

Lista, bazë e mirë për zgjedhje fer



FAQE 3

Çereku i shkollave, në Shkup



FAQE 4

Pançevskit i ngushtohet rrethi



FAQE 5

90 të punësuar, vetëm 4 shqiptarë!



FAQE 7

# Koha

www.koha.mk



## Tigrat që ia mbathën nga drejtësia

FAQE 18-19

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3192 • E hënë 9 tetor 2017 15 DEN



## Fituesi shihet në qytetet e mëdha

Shkup, 8 tetor - Fushata parazgjedhore këtë javë pritet të jetë më sensitive në aspektin e rivalitetit politik dhe më dinamike gjatë aktiviteteve në terren nga garuesit e zgjedhjeve lokale të 15 tetorit. Në taborin maqedonas - LSDM ia ka mësy me çdo kusht në fitojë Shkupin,

duke pasur BDI-në në krah ku dhe vetë lideri i saj, Ali Ahmeti, i bëri thirrje elektoratit shqiptarë të votojnë kandidatin e partisë së Zaevit, Petre Shilegov. Së fundmi, lideri i LSDM-së elektrizoi edhe më shumë garën mes BDI dhe Lëvizjes BESA duke thënë se kjo fundit ka

bashkëpunim me VMRO për Tetovën dhe Çairin, dy qytete këto ku partitë në pushtet kanë përqendruar të gjitha forcat për fitore të sigurt mos në rrethin e parë, por në të dytin gjithsesi. Nga ana tjetër, në kuluaret politike flitet se VMRO nuk ka gjasa ti... **FAQE 3**

Lojërat e fatit në Maqedoni

# Kumarxhi edhe 16 vjeçarët



Sipas hulumtimit të fundit të ESPAD, projektit evropian që analizon dukuritë negative në shkollat e mesme në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian si dhe shteteve të tjera evropiane, Maqedonia së bashku me ish shtetet e Jugosllavisë, Finlandën dhe Greqinë ka më shumë kumarxhinj ndër të rinjtë në Evropë **FAQE 6**

## Shkollat speciale vetëm në gjuhën maqedonase



Shkup, 8 tetor - Pabarazia në sistemin arsimor në Maqedoni përveçse në shkollat e rregullta, ku e gjejmë përmes formave të ndryshme, nuk mungon edhe në shkollat speciale apo institucionet shkollore për fëmijë me nevoja të veçanta. Të gjitha shkollat speciale shtetërore për fëmijë të moshës se mesme janë

vetëm në gjuhën maqedonase. Këto shkolla janë egocentrike edhe sa i përket vendndodhjes së tyre. Konkretisht, nga katër të tilla, tre janë në Shkup edhe atë në komuna me popullsi kryesisht maqedonase dhe një shkollë speciale në Shtip. Fëmijëve me nevoja të posaçme, pjesëtarëve të etnikeve jo maqedonase nuk u mbetet zgjidhja tjetër përpos të ndërpresin në mes shkollimin e tyre, nëse nuk dëshirojnë të shkollohen në gjuhën maqedonase. Ose, prindërit e tyre mund ti dërgojnë fëmijët me nevoja të posaçme nëpër kurse dhe shkolla private, mirëpo kur janë në pyetje kushtet dhe... **FAQE 4**

donase nuk u mbetet zgjidhja tjetër përpos të ndërpresin në mes shkollimin e tyre, nëse nuk dëshirojnë të shkollohen në gjuhën maqedonase. Ose, prindërit e tyre mund ti dërgojnë fëmijët me nevoja të posaçme nëpër kurse dhe shkolla private, mirëpo kur janë në pyetje kushtet dhe... **FAQE 4**

SPORT

### Flet Rexhepi, ndihmëstrajner i Maqedonisë



Në atë kohë shumë ishte vështirë të përparosh dhe te gesh klube për të luajtur për dallim prej tash kur është shumë e lentë të angazhohesh në ndonjë klub të Ligës dytë apo të parë. Suksesin më të madh e arrita te KF Renova duke u inkluadruar ekipin nga Liga e tretë në të... **FAQE 12-13**

PROFILE

### Njeriu që ndryshoi Italinë, edhe pse i vdekur...

FAQE 20

RAJON

### Millionat e kosovarëve në kafe, çaj e sheqer

FAQE 16

GLOBI

### Katastrofa e panjohur



FAQE 17



## Tetova, djep i kulturës dhe i civilizimit të shqiptarëve

Ne, shqiptarët e Maqedonisë e veçanërisht Tetova duhet të vazhdojmë të jetë djep i kulturës dhe civilizimit të shqiptarëve, porositi kreu i Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, në tubimin qendror në sheshin e qytetit ku u prezantua kandidati për kryetar komune dhe lista e këshilltarëve. Thaçi simpatizantëve të partisë dhe qytetarëve ju bëri thirrje për përkrahje masive për kandidatët e PDSH-së në Zgjedhjet e 15 tetorit duke i porositur që të mos bien pre e manipulimeve për "vëllazërim-

bashkim". "Ne jemi pjesë e kombit shqiptar dhe nuk duhet të biem pre e manipulimeve të dikujt se duhet të integrohemi me dikë tjetër. Ne shqiptarët e Maqedonisë e sidomos Tetova duhet të vazhdojmë të jetë djep i kulturës dhe civilizimit të shqiptarëve. Vota juaj më 15 tetor do të përcaktojë këtë orientim të shqiptarëve të Maqedonisë", tha Thaçi në tubim. Ai më tej potencoi se nuk mundet që qytetet e maqedonasve të zhvillohen me të gjitha kushtet ndërsa qytete shqiptare të mos kenë as kushtet elementare.

## Struga meriton siguri, zhvillim dhe pastërti

Kandidati i BDI-së për kryetar të Komunës së Strugës, Ramiz Merko, në një takim me gazetarë ka vlerësuar se fushata parazgjedhore në këtë komunë zhvillohet në një atmosferë demokratike me ç'rast janë vizituar pothuajse të gjitha vendbanimet e kësaj komune. "Gjatë kësaj kohe janë vizituar të gjitha shtabet vendore, janë formuar në kohë dhe me numër shumë të madhe të aktivistëve, gjithashtu janë bërë në njësit apo këshillat zgjedhor. Në javën e dytë kemi vizituar të gjithë vendbanimet, kemi shkuar shtëpi në shtëpi, lagje në lagje, si kandidati për kryetar bashkë me të gjithë kan-

didatët për këshilltar komunal të listës të Bashkimit Demokratik për Integrim. Mendoj se deri më tani kemi bërë një fushatë jashtëzakonisht të qetë e cila do të rezultojë me sukses në 15 tetor 2017. Sot fushata merr kulminacionin e vet, sot do të vijë kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti në vizitë komunës së Strugës", theksoi Merko. Ai gjatë prezantimit të Programit zgjedhor, theksoi se në këto zgjedhje del me ofertë të qartë për zhvillim të komunës së Strugës, program që është përpiluar në bashkëpunim me qytetarët e kësaj komune.

# Qytetarët duan progres dhe anëtarësim në NATO dhe BE

"BDI dha kontribut të madh që të mos ndodh më e keqja, pasi që vetëm në mënyrë të qetë mund të shkojmë përpara. BDI nuk i humbi zgjedhjet parlamentare dhe siç thamë, ishte çelës për formimin e Qeverisë", theksoi Ahmeti



Dibër, 7 tetor - Qytetarët e vendit tonë dëshirojnë progres, anëtarësim në NATO dhe BE, lëvizje të lirë, ekonomi të fuqishme, stabilitet, porositi lideri i BDI-së, Ali Ahmeti nga tubimi i mbrëmshëm në Dibër në të cilin janë prezantuar kandidati për kryetar komune dhe lista e këshilltarëve. "Angazhimi ynë është bashkëpunimi me të gjithë fqinjët, me Shqipërinë, Kosovën. Shenjë e mirë është marrëveshja me Bullgarinë si edhe angazhimet për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë. Punët po shkojnë në këtë drejtim, ndërsa kjo na e hap rrugën drejt NATO-s që do të thotë stabilitet jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për rajonin, besim më të

madh tek investitorët, zhvillim më të shpejtë dhe anëtarësim në BE. Ne dëshirojmë perspektivë evropiane për gjithë Ballkanin", tha Ahmeti. Sipas tij, Maqedonia gjatë dy viteve të kaluara pati krizë politike e cila mundet të çonte drejt përlëshjeve ndëretnike, por me ndihmën dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, u arrit marrëveshje. "BDI dha kontribut të madh që të mos ndodh më e keqja, pasi që vetëm në mënyrë të qetë mund të shkojmë përpara. BDI nuk i humbi zgjedhjet parlamentare dhe siç thamë, ishte çelës për formimin e Qeverisë", theksoi Ahmeti. Ai ju bëri thirrje qytetarëve që ta mbështesin, Ruzhdi

Latën pasi që angazhimi i tij është, tha Dibra evropiane. Këtë e ka dëshmuar edhe gjatë katër viteve të kaluara. Lata, i cili për të dytën herë me radhë e kërkon besimin, u përëndrua në projektet e premtuara dhe të realizuar. "Gjithçka që premtuan para katër vitesh, realizuam edhe më shumë se atë. Për gjithçka që arritëm me angazhim maksimal, bashkëpunim, mirëkuptim, me fytyrë të pastër, ju drejtohem dhe e kërkoj votën tuaj për edhe një mandat në të cilin në tërësi do t'i realizojmë idetë tona me të cilat Dibra do të bëhet qytet evropian", theksoi Lata. Ai paralajmëroi më shumë projekte, më shumë

infrastrukturore, ndërtimin e kopshtit të ri, rezervuarit për furnizimin e qytetit, rregullimin e deponisë së qytetit, rikonstruimin e sistemit për ujë. Para të pranishmëve u promovua edhe lista e kandidatëve për këshillin komunal, bartës i së cilës është Fuat Spahiu, sportist i njohur dibran. "Është nder të jesh në krye të listës në të cilën ndodhen njerëz të suksesshëm dhe me vlerë. Do ta arsyetojmë besimin dhe së bashku me të gjithë këshilltarët, pa dallim përkatësisë së tyre partiake dhe përkatësisë tjetër do të punojmë për të mirën e komunës së Dibres dhe banorëve të saj", tha Spahiu.

## Dyert e komunës tonë do të jenë të hapura



Lëvizja Besa tubim qendror mbajti në komunën e Studeniçanit, ku fjalë rasti gjatë tubimit mbajtën deputeti i Lëvizjes Besa, Afrim Gashi, sekretari organi-

zativ i partisë Zejd Rexhepi. Gjatë fjalimeve dy anëtarët e kryesisë qendrore të Besës, siç njofton Shërbimi për informim, bartësin e listës Ibrahim Jusufi dhe kandidatin për

kryetar të Komunës së Studeniçanit Rexhep Memedi, i përgëzuan me fitoren e radhës që, siç thuhet, do të ketë Lëvizja Besa në Studeniçan. Fjalë rasti mbajti edhe kandidati i Lëvizjes Besa për kryetar komune në Studeniçan, Rexhep Memedi duke ngërthyer, siç shtohet më tej në kumtesë, fjalë shpresëdhënëse për banorët e Karshiakës. "Qytetarëve të Komunës së Studeniçanit me sinjeritet më të madh ju premtojmë se detyrimet tona do t'i kryej me profesionalizëm dhe transparencë. Pa dallim përkatësisë nacionale dhe

politike, dyert e komunës tonë do të jenë të hapura për të gjithë banorët e Karshiakës. Ne do të jemi në shërbimin tuaj gjithmonë. Jemi të vetëdijshëm për hallet dhe problemet që ekzistojnë në komunën tonë por ne së bashku duhet të punojmë sa më shumë dhe të ofrojmë më të mirën për të gjithë", tha Memedi. Tubimi i Lëvizjes Besa në Studeniçan, përfundoi me prezantimin e projekteve të prezantuara me 3D, programe dhe projekte të cilat Lëvizja Besa i synon që t'i realizoj gjatë mandatit të fituar katërvjeçar.

## Rrugët të shkretuara, qytetet dhe fshatrat të shpërngulur

Nuk mund të themi si gjithçka është e njëjtë në qytetet dhe fshatrat tona, sepse rrugët janë të shkretuara, ndërsa qytetet dhe fshatrat të shpërngulura nga banorët. Do të bëjmë gjithçka që të tregojmë se fillon jetë e re në qytetet në vend, tha lideri i LSDM-së, Zoran Zaev nga tubimi në Vinicë. Në fjalim, Zaev paralajmëroi ndryshime, duke theksuar se LSDM-

ja me siguri do të fitojë me mijëra vota dallim dhe kjo do të jetë e qartë që në raundin e parë. "Më 15 tetor fillojmë ndryshimin në të gjitha sferat e jetesës, sepse do të rrezohet regjimi dhe do të fitojmë me penë", theksoi Zaev. Lideri i LSDM-së foli edhe për rezultatet që qeveria aktuale i arriti në katër muajt e kaluar. U fokusua edhe në miratimin e Ligjit për paga

minimale që do të vlejë për 7.000 të punësuar në vend. Paga minimale, kujtoi, do të jetë 12.000 denarë. "Deri në fund të vitit 2019 paga mesatare në Maqedoni do të jetë 500 euro", tha Zaev. I bëri thirrje qytetarëve më 15 tetor të votojnë për jetën në Maqedoni, duke premtuar se vendi dhe pushteti lokal do të jetë servisi i duhur i qytetarëve. Koalicioni "Jetë në Maqedoni" i

kryesuar nga LSDM-ja në tubimin në Vinicë para qytetarëve e paraqiti listën e këshilltarëve për këshillin e ardhshëm të komunës bartës liste i të cilit është Mitko Ilievski. Foli edhe kandidati për kryetar komune Ivica Dimitrov i cili theksoi se pushteti i ri lokal ka plane reale edhe projekte për rrugët, kanalizimet, ujësjellësat, kopshtet, shkollat dhe terrenet sportive.





## Vota për ASH-në, votë për decentralizim thelbësor të pushtetit

Do të jemi në parlament kur të silltet ligji për gjuhët, vota për Aleancën për shqiptarët do të thotë decentralizim thelbësor i pushtetit për të cilin do të angazhohemi, pasi që vetëm kështu kryetarët e komunave do të mund të jenë shumë më të suksesshëm, porositi në Kërçovë lideri i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela. Sela para të pranishmëve tha se kanë pasur guxim dhe kanë qenë atje ku u zgjodh kryetari i Parlamentit dhe ku rrethojë Qeveria ku, siç tha, shumë liderë nuk ishin aty, atë ditë në parlament. "Më lejoni këtu në Kërçovë, publikisht të apeloj dhe t'i jap mbështetje Fatmir Deharit që përsëri të zgjidhet kryetar komune. Por, gjithashtu do të më lejoni që publikisht ta pyes Ali Ahmetin se me çfarë porosi ai vjen në Strugë nëse unë erdha këtu në Kërçovë me mesazhin për bashkim", deklaroi Sela në Kërçovë, ku sonte nën moton "Dituri dhe guxim" u prezantua programi zgjedhor për zgjedhjet lokale të Aleancës për shqiptarët. Në Shtëpinë e Kulturës para të pranishmëve fjalim mbajti bartësi i listës së këshilltarëve, Genc Selmani i cili tha se në Kërçovë ia kanë dalë ta vrasin frikën. "Do të dimë të bëjmë depolitizim të administratës publike, do të kërkojmë dislokimin e deponisë, do të ndërtojmë kopshte në mjediset rurale si dhe vlerësojmë se është shumë e rëndësishme të hapet zyrë për tërheqjen e investimeve", tha Selmani. Ai theksoi se do të punojnë edhe në përmirësimin e infrastrukturës sportive si dhe në pasurimin e jetës kulturore në Kërçovë.

**BDI fushatën parazgjedhore do ta mbyllë një ditë më herët me tubim të madh në Tetovë, ndërsa të premtën - në të gjitha komunat do të ketë tubime zbatimëse organizuar nga të rinjtë e partisë. Në Tetovë fushatën do ta mbyllë një ditë më pas Lëvizja BESA përmes një tubimi të madh, ndërsa ASH në Strugë. PDSH takimin përmbyllës me elektoratin e vet do ta ketë të premtën në Likovë**

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 8 tetor - Fushata parazgjedhore këtë javë pritet të jetë më sensitive në aspektin e rivalitetit politik dhe më dinamike gjatë aktivitetëve në terren nga garuesit e zgjedhjeve lokale të 15 tetorit. Në taborin maqedonas - LSDM ia ka mësy me çdo kusht në fitojë Shkupin, duke pasur BDI-në në krah ku dhe vetë lideri i saj, Ali Ahmeti, i bëri thirrje elektoratit shqiptarë të votojnë kandidatin e partisë së Zaevit, Petre Shilegov. Së fundmi, lideri i LSDM-së elektrizoi edhe më shumë garën mes BDI dhe Lëvizjes BESA duke thënë se kjo fundit ka bashkëpunim me VMRO për Tetovën dhe Çairin, dy qytete këto ku partitë në pushtet kanë përqendruar të gjitha forcat për fitore të sigurt mos në rrethin e parë, por në të dytin gjithësesi. Nga ana tjetër, në kuluaret politike flitet se VMRO nuk ka gjasa ti rezistojë binomit LSDM-BDI në Shkup, duke u përqendruar në komunat lindore dhe jugore - rajone këto ku kemi një numër të konsiderueshëm dhe të komunave të vogla e ku dominante për

Pritet rivalitet më i ashpër në ditët e fundit të fushatës

# Fituesi shihet në qytetet e mëdha



tre palë zgjedhje lokale ka qenë VMRO. Ndryshe, LSDM për dalim nga anketat e mëhershme para çdo cikli zgjedhor - si parlamentar ashtu dhe në atë lokal, qëndronte shumë mbrapa VMRO-së, këtë radhë - duke qenë në pushtet, në anketat e fundit ka tejkaluar VMRO-në për herë të parë pas vitit 2006. BDI nga ana tjetër, përveç rivaliteti të fortë me BESËN në Komunat e Shkupit dhe në Likovë, këto ditë e ka theksuar rivalitetin në terren dhe me partnerin e saj qeveritar - Aleanca për Shqiptarët të Ziadin Selës. Ky fundit, gjatë një tubimi në Kërçovë ironizoi direkt me liderin e BDI-së, Ali Ahmeti, lidhur me apelet e tij të që bëri në fillim të fushatës për mospërçarjes votës shqiptare. "Ali e kemi një pyetje publike për ty. Çfarë do të bësh kur të vish në Strugë, do të bësh thirrje për të përçarë apo bashkuar. S'ke nevojë të vish, sepse shqiptarët janë bashkuar

në të gjitha vendbanimet dhe komunat, përfshirë Ohër e Manastir me lista të përbashkëta", ka thënë Sela. Mes partive shqiptare garë e nxehtë po zhvillohet në komunat kryesore, ku pikas Tetova më katër pretendentë serioz në garë - Teuta Arifin, Bilall Kasamin, Adnan Nezirin dhe Bardhyl Dautin, më pas Gostivari mes Nevzat Bejtës dhe Arbën Taravarit, pastaj Struga mes Ziadin Selës dhe Ramiz Merkos, Çairi mes Visar Ganiut dhe Zeqirija Ibrahimit dhe Likova, ku BESA ia ka mësy ta mund BDI-në për herë të parë që nga Konflikti i vitit 2001 me kandidatin Shaban Zendeli kundrejt Erkan Arifit të BDI-së.

Por, bashkëpunimi mes partive do të jetë kyç në rrethin e dytë, sidomos mes BDI-së dhe LSDM-së nga njëra anë dhe nga ana tjetër - Lëvizjes BESA dhe Aleancës për Shqiptarët që kanë afri mes veti që në rrethin e parë. Por njëherë apo tjetrit bosht mund t'ia

prish hesapet PDSH, e cila ende qëndron e fortë në Tetovë, Gostivar, Studeniçan, Strugë, Likovë dhe në komunat tjera, e cila edhe në anketën e fundit të Brima Gallupit, me mbi 2 për qind nuk mund të mos llogaritet kyçe për në rrethin e dytë zgjedhor. Në këtë parti, pas zgjedhjeve lokale ka zëra se mund të ketë ndryshime në kreun e partisë, ndërsa emri që do ta zëvendësojë Menduh Thaçin përflitet nënkryetari i partisë Bardhyl Dauti për të cilin pritet në këtë parti janë të mëdha se do të shkojë në rreth të dytë për Komunë e Tetovës. Sa i përket tubimeve përmbyllëse, nga agjendat partiake shihet se partitë shqiptare do të përqendrohen në komunat e perëndimore më shumë ku dhe elektorati shqiptarë është më dominant. BDI tubimin përmbyllës do ta mbajë në Tetovë, ditën e enjte, ndërsa partitë tjera - si zakonisht do ta mbyllin të premtën. Deri të premtën, BDI do

të ketë tubime në Gostivar, Çair, Strugë dhe Kërçovë. Po në Tetovë, fushatën do ta mbyllë edhe Lëvizja BESA, ndërsa deri të premtën - tubime të mëdha do të mbajë në Zhelinë, Likovë, Kumanovë, Saraj, Vrapçishtë dhe Gostivar. Lëvizja BESA synon fitore në rreth të parë në Likovë, Çair, Saraj, Studeniçan dhe Tearcë, ndërsa llogarit në fitore të sigurt në rreth të dytë në Tetovë dhe Bogovinë, por mbajnë shpresa edhe në Dibër dhe Gostivar. Ditëve të fundit, kjo parti ka reaguar kundër qëndrimeve të BDI dhe LSDM-së se ka bashkëpunim me VMRO-në, ndërsa i fundit ishte kandidati për Çairin, Zeqirija Ibrahimit i cili tha se BESA ka refuzuar ofertë konkrete për formimin e Qeverisë, ndërsa për zgjedhje - nuk bëhet fjalë që të ndihmohej partia e Gruevskit. Aleanca për Shqiptarët tubimin përmbyllës do ta mbajë të premtën në Strugë, qytet të cilin synim kryesor ka që të fitojë duke llogaritur në kandidaturën e fortë të liderit të partisë, Ziadin Sela. ASH të enjten do të mbajë tubim në Gostivar dhe në Vrapçisht dhe të mërkurën në Dibër. Partia Demokratike Shqiptare fushatën parazgjedhore do ta përmbyll në Likovë të premtën, ndërsa këto ditë do të jetë aktive në lagjet dhe fshatrat e Komunës së Tetovës, siç thonë nga Shtabi qendror, ndërsa tubim të madh do të ketë edhe në Gostivar. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët (RDK+UNITETI) tubimion përmbyllës, siç edhe pritej, do ta ketë në Gostivar.

Çiçakovski për Radio Evropën e Lirë

## Lista zgjedhore, bazë e mirë për zgjedhje kredibile

Shkup, 8 tetor - Lista zgjedhore është në pajtim me kornizën juridike dhe metodologjinë ekzistuese për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e saj, e reflektionet shkallën e rrejtshmërisë së të dhënave të marra nga institucionet relevante dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin zgjedhor konsiderojnë se është bazë e mirë për mbajtje të zgjedhjeve të drejta dhe kredibile, thotë në intervistën e së dielës të radios Evropa e Lirë kryetari i KSHZ-së, Aleksandar Çiçakovski. Sipas tij, në KSHZ janë parashtruar vetëm tridhjetë kërkesa për regjistrim, ndryshime apo shlyerje në të dhënat e Listës zgjedho-

re. "Komisioni shtetëror zgjedhor vendimin për mbyllje të Listës zgjedhore e sollë në mbledhje publike në të cilën u thirrën të gjitha mediumet, institucionet relevante dhe vëzhguesit e akredituar, Vendimi është publikuar në uebfaqen e KSHZ-së, e kapshme për të gjithë qytetarët. Ka vërejtje të caktuara, i shohim edhe ne nga ana e ekspertëve të caktuar, por unë personalisht konsideroj se gjendja ekzistuese e Listës zgjedhore e reflektionet kornizën juridike dhe shkallën e rrjedhshmërisë së të dhënave të cilat i morëm nga institucionet relevante", thekson Çiçakovski. Lidhur me akuzat e VMRO-DPMNE-

së se një pjesë e KSHZ-së punon në interes të partisë në pushtet, Çiçakovski është decid se zgjedhja dhe emërimi i administratës zgjedhore bëhet në bazë të metodologjisë së përcaktuar dhe të dhënave të marra nga Ministria kompetente, e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Deri më tani, postenoi, nuk kanë arritur ankesa dhe vërejtje të llojit të këtyllë. "Komisioni shtetëror zgjedhor edhe për këto zgjedhje e implementoi këtë metodologji dhe kreu zgjedhje të anëtarëve të këshillave zgjedhor sepse ndërkohë u skadoi mandati, por kreu edhe plotësim të anëtarëve të komisioneve komunale



zgjedhore në të cilët në baza të ndryshme u kaloi mandati. Tërësisht u respektuan dispozitat ligjore në këtë pjesë. Nëse ka vërejtje të caktuara lidhur me qasjen e veprimt, ata duhet të dokumentohen

dhe parashtrohen në KSHZ, në mënyrë që të mund të veprojmë në mënyrë adekuate", theksoi kryetari i KSHZ-së, Aleksandar Čičakovski në intervistën e së dielës të Radios Evropa e Lirë.



Shpërndarja e institucioneve arsimore sipas rajoneve

Nuk është vetëm koncentrimi i institucioneve arsimore në kryeqytet, elementi dominant në analizën e rrjetit të shkollave të mesme, sipas shpërndarjes në tetë rajone. Një fakt, shqetësues është edhe disproporcioni i shkollave në rajone të dominuar me shqiptarë dhe maqedonas. Kështu, për shembull, rajoni i Pollogut, i cili ka thuhetse dyfishin e nxënësve të rajonit të Pellagonisë kanë thuhetse numër të njëjtë shkollash

# Çereku i shkollave të mesme, në Shkup



Koha Laura PAPANUKU

Shkup, 8 tetor - Thuhetse një e treta e institucioneve arsimore të nivelit të mesëm në Maqedoni janë në rajonin e Shkupit. Nga 176 objekte, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë edukative arsimore 124 shkolla të rregullta, speciale dhe fetare, vetëm në rajonin e Shkupit ndodhen 54 objekte ose 30.7 për qind e totalit. Pjesa tjetër e shkollave janë të shpërndara në shtatë ra-

jonet e mbetura, ku gjithashtu mund të vërehet një diskrepancë e shpërndarjes së shkollave, krahasuar me numrin e nxënësve. Kështu për shembull në rajonin e Pellagonisë me kryeqendër Manastirin ka 23 objekte në të cilat zhvillohet mësimi i mesëm, kurse në rajonin e Pollogut me kryeqendër Tetovën ka 24

objekte. Mirëpo, Tetova ka dyfish më tepër nxënës se sa Manastiri. Konkretisht, sipas Entit të Statistikave, në vitin shkollor 2016 vetëm Tetova kishte 4060 nxënës të mesëm, ndërsa Manastiri 2113 nxënës. Në rajonin e Pollogut bie edhe qyteti i Gostivarit me numër gjithashtu të madh nxënësish të shkollave të mesme, konkretisht 2322

nxënës, kurse në rajonin e Pellagonisë, krahas Manastirit qytet tjetër i madh është Prilepi, me jo më shumë se 1781 nxënës.

Nëse i krahasojmë të dyja këto rajone, duke i gjykuar vetëm në bazë të numrit të nxënësve të qyteteve kryesore, pra Tetovën dhe Gostivarin bashkë si dhe Manastirin

dhe Prilepin bashkë, i bie që numri i nxënësve të jetë 6382 nxënës përballë 3894 nxënësve. E, pavarësisht diferencës prej rreth 2500 nxënës më shumë, të dyja rajonet kanë numër thuhetse të barabartë objektsh shkollorë, pra 23 rajoni i Pellagonisë dhe 24 i Pollogut. Ose vetëm, në bazë të numrit të nxënësve të dy qyteteve më të mëdha të atyre rajoneve, i bie që në Pellagoni të ketë mesatarisht nga 170 nxënës në secilin objekt, për dallim prej rajonit të Pollogut, ky sipas atij raporti i bie të ketë mesatarisht nga 266 nxënës. Shpërndarja jo e drejtë vërehet edhe në numrin e shkollave si subjekte juridike, ku në Tetovë dhe Gostivar, kemi 11 subjekte juridike ose njëlloj sa në Manastir dhe Prilep, pavarësisht faktit se kemi rreth 2500 nxënës më tepër. Rajoni me numrin më të madh të shkollave dhe objekte shkollorë të mesme është ai i Shkupit, ku krahas 26 shkollave të rregullta të mesme, janë edhe katër

shkolla speciale dhe dy shkolla të mesme fetare. Pas saj vijjnë rajonet e Pollogut (24), Pellagonisë (23), rajoni Lindor me kryeqendër Shtipin (18), rajoni Jugperëndimor me kryeqendër Ohrin (16), rajoni i Vardarit me kryeqendër Velesin (15), rajoni Verior me kryeqendër Kumanovën (14) dhe rajoni juglindor me kryeqendër Strumicën (11).

Në rrjetin e institucioneve arsimore të nivelit të mesëm bie në sy mungesa e tyre në disa komuna, konkretisht në 23 komuna 81 gjithsej. Mirëpo, është evidente edhe një e dhënë tjetër shqetësuese, komuna me popullsi kryesisht maqedonase, që nuk kanë shkolla të mesme janë me numër shumëfish më të vogël nxënësish se komunat që banojnë me popullsi kryesisht shqiptare. Kështu, për shembull, nuk kanë shkolla të mesme disa komuna maqedonase, si Konçeja, Pehçeva Pllashica apo Rosomani me nga 279, 210, 337 dhe 399 filloristë gjithsej. Por, komunat kryesisht shqiptare, si për shembull Studeniçani dhe Haraçina kanë nga 2043, respektivisht 1060 nxënës të shkollave fillore. Pra, numri potencial i nxënësve e kandidatë për shkollë të mesme në komunat maqedonase, është disa herë më i vogël se numri i nxënësve kandidatë për regjistrim në shkollat mesme.

**Katër shkollat e mesme speciale, përveçse gravitojnë në komuna kryesisht maqedonase, tre në Shkup dhe një në Shtip, nuk kanë asnjë paralele me mësim në gjuhën shqipe. Fëmijëve me nevoja të posaçme, pjesëtarëve të etniteteve jo maqedonase nuk u mbetet tjetër përveçse të ndërpresin shkollimin, nëse nuk dëshirojnë të vazhdojnë në gjuhën maqedonase**

Shkup, 8 tetor - Pabarazia në sistemin arsimor në Maqedoni përveçse në shkollat e rregullta, ku e gjejmë përmes formave të ndryshme, nuk mungon edhe në shkollat speciale apo institucionet shkollorë për fëmijë me nevoja të veçanta. Të gjitha shkollat speciale shtetërore për fëmijë të moshës se mesme janë vetëm në gjuhën maqedonase. Këto shkolla janë egocentrike edhe sa i përket vendndodhjes së tyre. Konkretisht, nga katër të tilla, tre janë në Shkup edhe atë në komuna me popullsi kryesisht maqedonase dhe një shkollë speciale në Shtip. Fëmijëve me nevoja të posaçme, pjesëtarëve të etnikeve jo maqedonase nuk u mbetet zgjidhja tjetër përpos të ndërpresin në mes shkollimin e tyre, nëse nuk dëshirojnë të shkollohen në gjuhën maqedonase. Ose, prindërit e tyre mund të dërgojnë fëmijët me nevoja të posaçme nëpër kurse dhe shkolla private, mirëpo kur janë në pyetje kushtet dhe mundësitë që shteti duhet ti ofrojë në mënyrë të barabartë për të

Pabarazi edhe në arsimin special

## Shkollat speciale vetëm në gjuhën maqedonase



gjithë - shqiptarët, turqit dhe të tjerët nuk e gëzojnë një të drejtë të tillë. Në nivelin e arimit fillor, përveçse në gjuhën maqedonase, ka edhe në gjuhën shqipe shkolla dhe paralele për nxënës me nevoja të veçanta. Në gjithsej 45 shkollat e këtuila me rreth 700 nxënës, arsimit sipas nevojave të veçanta në gjuhën shqipe organizohet në gjashtë shkolla për mbi 80 fëmijë. Pra, nuk është se nuk ka nxënës që do të vazhdonin arsimin e mesëm special edhe në gjuhën shqipe, por nuk ka shkolla dhe paralele në gjuhën shqipe, ku fëmijët me nevoja të veçanta të mund të realizonin një gjë të tillë. Edhe kuadri i

posaçëm arsimor nuk është që mungon, pasi ka më tepër se 10 vite që kuadro të këtuila nxjerr vazhdimisht Universiteti i Tetovës krahas shumë të tjerëve që regjistrojnë programet studimore të defektologjisë në Shkup. Tregues i jo mungesës është edhe angazhimi i 14 mësimdhënësve në nëntë paralelet e arimit special në nivelin e shkollave fillore. Jo të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta kanë pengesa të njëjta zhvillimore. Madje, për shkak të inkuizivitit (gjithëpërfshirës) në arsim në rastet e pengesave jo të rënda fëmijët dërgohen në shkollat e rëndomta dhe për këtë arsye - numri më i madh i fëmijëve që

ndjekin shkollat speciale janë kategoria e fëmijëve me pengesa në zhvillimin mental. Në vitin shkollor 2016/2017, në shkollat fillore speciale në Maqedoni ishin gjithsej 809 nxënës të shpërndarë në 194 paralele dhe 45 shkolla. Në kategorinë e fëmijëve me pengesa në zhvillimin mental ishin të evidentuar 665 fëmijë, të shpërndarë në 152 paralelet dhe 39 shkolla. Nxënësit tjerë janë në paralelet pengesa në dëgjim dhe të folur (80), në paralelet me shikim të dëmtuar (33), në paralelet e fëmijëve me invaliditet trupor (10) dhe në paralelet e fëmijëve të braktisur (21).

Në nivelin e arimit të mesëm, sikurse përmendëm më lart janë katër shkolla speciale edhe atë nga një në komunat e Gazibabës, Kisellavodës dhe Qendrës në Shkup, si dhe një në Shtip. Në këtë të fundit janë gjithsej 71 nxënës, ndërsa pjesa tjetër në tre shkollat speciale të kryeqytetit. Çairi, Tetova, Gostivari dhe komuna të tjera të mëdha me popullsi kryesisht shqiptarë nuk kanë asnjë shkollë të mesme speciale. Përveç kësaj, edhe në shkollat që gravitojnë në komuna me popullsi kryesisht maqedonase nuk ka asnjë paralele në gjuhën shqipe. (L.P)



## Të shlyhen borxhet për taksën radiodifuzive

Shkup, 8 tetor - Nga Drejtoria e të hyrave publike thonë se taksa radiodifuzive duhet të paguhet deri në muajin shtator, duke apeluar te qytetarët dhe kompanitë që të paguajnë borxhet e mbetura.

“Qytetarët dhe kompanitë kanë detyrim të paguajnë të gjitha borxhet për taksën radiodifuzive për periudhën janar 2011 - shtator 2017. Për të gjitha rastet specifike, për të mbyllur siç duhet kartat financiare që Zyra për të Ardhurat Publike lëshon për obligacionet e taksës radiodifuzive, qytetarëve dhe kompanive, informata shtesë do të publikohen në faqen tonë të internetit “, thonë nga DAP. Zyra e të ardhurave publike nuk do të lëshojë fletpagesë për taksën radiodifuzive për muajin tetor, pasi kjo tarifë është shfuqizuar me ndryshimet në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, të cilat u miratuan muajin e kaluar.



Edhe një iniciativë për hetim të brendshëm në GJPSH

# Pančevskit i ngushtohet rrethi përbrenda

Brenda javës e cila pason, edhe zyrtarisht duhet të dihet forma përmes të cilës "gjykatësit e anashkaluar" në GJPSH, do të kërkojnë llogaridhënie nga ish kryetari i tyre, gjegjësisht duhet të sqarohen dilemat se kërkesa e gjykatësve do të shkojë në mënyrë kolektive, ose çdo njëri individualisht do të parashtrijë pyetje për aktivitetet dhe punën e ish-kryetarit Vladimir Pančevski

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 8 tetor - Krahas hetimeve, të cilat Prokuroria Speciale Publike i ka filluar ndaj ish kreut të Gjykatës Penale të Shkupit (GJPSH), Vladimir Pančevski, sot (e hënë), sipas paralajmërimeve - edhe një pjesë e gjykatësve të cilët punojnë në këtë Gjykatë, do të kërkojnë iniciimin e procedurës për llogaridhënie nga ish-kryetari Pančevski. Kërkesat e tyre, pjesa dërmuese e gjykatësve që punojnë në GJPSH, siç raportojnë mediat e vendit, në formë peticioni pritet t'i kërkojnë ushtruesit aktual të detyrës kryetar i kësaj gjykate, Stojanče Ribarev, të dhëna dhe informacione nga puna kur me këtë instancë gjyqësore ka udhëhequr gjykatësi Vladimir Pančevski. Brenda javës, e cila pason, edhe zyrtarisht duhet të dihet forma përmes të cilës



"gjykatësit e anashkaluar" në GJPSH, do të kërkojnë llogaridhënie nga ish kryetari i tyre, gjegjësisht gjatë ditëve në vazhdim duhet të sqarohen dilemat se kërkesa e gjykatësve do të shkojë në mënyrë kolektive, ose çdo njëri individualisht do të parashtrijë pyetje për aktivitetet dhe punën e ish kryetarit dhe kolegut të tyre për momentin - gjykatësin Pančevski. Të dhënat e publikuar për zhvillimet në GJPSH thonë se "gjykatësit e anashkaluar", do të kërkojnë edhe informacione nga bastisja e PSP-së që ndodhi javën e kaluar, përfshi edhe kontrollin nga hetuesit e

kësaj në shtëpinë e ish kryetari të GJPSH-së, Pančevski. "Gjykatësit janë të interesuar se çfarë lloj të keqpërdorimit ka bërë Pančevski gjatë kohës kur ka qenë kryetar i kësaj gjykate. Flitet se pikërisht gjatë dy viteve të tij si drejtues i GJPSH-së, ai e ka penguar punën e PSP-së, si dhe ka intervenuar në sistemin elektronik të shpërndarjes së lëndëve, gjegjësisht lëndët gjyqësore i ka dhënë dorë më dorë, respektivisht kjo mënyrë e funksionimit të dhënies së lëndëve thuhet se ka vazhduar edhe pas largimit të tija nga posti i kryetari të gjykatës", thonë bu-

rime brenda Gjykatës Penale të Shkupit, sipas të cilëve, revolta e gjykatësve është shtuar më tepër pasi ka zëra se Pančevski i ka incizuar vendet e tyre të punës. Në kuadër të kërkesës, e cila përgatitet të dorëzohet deri te u.d kryetari Stojanče Ribarev, thuhet se do të kërkohej që ky i fundit - para Këshilli Gjyqësor të Maqedonisë, t'i dorëzohen të gjitha të dhënat që i posedon e që lidhen me punën e paraardhësit të tij. Ndryshe, një Komision i Ministrisë së Drejtësisë, ekupe të policisë dhe hetues nga PSP, të enjten e kaluar edhe zyrtarisht me urdhra gjyqësor u futën në Gjykatën Penale të Shkupit. Përveç autoriteteve nga Ministria e Drejtësisë, të cilët kontrollin e sistemit elektronik të shpërndarjes së lëndëve gjyqësore paralajmëruan më herët, MPB dhe prokurorët special si cak patën zyrën e gjykatësit Pančevski, ndaj të cilit në prokurorinë e Katica Janevës, zhvillohet një procedurë para hetimore dhe me këtë rast - ish kryetarit të GJPSH-së, ju konfiskuan të gjitha të dhënat nga sistemi kompjuterik i tij dhe dy personave tjerë të punësuar në këtë gjykatë. Duke e arsyetuar këtë bastisje, nga PSP kanë njoftuar se ish kreu i GJPSH-së dyshohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare, respektivisht për zbulim të sekretit shtetëror, me këtë rast furnizim me informacione sekret personat të cilët kanë qenë objekt hetimi nga PSP.

Bie interesi i qytetarëve për marrje të kredive nëpër banka

## Më shumë kursejnë se sa marrin kredi

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Popullore të Maqedonisë, deri në fund të muajit gusht kreditë e përgjithshme kanë shënuar rritje minimale prej 0.2 për qind, edhe atë vetëm te kreditë e destinuara, gjegjësisht kredi konsumatore. Në anën tjetër, të dhënat e raportit zyrtar për periudhën prej 8 muajve të parë të këtij viti, tregojnë për ulje të interesit të qytetarëve për marrje të kredive

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 8 tetor - Edhe pse bankat komerciale, të cilat veprojnë në Maqedoni, ofrojnë oferta të llojllojshme të kredive, si kredi konsumuese, për banim apo blerje të veturave, interesimi i qytetarëve për të aplikuar për kredi të reja vazhdimisht po bie. Sipas të dhënave të fundit të Bankës Popullore të Maqedonisë (BPM), deri në fund të muajit gusht, kreditë përgjithshme kanë shënuar rritje minimale prej 0.2 për qind, edhe atë vetëm te kreditë e destinuara, gjegjësisht



kredi konsumatore. "Rritje vjetore e kredive të lejuara, të cilat në nivel vjetor shënojnë rritje prej 5.1 për qind, janë kredi konsumatore, gjegjësisht 89 për qind janë kreditë të lejuara për pajisje shtëpiake", thuhet në raportin e BPM-së. Raporti gjithashtu tregon se edhe kreditë për sektorin korporativ si dhe muajin e mëparshëm shënojnë rritje minimale prej 0,1 për qind për kreditë e marra në valutën e denarit, ndërsa kreditë e lejuara në valutat e huaja, shënojnë ulje prej 0.2 për qind. Raporti i BPM-së, i përgatitur përfundimisht më muajin gusht të këtij viti, nuk sjellë edhe lajme të mira për

dilerët apo importuesit legal të veturave të reja. "Numri i kërkesave për blerje të veturave të reja me kredi deri në fund të muajit gusht është zvogëluar për 9.4 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Këto të dhëna, edhe njëherë vërtetojnë shqetësimin e firmave, të cilët në Maqedoni shesin vetura, se kërkesat për blerje të veturave të reja përmes kredive në vazhdimësi po ulet", thuhet në raportin e BPM-së. Për dallim nga kërkesat e ulëta për kredi konsumatore, banimi apo kredi automobilistike, në raportin e BPM-së thuhet se gjatë 8 muajve të parë të këtij viti bankat kanë rritur limitin e

qytetarëve bartës të kartelave kreditore dhe atë për 0.4 për qind, por dhe nëse e krahasojmë në nivel vjetor, kemi ulje mesatarisht prej 0.7 për qind. "Gjithashtu gjatë muajit qershor të vitit 2017, është regjistruar saldo negative në llogaritë transakionale të qytetarëve prej 1.3 për qind, ndërsa në nivel vjetor kjo ulje kap shifrën prej 2.9 për qind, ndërsa kreditë e lejuara pa dedikim në nivel mujor, shënojnë ulje prej 0.4 për qind, ndërsa në nivel vjetor ulja është 1.7 për qind", thuhet në raportin e BPM-së. Në anën tjetër, derisa të dhënat e raportit zyrtar të BPM-së për periudhën prej 8 muajve të parë të këtij viti, tregojnë për ulje të interesit të qytetarëve për marrje të kredive, rritje është regjistruar në nivel mujor te kursimet e qytetarëve në valutave të huaja dhe në denarë prej 0.6 për qind. "Në nivel vjetor kursimet e depozitave të qytetarëve në valuta të huaja shënojnë rritje prej 5.7 për qind. Rritje të njëjtë shënojnë edhe kursimet e qytetarëve edhe në denarë", thuhet në raportin e fundit zyrtar të Bankës Popullore të Maqedonisë për 8 muajt e parë të vitit 2017.

Kronikë

## Tetovari shkrep 100 plumba në oborr

Të shtunën mbrëma rreth orës 20.00, në fshatin Saraqinë të Tetovës, 32-vjeçari me iniciale P.P në oborrin e shtëpisë së babait të tij, në gjendje të alkoolizuar, sipas rrëfimit të tij për shkaqe personale, gjegjësisht për shkak të revoltës dhe depressionit ka gjuajtur 100 plumba në ajër nga një pistoletë e markës "Červena Zastava", të kalibrit 9 milimetër, të cilën e ka poseduar me leje. Ekspertizë në vendngjarje ka kryer një ekip hetimorë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, pas çka në oborrin e shtëpisë së tij në toke janë gjetur rreth 50 gëzhoja të kalibrit 9 milimetër, municion për pistoletë, përderisa në dhomën e ndejës së shtëpisë është gjetur një plumb gjithashtu nëntë milimetër, si dhe një pistoletë tjetër vendin e së cilës e ka treguar vet i dyshuari. I dyshuari menjëherë është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policore të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë dhe pas zbardhjes dhe dokumentimit të plotë të rastit do të pasojë edhe padi adekuate.

## Sulm seksual në shtabin e VMRO-së në Debarcë

K.P. nga fshati Trebenisht ka denoncuar përpjekje për sulm seksual nga F.P.M në hapësirat e shtabit të VMRO-së në Komunën e Debarcës. Sipas MPB, rasti është denoncuar mbrëmë rreth orës 20:40. Nuk kumtohet se e cilës parti politike është shtabi, përveç se ndodhet në fshatin Trebenisht.

## Në aeroport me dy plumba në çantë

Një shtetase e Republikës së Serbisë, gjatë ditës së shtunë është arrestuar në aeroportin e Shkupit, pasi gjatë kontrolleve paraprake - në çantën e saj është zbuluar një plumb. Në raportin e ditor të Ministrisë për Punë të Brendshme, thuhet se ngjarja është regjistruar rreth orës 12:00, gjegjësisht para se të fillojë fluturimi nga Shkupi në drejtim të Bazelit. Me këtë rast, siç njoftojnë nga policia e Shkupit, shtetësia serbe S.M, 26 vjeçare, gjatë kalimit të pikës kufitare është paraqitur me letërnjoftim bullgar. "Gjatë kohës së kontrollit të pasaportës, nga ana e shërbimeve të aeroportit, në çantën e dorës të shtetases serbe janë zbuluar dy plumba dhe se dikush me qëllim ia ka vendosur në çantë", thuhet në raportin e policisë. Ndryshe, me qëllim zbardhjen e rastit, shtetases serbe nuk i është lejuar kalimi i pikës kufitare në aeroportin e Shkupit dhe të njëjtës ia janë marrë dy plumba e gjetur në çantë.



Lojërat e fatit në Maqedoni

Sipas hulumtimit të fundit të ESPAD, projektit evropian që analizon dukuritë negative në shkollat e mesme në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian si dhe shteteve të tjera evropiane, Maqedonia së bashku me ish shtetet e Jugosllavisë, Finlandën dhe Greqinë ka më shumë kumarxhinj ndër të rinjtë në Evropë

Koha Fiskik PASHOLLI

Shkup, 8 tetor - Mbi 14 për qind apo një e shtata e nxënësve të moshës 16 vjeçare në Maqedoni luajnë kumar për të holla. Ato më së shumti luajnë në bastoret sportive, letra si brixh apo poker dhe kanë provuar fatin për të fituar më shumë në aparatet elektronike në kazino.


Sipas hulumtimit të fundit, ESPAD, projekt evropian që analizon dukuritë negative në shkollat e mesme në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian si dhe shteteve të tjera evropiane, Maqedonia së bashku me ish shtetet e Jugosllavisë, Finlandën dhe Greqinë, ka më shumë kumarxhinj ndër të rinjtë në Evropë. Hulumtimi në Maqedoni është realizuar në periudhën mars-qershor të vitit 2015, në 82 shkolla të mesme, me ç'rast janë anketuar 4,739 nxënës, ku 2,430 prej tyre kanë qenë të moshës 15 dhe 16 vjeç.

### Prin Greqia

Edhe pse kumarit është i ndaluar në Maqedoni për të rinjtë nën 18 vjeç, megjithatë hulumtimi tregon se ai është mjaft prezent tek djemtë e rinj që luajnë bixhoz për para në internet, por edhe në mënyra të tjera. Sipas studimit të organizatës ESPAD, që merret me hulumtimin e devijimeve në sjellje të fëmijët shkollor, edhe pse Maqedonia me 14 për qind të popullatës rinore që luan kumar bën pjesë në mesataren evropiane, megjithatë si shtet me këtë përqindje bëjmë pjesë ndër 11 shtetet e para për kumarin rinor, nga 33 shtete sa renditen në hulumtim. Përqindje më të ulët se Maqedonia ka Shqipëria dhe Portugalia me nga 8 për qind, kurse Austria, Ukraina dhe Norvegjia me nga 7 për qind.

Malta me 5 për qind renditet shteti i parë në Evropë sipas popullatës rinore që luan më pak bixhoz. Vendin e parë në Evropë, sipas rinitë që luan kumar, me 30 për qind, e mban Greqia, pas saj është Mali i zi dhe Qiproja me 23 për qind dhe Finlanda me 20 për qind. Lartë renditen edhe

# Nxënësit, kumarxhi me 16 vjet



Slovenia me 21 për qind, Kroacia me 19, Bullgaria me 18 për qind dhe Franca me 17 për qind. "Edhe pse numri më i madh i të rinjve ka deklaruar se merret me sport, megjithatë dy të tretat e të rinjve janë për çdo ditë në internet, ndërsa brengos fakti se 13.6 për qind e nxënësve kanë deklaruar se kanë luajtur kumar për para në vitin 2015, ku më së shpeshti apo 16.2 për qind bëhet fjalë për luajtjen bast në bastoret sportive, 10.8 për qind kanë luajtur letra, lotari apo bingo dhe 4.8 për qind kanë luajtur në slot makineritë", thotë autorja e raportit për Maqedoninë, Silvana Onçeva nga Instituti për Shëndet Publik.

Raporti më tej thekson se është brengosës edhe gjendja e kumarit në internet, ku Maqedonia renditet ndër shtetet e para që kryesojnë listën lidhur me këtë dukuri negative. Të rinjtë në Maqedoni, së paku një herë në muaj, kanë luajtur kumar, edhe atë makina me pemë apo slot (3.5 për qind), brixh apo poker (7.7 për qind), bingo (5.9 për qind), bastore sportive apo bastore me kafshë (6.5 për qind). Psikologët dhe sociologët thonë se të rinjtë dhe atë para së gjithash popullata adoleshente, është më e prekshme për shkak se akoma është e ndërntuar si

personalitet i rritur dhe i pjekur që mund të sjellë vendime mirë të menduara dhe të përgjegjshme. Nga ana tjetër, ata më nuk konsiderohen fëmijë, andaj edhe sillen si të rritur. Ekspertët vlerësojnë se nga të rinjtë shumë pritet në rrugëtimin e tyre jetësor plot me sfida. Gjithashtu, problemet në të cilat hasin të rinjtë, si mania e bastoreve dhe kumarit, nuk janë aspak për të nënçmuar, shtojnë ekspertët. Është koha, porosisin ekspertët, që hulumtojnë sjelljen rinore dhe t'i kushtohet më shumë vëmendje nga shoqëria problemit të kumarit të të rinjve, që mendojnë se me investimin e shumave të vogla do të fitojë shumë të holla dhe do të blejë fatin. Sociologët thonë se nëse flasim për një kontekst më të gjerë shoqëror, atëherë mund të themi se për këtë dukuri brengosëse për të rinjtë, fajin e kanë më shumë segmente të shoqërisë, ndërsa në përgjithësi pak kush mban llogari për të rinjtë.

### Fajtorë, familja, sitmi arsimor...

Sipas profesorit të sociologjisë, Ilija Acevski, që në fillim duhet theksuar se jo të gjithë të rinjtë janë të përfshirë nga kjo dukuri negative, megjithatë edhe nëse flasim në shifra, edhe

kjo përfshirje kaq e madhe e të rinjve që luajnë kumar, megjithatë paraqet një problem serioze për shoqërinë tonë. Sipas tij, për këtë dukuri negative, e kanë fajin më shumë faktorë, duke filluar nga familja, sistemi arsimor, sistemi i mediave e kështu me radhë.

"Kemi një krizë të madhe në shoqëri jo vetëm materiale, por edhe shpirtërore. Një pjesë e prindërve shpesh edhe nuk e dinë se ku janë dhe me çka merren fëmijët e tyre, në shkolla shpesh të rinjtë i trajtojnë si kope dhe jo si subjekte individuale, ndërsa ndodh që bastoret nuk dënohen apo edhe nuk mbyllen, edhe pse ju lejojnë të miturve të luajnë kumar. Nga ana tjetër, nga temat e mëdha qoftë etnike, politike, apo partiake, sikur e kemi harruar rininë si vlerë dhe potencialin më të madh për të ardhmërinë e një shoqërie dhe sikur interesat individuale kanë mundur interesin e përgjithshëm. Me fjalë të tjera, kemi humbur vlerat e vjetra dhe shumë rëndë po ndërtojmë vlerat e reja, sipas të cilave duhet të udhëhiqen dhe edukohen të rinjtë", thekson Acevski. Një problem më vete është edhe mungesa e shembujve pozitiv në shoqëri se si arrihet suksesi, ndërsa nga ana tjetër, shpesh

### ILUJA ACEVSKI

"Kemi një krizë të madhe në shoqëri jo vetëm materiale, por edhe shpirtërore. Një pjesë e prindërve shpesh edhe nuk e dinë se ku janë dhe me çka merren fëmijët e tyre, në shkolla shpesh të rinjtë i trajtojnë si kope dhe jo si subjekte individuale, ndërsa ndodh që bastoret nuk dënohen apo edhe nuk mbyllen, edhe pse ju lejojnë të miturve të luajnë kumar



itet që kanë për qëllim parandalimin e problemit të kumarit, siç janë borboret, problemet psikologjike dhe pozita jo e volitshme shoqërore. Hulumtimi ESPAD rekomandon se duhet të ndihmohet dhe mbështetet bota krijuese e nxënësve gjatë kohës së lirë, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve sportive dhe kulturore, promovimit të shëndetit dhe të qenit i përgjegjshëm.

Duhet të ndërmerren më tepër aktivitete parandaluese, edhe për shkak se adoleshentët janë më të ndjeshëm ndaj bashkëmoshatarëve të tyre, andaj edhe vetë nxënësit e shkollave duhet të angazhohen për të luajtur rol aktiv në të tilla aktivitete. Stafii i shkollave duhet të përfshihet shumë më tepër në drejtim të mesazheve që promovojnë shëndetin midis adoleshentëve.

Mediat sociale zënë një pjesë shumë të konsiderueshme të aktiviteteve të përditshme të adoleshentëve, duke shërbyer si një burim potencial për një sërë sjelljesh të rrezikshme për ta, por njëkohësisht duke shërbyer edhe si një mundësi e mirë për informim dhe promovimin e shëndetit. Niveli i lartë i pjesëmarrjes në lojërat online ku fitohen para, kërkon monitorimin e kujdesshëm të këtij fenomeni nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të përshtatshme dhe forcimit e kontrollit dhe legjislacionit thekson ESPAD. Ndryshe, hulumtimet e Qendrës për hulumtimin e politikave, tregoi se pjesa më e madhe e qytetarëve që shkojnë në bastore janë rinjtë, por nuk mbesin mbas as më të moshuarit dhe atë me status të rrezikuar social. Hulumtimet treguan se bile 72 për qind e qytetarëve shkojnë në bastore për shkak të gjendjes jo të volitshme ekonomike, gjegjësisht të mungesës së mjeteve financiare.

Gjithashtu, të dhënat tregojnë se qytetarët në Maqedoni, për të dalë nga problemet financiare, për çdo vit harxhojnë më shumë se 200 milionë euro. Këtë e dëshmojnë edhe raportet financiare të bizneseve më të mëdha, sipas të cilave, ndër 200 firmat me të ardhura më të mëdha në Maqedoni, renditen edhe gjashtë biznese të lojërave të fatit.

Gjashtë bizneset e bastoreve sportive dhe kazinove në vitin e kaluar kanë pasur qarkullim prej afër 200 milionë euro, gjegjësisht qytetarët kanë harxhuar afër 200 milionë euro në shpresë se do dalin prej problemeve financiare.

### Lojërat e fatit mjaftë profitabile

Grupi ESPAD thekson brengosjen, për shkak të rritjes së popullaritetit të luajtjes së lojërave të internetit dhe kumarit ndër të rinjtë, duke theksuar se edhe masat me prior-





Konferencë ndërkombëtare

# Medresetë në kohën e sotme



Shkup, 8 nëntor - Nën organizimin e Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC), në bashkëpunim me Qendrën për Studime të Avancuara (CNS) - Sarajevë dhe Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, u mbajt konferenca e tretë ndërkombëtare me temë "Medresetë shqiptare në kohën e sotme: kurrikulat dhe tekstet shkollorë", në të cilën morën pjesë profesorë, akademikë, punonjës të arsimit islam si dhe përfaqësues të bashkësive islame nga Maqedonia dhe rajoni.

Me këtë rast, përmes shqyrtimit të temave të ndryshme si dhe përmes mjaft debateve konstruktive u shpalosën sërë problemesh, duke evidentuar zhvillimet e aspekteve të ndryshme të mendimit islam të shqiptarët, gjenden aktuale, sfidat me të cilat përballlet dhe perspektivat e saj.

Drejtor i AIITC-së, Prof. Dr. Ramiz Zekaj, në hapjen e konferencës tha se Konferenca e Ohrit syn-

on të trajtojë dhe analizojë në mënyrë shkencore dhe të zgjeruar kurrikulat dhe tekstet shkollorë në medresetë e hapësirës shqipfolëse, por edhe më gjerë në rajonin e Ballkanit. "Medresetë kanë qenë, janë dhe mbeten institucionet arsimore islame me traditën më të gjatë të mësimdhënies së rregullt në planin fetar e kombëtar dhe që mbajnë në bankat e tyre numrin më të madh të nxënësve e studentëve të interesuar për edukim islam", ka nënvizuar Zekaj.

Ndërkaq, kreu i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, deklaroi se medresetë në hapësirat shqiptare të Ballkanit, kanë luajtur veç të tjerash edhe rolin e kalitjes së personaliteteve që kanë lënë gjurmë të pashlyshme fetare dhe kombëtare.

Në fund të fjalës së rastit efendi Rexhepi, tha: "do të isha lutur që, nga kjo konferencë ndërkombëtare, të dalë edhe një përfundim, si iniciativë

për themelimin e një trupi, të një zëri fetar e kombëtar që do të artikulohej nga udhëheqësit e Institucioneve tona fetare deri te qeveritë tona aktuale për ta pranuar si domosdoshmëri të patjetërsuar nevojën e akreditimit të medreseve tona si shkolla të mesme shtetërore që prodhojnë kadro profesionale për nevojat fetare të popullatës sonë. Ne, si shoqëri, nuk guxojmë që edhe më tej të veprojmë si "shoqëri private". Akreditimi i shkollave tona të mesme, me të gjitha specifikat e veta, me të gjitha dallimet dhe lëndët e veçanta, duhet të konceptohen si vlera të pamohueshme në sistemin e gjithmbarshëm arsimor. Kjo është sfida prioritare, kujtoj unë, që urgjentisht duhet ta tejkalojmë.

Vlen të theksohet se kjo konferencë dy ditore ishte e ndarë në gjashtë sesione në të cilat njohës dhe profesorë universitar të shkencave islame nga vendi dhe rajoni debatuan mbi medresetë midis së kaluarës dhe të sotmes, metodat e mësimdhënies

Përmes shqyrtimit të temave të ndryshme si dhe përmes mjaft debateve konstruktive u shpalosën sërë problemesh, duke evidentuar zhvillimet e aspekteve të ndryshme të mendimit islam të shqiptarët, gjenden aktuale, sfidat me të cilat përballlet dhe perspektivat e saj

në medresetë shqiptare, si dhe çështje të tjera të kurrikulave të lëndëve fetare islame.

Në këto sesione u trajtuan tema si: Profili dhe niveli arsimor i medreseve për tregun e punës, Zhvillimi i Medresesë Isa Beu në përputhje me nevojat e kohës, Edukimi islam në Evropë: eksperiencia e medreseve në Bosnje, Mesatarizmi dhe vlerat e bashkëjetesës paqësore në kurrikulën e medresesë Isa Beu -Shkup, raporti i lëndëve fetare dhe atyre laike në medresenë Alaudin Prishtinë. Disa çështje në kurrikulat dhe tekstet në medresetë shqiptare sot, Medreseja e Isa Beut si ripërtëritje e traditës arsimore institucionale islame, (Mos)prezantimi i gruas muslimane në tekstet e medreseve dhe fakulteteve tona, Masat e dhunshme kundër mejtepeve dhe medreseve në trevat shqiptare në RS të Maqedonisë 1945-1984 etj. Ligjërues ishin akademikë, profesorë e shkencëtar nga viset etnike shqiptare, si dhe nga vendet myslimane në rajon.

"Pelisterka" arsyetohet për numrin e vogël të punonjësve shqiptarë



## Nga 90 të punësuar, vetëm katër shqiptarë!

"Dëshmi se kompania 'Pelisterka' njëjtë i vlerëson edhe maqedonasit edhe shqiptarët, por edhe të gjithë konsumatorët tjerë të ujit tonë, janë edhe aktivitetet tona të marketingut. Të gjitha reklamat tona, si panotë apo edhe video-materialet, flaerat... publikohen edhe në gjuhën shqipe. Në kalendarin tonë tradicional, i cili shërben si material promovues, njëra nga yjet ishte edhe këngëtarja shqiptare, Adelina Tahiri...", thotë Pandeleska

Shkup, 8 tetor - Arsyja pse në fabrikën për prodhimin e ujit "Pelisterka" në fshatin Mexhitli nuk ka shumë të punësuar punonjës shqiptarë është se, interesimi i vogël dhe se njëkohësisht, nuk ka persona të kualifikuar për punë në fabrikën që gjendet në fshatin e banuar me shqiptarë. Kështu është arsyetuar Tanja Pandeleska, drejtore e marketingut në kompaninë "Pelisterka", ndërsa pranon se nga 90 të punësuar në këtë fabrikë, vetëm katër janë shqiptarë, ndërsa pjesa tjetër maqedonas dhe pak nga etnitet tjera. "Kompania jonë nuk punëson në bazë të etnitetit, por në bazë të kualifikimeve, shkollimin e mbaruar dhe dëshirën për punë. Numri më i madh i banorëve të fshatit Mexhitli, kanë pasur mundësi të punojnë. Ata, të cilët kanë pasur kualifikim adekuat, këtë mundësin e kanë shfrytëzuar. Për të tjerët, fabrika gjithmonë ka siguruar punë sezonale, ndërsa të njëjtit kanë marrë honorare të caktuara", thotë Pandeleska, sipas të cilës, midis bashkëpunëtorëve

sezonal të fabrikës, ka edhe shqiptarë nga rajone tjera të Maqedonisë dhe jo vetëm nga fshati Mexhitli, aty ku gjendet fabrika "Pelisterka". "Në 64 vitet e ekzistimit të kompanisë sonë, ekipi i punonjësve janë nga të gjitha nacionalitetet. Sidomos në fshatin Mexhitli. Aktualisht, në fabrikën me 90 punonjës, janë të punësuar katër shqiptarë, të cilët punojnë për më shumë se 40 vite, siç është rasti me Usein Banu-shevskin, i cili në këtë fabrikë punon për 43 vjet me radhë", arsyetohet Pandeleska. Si dëshmi se "Pelisterka" nuk bën diskriminim në punësimin e shqiptarëve, Pandeleska përmend një fakt interesant, të cilin ajo e konsideron si "përfaqësim" të punonjësve shqiptarë. "Dëshmi se kompania 'Pelisterka' njëjtë i vlerëson edhe maqedonasit edhe shqiptarët, por edhe të gjithë konsumatorët tjerë të ujit tonë, janë edhe aktivitetet tona të marketingut. Të gjitha reklamat tona, si panotë apo edhe video-materialet, flaerat... publikohen edhe në gjuhën shqipe. Në kalendarin tonë tradicional, i cili shërben si material promovues, njëra nga yjet ishte edhe këngëtarja shqiptare, Adelina Tahiri. Ndërsa në periudhën që vijon, do të kemi bashkëpunim promovues edhe me sportistë dhe aktorë shqiptarë", thotë Pandeleska. Ndryshe, ditë më parë, banorë të fshatit shqiptar Mexhitli u ankuan se, që nga themelimi i kësaj fabrike, numri i shqiptarëve që punojnë aty është tejet i vogël, për të mos thënë asnjë. (Q.H)

## "Skupi festival" me prurje cilësore



Shkup, 8 tetor - Të enjten (12 tetor) më Shkup fillon edicioni i njëmbëdhjetë i Festivalit ndërkombëtar të teatrit, Skupi Festival. Me moton për SHPIRT TË SHËNDETSHËM, Skupi Festival, që do të zgjasë deri më 18 tetor, edhe sivjet pritet të ketë prurje interesante. Organizatorët thonë se kanë bërë një seleksionim mjaft të cilësor, ndërkaq për këtë gjithësesi do të binden vetë art-

dashësit. Përveç shfaqjes nga Shqipëria e cila do të shfaqet në Suli Han të Çarshisë së vjetër të Shkupit, të gjitha shfaqjet tjera do të mund të ndiqen Qendrën kulturore të rinjve (në afërsi të RTVM-së dhe Akademisë së Shkencave). Këtë vit në festival, për shfaqjes nga Shqipëria, do të marrin pjesë edhe teatro nga Kosovë, Izrael, Serbi, Iran, Rusia, dhe Bullgaria.

## Në mënyrë drastike zvogëlohen nivelet e disa lumenjve

Shkup, 8 tetor - Nivelet e lumenjve Drini i Zi në Lozhan dhe i Varadarit në Jegunoc janë pesë herë më të ulëta se mesatarja për tetorin, tregon matja e sotme hidrologjike e DPHM.

Zvogëlime të nivelit të ujit shënohen edhe në

Vardar në Zajcev Rid, Cërna Reka në Novaci, Sateska në Botun, Kriva Reka në Kriva Pallankë, Treska në Makedonski Brod dhe Pčinje në Banjën e Katllanovës. Nivel më të lartë se mesatarja për tetorin është shënuar vetëm në Vardar në

Demir Kapi dhe në lumin Bregallnicë në Berovë. Sipas DPHM, niveli i Liqenit të Dojranit përsëri është rritur prej 82 centimetra aq sa është mesatarja për tetorin, në 174 centimetra, ndërsa Liqeni i Ohrit është nën mesataren.

Publicitet

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira për shkollat fillore nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014 të sjellë nga MASH, SHFK "Petar Zdravkovski - Penko" Shkup publikon

**SHPLLJE PUBLIKE**  
Për grumbullimin e ofertave

SHFK "Petar Zdravkovski - Penko", Butel - Shkup, rr. "Vtora Makedonska Brigada" pn, tel. 2616-859, organizon ekskursione dhe aktivitetet tjera të lira gjatë vitit shkollor 2017/2018, në pajtim me Programin për aktivitetet e theksuara.

Ftohen ofertuesit e interesuar të parashtrijnë oferta sipas dokumentacionit që mund të merret në objektin e shkollës deri më 16.10.2017 prej ora 8.00 deri në ora 14.00 tek sekretari i shkollës.

**DREJTOR**  
Enis MEHMED



Komuna e Kumanovës  
Vetëqeverisja lokale

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim ka sjellë

## LAJMËRIM

Lajmërohen të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Komunës së Kumanovës se shpallet  
**Thirrje publike për dorëzimin e iniciativave për përpilim të Planeve urbanistike**

Thirrja publike shpallet në pajtim me nenin 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16), në kuartalin e tretë të vitit 2016.

- **Thirrja publike do të zgjasë prej 09.10.2017 deri më 08.11.2017 – 31 ditë** duke llogaritur me ditën e publikimit.
- **Thirrja publike do të shpallet** në lajmëtarin zyrtar të komunës, në ueb faqen e komunës [www.kumanovo.gov.mk](http://www.kumanovo.gov.mk), në tabelën për shpallje të komunës, në sistemin informativ e-urbanizam, në gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gazetë ditore në gjuhën shqipe.
- **Gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes publike** të gjithë subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund të dorëzojnë iniciativë për përpilim dhe sjellje të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika (2) alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16).
- **Lënda e iniciativës** mund të jetë sjellja e planit të ri urbanistik ose ndryshim dhe plotësim i planit ekzistues urbanistik me arsyetim për ndryshimin e kërkuar dhe propozim të përfshirjes planore nga parashtruesi i iniciativës.
- **Subjektet e interesuara juridike dhe fizike** iniciativat ti dorëzojnë në pajtim me nenin 21 paragrafi (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16).
- **Mjetet për iniciativat e pranuar** për përpilim të dokumentacionit të nevojshëm duhet të sigurohen nga vet parashtruesit e iniciativave.

Nr. 21-6810/1  
Data 04.10.2017

Kryetari i Komunës  
së Kumanovës  
Zoran Damjanovski

KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
GOSTIVAR BELEDIYESI



[www.gostivari.gov.mk](http://www.gostivari.gov.mk)  
[info@gostivari.gov.mk](mailto:info@gostivari.gov.mk)  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-108/13  
06.10.2017 vit  
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 и 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

### LAJMËRIM

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik të përfshirë në hapësirën e Propozim **PDU-së për Bllok 13, KK Gostivar 2** - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e :

#### PREZENTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Rreth Propozim **PDU-së për Bllok 13, KK Gostivar 2**- Komuna e Gostivarit për periudhën e planit **2017-2022**, sipërfaqja e përfshirjes ( **22.522 Ha**), që kufizohet në mes rrugëve:

- Nga ana veriore për rr. “ Zhivko Brajkovski ” ,
- Nga ana jugore për rrugës së re të projektuar “ 11 ” sipas PGJU-së të qytetit të Gostivarit,
- Nga ana lindore me rr. ” Branko Stanoeviq ” dhe
- Nga ana perëndimore për rrugës së re të projektuar “ 12 ” sipas PGJU-së të qytetit të Gostivarit .

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. **12.10.2017 (e enjte ) në ora 12.00.**

Propozim **PDU për Bllok 13, KK Gostivar 2** - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 10 ditë pune edhe atë nga **13.10.2017 vit deri 27.10.2017 vit.** çdo ditë pune prej orës **08.00-16.00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridik dhe fizik nga zona konkrete të përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrorjnë vërejtje me shkrim në fletat anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës  
Nevzat Bejta

### SHPALLJE PËR ANGAZHIMIN E KONSULTANTIT PËR REALIZIMIN E HULUMTIMIT NË KUADËR TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT PËR MBROJTJE JURIDIKE NË LIDHJE ME AZILIN DHE NATYRALIZIMIN” MBËSHTETUR NGA UNHCR

Avokati i Popullit, i mbështetur nga zyra e Komisionarit të Lartë për Refugjatë të KB-së, UNHCR-së për nevojat e projektit “Përmirësimi i sistemit për mbrojtje juridike në lidhje me azilin dhe natyralizimin” ka nevojë për angazhimin e konsulentit (një person) për realizimin e hulumtimit.

Kandidati i përzgjedhur duhet të bëjë hulumtim me temë: “Integrimi i refugjatëve të kosovar, zgjidhjet e përhershme dhe kthimi vullnetar” sipas udhëzimeve dhe orientimeve të dhëna nga Avokati i Popullit/Mekanizmi Parandalues Nacional. Draft versioni nga hulumtimi duhet të përgatitet dhe dërgohet pranë Avokatit të Popullit/Mekanizmit Parandalues Nacional më së voni deri më datën 13 nëntor të vitit 2017. Konsulentit do të prezantohet hulumtimin në Konferencën rajonale e cila do të mbahet më datë 20 dhe 21 nëntor të vitit 2017.

Kualifikimet e nevojshme:

- Të ketë kryer arsim të lartë nga sfera e shkencave juridike, politike ose shoqërore
- Të ketë përvojë pune nga sfera e azilit, migracionit dhe refugjatëve
- Të ketë njohuri lidhur me problematikën dhe politikën e natyralizimit të refugjatëve dhe kthimin vullnetar në rajon

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë letër për interesim të shprehur dhe biografi të shkurtër.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dërgohet në e-mail adresën e mëposhtme: [sdimitrievska@ombudsman.mk](mailto:sdimitrievska@ombudsman.mk) me shenjën në Subject “Konkurs për konsulent”.

Afati i paraqitjes është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të konkursit në gazetë ditore (duke mos e llogaritur ditën e publikimit), përkatësisht deri më datën 17 tetor në orën 16:00.





## Ana malazeze e Bjeshkëve të Nemuna



# Bukuria që të jep qetësi të jashtëzakonshme

**Me maja të thikta në dukje kërcënuese, liqene të kaltra dhe një ari rastësor, një alpinist eksploron anën malazeze të Bjeshkëve të Namuna, një prej sekreteve më të mirëmbajtura të Ballkanit**

Sërgjan GARÇEVIÇ

Të njohur si "Të Namuna" në shqip dhe serbo-kroatisht, është e lehtë të kuptohet përse këto vargmale të padepërueshme të Bjeshkëve të Nemuna (Prokletije) kanë marrë këtë emër. Majat ogurzeza, të bardha me akullnaja masive ende mbajnë mbetjet e lumenjve të mëdhenj akullnajorë. Por këtu, pas zigzagut në Shqipërinë e veriut, Kosovë dhe ver-

ilindje të Malit të Zi, ku mund të gjendet një nga panoramat më të egra dhe më mbresëlënëse të rajonit.

Unike në Ballkan, luginat e saj të sheshta janë të rrethuara nga majat e larta dhe që i ngjajnë Dolomitëve italianë, gjë që i ka dhënë një tjetër pseudonimin: Alpet shqiptare ose malazeze.

Por ndryshe nga Alpet italiane, malet e Nemuna nuk janë të tejmbushura me alpinistë. Pavarësisht një nxitje turistike së fundmi, veçanërisht nga operatorët shqiptarë, alpinistët preferojnë ta bëjnë rrugën vetë. Dhe tani që pjesa jugore e vargmalit është në Via Dinarica, një udhëtim prej 1,931 kilometrash që ndërthurur së bashku shtatë vende, Alpet malazeze janë bërë edhe më tërheqës për entuziastët e natyrës.

Qyteti Gusinjë është

një bazë e mirë për të eksploruar zonën. Megjithëse merr shtatë orë me makinë nga Beogradi, ia vlen pasi gjarpëron krah lumit Ibar me fortesën mesjetare Maglic, Novi Pazari të periudhës osmane dhe Kishës së Shën Pjetrit që është në UNESCO. Nëse fluturonit në Podgoricë, është vetëm dy orë larg me makinë.

Me të mbërritur në Gusinje, një qytet me më pak se 5000 banorë, dy luginat fantastike shtrihen në anën malazeze të alpeve: Grebaja dhe Ropojane.

Lugina Grebaja shtrihet plotësisht brenda Parkut Kombëtar "Prokletije" dhe është e rrethuar nga Karanfil, një seri majash skeletore më shumë se 2000 metra mbi nivelin e detit, me disa nga shkëmbinjtë më impresionues të Ballkanit. Disa fshatra të vegjël tradicional përgjatë shtigjeve

ofrojnë strehim dhe mundësi për të shijuar versionin lokal të gatimit të famshëm të malit, kaçamakut – polentës, e mbytur në djathë vendas, qumësht dhe kajmak ballkanik.

Rruga nis nga lugina dhe gjarpëron duke kaluar tre maja përballë Karanfil: Volusnica, Talijanka dhe Popadija. Edhe një alpinist në formë dhe i moderuar duhet të përgatitet për sfidën.

Duhet rreth shtatë orë për të përfunduar shtegun, përfshirë ndalesat e pushimit. Duke kaluar së pari nga një pyll i dendur, rruga pastaj kalon nëpër male të pjerrëta të mbuluara me shkurre. Në çdo pikë, ka panorama mah-nitëse të Malit të Zi dhe Shqipërisë së Veriut ku pika më e lartë, 2056 metra mbi nivelin e detit shtrihet në kufirin malazez-shqiptar.

Vizita në mes-shtatori,

bën që vetëm një ari të na shoqërojë nëpër pyll për këtë ditë.

Rreth 40 minutat me makinë nga Grebaja duken më pak dramatike, megjithatë mbi ne gjenden maja të thikta që varen mbi luginën Ropojane. Pikat kryesore janë lumi i freskët Skakavica që kalon nëpër një pyll të dendur. Hyrja e luginës shënohet me një shkëmb të magjishëm, që ka formë të gdhendur nga lumi. Një shteg i mirë ndjek ujin deri në majën magjike të njohur si Syri i Skakavicës. Këtu ndodhet dhe pellgu i lumit me ujë të kaltër, në mes të pyllit. Megjithëse romantik dhe paqësor në vjeshtë, në pranverë Syri i Skakavicës kthehet në dramatik prej ujërave që rrjedhin nga shkëmbinjtë përreth. Kjo ecje është e thjeshtë dhe merr një orë.

Megjithëse këto dy ngjitje do t'ju japin një shi-

je të mirë të anës malazeze të Bjeshkëve të Nemuna, ka shumë adrenalina të tjera që mund të përfitoni nëse keni më tepër kohë. Për dy orë në lindje të Gusinjës është Liqeni Hrid, një mundësi e mirë për ata që kacavirren në shkëmbinj. Me pak ditë në avantazhin tuaj, mund të hidheni në anën shqiptare për alpeve për t'i shijuar më mirë.

Pavarësisht distancës së largët të Alpeve Shqiptare ose Malazeze, ato përbëjnë një vizitë të domosdoshme për të pasionuarit e natyrës në Ballkan. Edhe nëse nuk jeni një alpinist i kalitur, bukuria e tyre do t'ju bëjë të ndjeni një qetësi të jashtëzakonshme nga jeta e përditshme. Ju mund ta vizitoni anën malazeze të Alpeve deri në fund të tetorit, sa është ngrohtë, pasi prej andej dëborat blikon çdo gjë deri në maj.



# Rreth çështjes së rendit të ri botëror



Dr. Vasil KURETA

Pas rrëzimit të komunizmit, sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare filloi një cikël të ri ndryshimi. Ishin ndryshime të pritshme. Periudha pa përballjen mes dy sistemeve të kundërta, evidentoi SHBA si superfuqia e vetme, që bashkë me aleatët europianë kontribuan në mbrojtjen e stabilitetit e sigurisë së rendit botëror. Element karakteristik u shfaq tërheqja e Rusisë në një partneritet në kuadër të NATO-s, që funksionoi fillimisht, por që shpejt u konstatua se Rusia ndiqte një strategji konkrete për një rol e status superfuqie botërore, që nuk vonoi të shfaqej. SHBA, duke realizuar përgjegjësitë e saj për garantimin e stabilitetit të rendit botëror, deklaroi e argumentoi qëndrimin apo nevojën e bashkëpunimit me aktorë të tjerë të rëndësishëm botërorë, që dukej se funksionoi. Megjithatë, shpejt u evidentua strategjia e Rusisë, veçanërisht për të mundësuar statusin e një superfuqie botërore, që shfaqej në një bashkëpunim konkret me Kinën e ku jdesshme, që ndiqte edhe ajo rrugën e vet karakteristike në plotësimin e ambicies së superfuqisë botërore. Element thelbësor i ndryshimeve u shfaq dhe kriza apo ngecja e ecurisë së projektit europian dhe evidentimi i një problematike konkrete bashkëpunimi brenda Perëndimit apo aleancës euroatlantike.

## "AMERIKA FIRST"

Analistë e studiuës të marrëdhënieve ndërkombëtare kishin përcjellë opsionet e tyre për një rend apo botë dy apo multipolare, duke folur tashmë edhe për një rend të ri botëror. Kur Presidenti i ri i SHBA Trump, bëri publike sentencën "America first", tërhoqi vëmendjen e analistëve dhe studiuësve të marrëdhënieve ndërkombëtare. Çështja ishte nëse ndodhemi përpara një doktrine të re, të përpunuar, apo ndodhemi përballë një rritjeje të peshës së nacionalizmit në SHBA, sidomos nën ndikimin e problemeve të brendshme ekonomike e

Analistë e studiuës të marrëdhënieve ndërkombëtare kishin përcjellë opsionet e tyre për një rend apo botë dy apo multipolare, duke folur tashmë edhe për një rend të ri botëror. Kur Presidenti i ri i SHBA Trump, bëri publike sentencën "America first", tërhoqi vëmendjen e analistëve dhe studiuësve të marrëdhënieve ndërkombëtare

sociale. Kishte dhe ka pritishtëmi të lartë, sa i përket konkretizimit të kësaj teze në politikën e jashtme të SHBA, që afekton direkt përmbajtjen e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare e modelin e tij. Që politika e jashtme e SHBA ka në themel të saj interesat e popullit e shtetit amerikan, kjo është e kuptueshme lehtësisht, por me rëndësi të veçantë është çështja e konkretizimit apo ndryshimeve të mundshme, sa i përket vendit, rolit dhe peshës së SHBA në zhvillimet botërore dhe mënyrës së realizimit të saj. Po kështu, rëndësi të veçantë ka të shihet se si do të harmonizohet konkretizimi i kësaj teze me ligjin e të drejtën ndërkombëtare, me rolin e aktorëve të tjerë të rëndësishëm botërorë, apo me aktivitetin e organizmave ndërkombëtarë, ku veçohet OKB; se si do të harmonizohen interesat nacionale me ato ndërkombëtare, se si do të mbrohen sistemi i vlerave, demokracia e sundimi i ligjit nga kërcënimet ekstremiste, antidemokratike e terroriste, por dhe nga kërcënimet natyrore. Po kështu, pritishtëmi të lartë ka se si do të funksionojë Perëndimi në situatën e sotme e në konkretizim të tezës "Amerika first". Kjo lidhet domosdoshmërisht me kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë SHBA në garantimin e stabilitetit e sigurisë së rendit botëror dhe pritishtëmitë aktuale, por që do të ndikojë maksimalisht në përmbajtjen dhe formën që do të marrë rendi botëror, modeli i ri i sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare në periudhën post-komuniste.

Sot konstatohet një problematikë e mprehtë që atakon ndjeshëm stabilitetin, sigurinë, paqen e rendit botëror dhe ardhmërinë e njerëzimit. Fenomene të tilla si gara e armatimit e animi nga përdorimi i fuqisë e forcës



ushtarake, kërcënimet bërthamore dhe aktiviteti i lartë i terrorizmit shumëformësh, dukuria e shtuar e nacionalizmit e tërheqja pas interesave të shtetit-komb, proteksionizmi e antiglobalizmi, ulja e treguesve të zhvillimit ekonomik botëror, thellimi i ndarjeve rajonale sa i përket zhvillimit dhe i pabarazive sociale, pasha e rëndë e efekteve e pasojave të krizës ekonomike botërore e financiare, vatrave e rrezikshme të krizave, prirjet imperiale e ato të mosrespektimit të ligjit e të drejtës ndërkombëtare të mosrespektimit të marrëveshjeve e traktateve ndërkombëtare, dobësimi i ndjeshëm i rolit të organizmave ndërkombëtarë, përfshi dhe OKB e Këshillin e Sigurimit, një "kryengritje" e vërtetë apo presion i shtuar i nacionalizmit e egoizmit nacional, përfshi dhe krizën e BE dhe një problematikë që po e shoqëron atë etj., po bëjnë trysni shqetësuese komplekse ndaj përmbajtjes e standardeve të qëndrueshmërisë së rendit botëror.

## EFEKTET E KRIZËS

Në kushtet kur ka nevojë të madhe për dialog e bashkëpunim, për bashkërendim të kontributeve, dukuria e egoizmit nacional ushqen ndarjet, kontradiktat, frenon e dobëson angazhimin e veprimin e përbashkët, ushqen filozofinë e përdorimit të forcës e fuqisë, ushqen mosrespektimin e ligjit ndërkombëtar e aventurizmin. Koha e sotme dëshmon se filozofia e egoizmit nacional bëhet pronë edhe e aventurierëve politikë, që edhe pse mund të jenë vende të vogla, zotërojnë armë bërthamore. Historia e rrezikshmërisë së lartë të filozofisë nacionaliste, e egoizmit nacional, nuk është shumë larg nesh. Nazizmi dhe fashizmi nuk lënë shteg as për të harruar e as për nënvlefësim e shkujdesje.

Filozofia nacionaliste e përmban mundësinë e lindjes së ekstremizmeve të rrezikshëm që duhen parandaluar me çdo kusht. Efektet e krizës ekonomike e ushqejnë egoizmin e ekstremizmin nacional, mbylljen dhe distancimin nga sistemi i vlerave. Zhvillimet e qëndrueshme ekonomike e sociale janë shumë të rëndësishme, por dhe orientimi nga sistemi i vlerave dhe respektimi i ligjit e të drejtës ndërkombëtare merr vlerë të veçantë. Filozofia e forcës nuk mund të ekzagjerohet, edhe pse, në një moment të caktuar, një veprim konkret apo hap praktik ka vlerë më shumë sesa pasiviteti e dialogu shterp.

Nacionalizmi, në formën e sotme të shfaqjes së tij, përveç tërheqjes nga prioriteti i interesave të shtetit-komb, mbylljes etj., duket se po shfaqet si kundërvënien ndaj sistemit të vlerave, ndaj modelit perëndimor që ushqen, mbështet e materializon në jetë vlerat e solidaritetit, humanizmit, të lirive e të drejtave të njeriut, demokracinë e sundimin e ligjit. Zgjedhjet e fundit në Gjermani dhe rezultati që rezultoi është dëshmi sintetik e fakt me interes që kërkon të analizohet me shumë vëmendje për mesazhin që përmban, jo vetëm në Gjermani, por në gjithë hapësirën europiane e perëndimore, në botën e lirë. Ajo që mund të quhet "ngjarja gjermane" përbën një fakt social e politik që kërkon analizë të kujdesshme, që të ndihmon të njohësh një kontradiktë reale, në zhvillim sot, në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Futja në parlament e një partie të ekstremizmit të djathtë, që hapur atakon modelin e sistemit të vlerave apo ky legalizim demokratik i tyre, nuk mund të anashkalohet apo të shihet thjesht si një zhvillim normal.

Vërtet rezultati që mori partia e Merkel nuk ishte ai që pritej, por në thelb

tregoi se ka lindur një kontradiktë reale, tregoi situatën në të cilën ndodhet ajo dhe vetë modeli perëndimor i sistemit të vlerave. Madje edhe vetë dalja në vend të parë e CDU/CSU, mund të lexohet vetëm si kontribut real i kancelares Merkel në mbrojtje të sistemit të vlerave, por dhe mbështetjen që gëzon ky model në Gjermani. Po kështu, rezultati i SPD, vërtet është në ulje, në raport me pritishtëmitë, por ai nivel që u sigurua, ishte falë pozicionimit të kësaj partie në koalicionin e mbështetje të pozicionit të Merkel në mbrojtje të sistemit të vlerave. Sa u përket ambiciesve politike të kësaj partie e dështimeve politike të saj, ato kanë të bëjnë me çështje të brendshme të saj dhe të situatës në tërësi që kalon social-demokracia europiane në kushtet e sotme.

## DALLGËT E NACIONALIZMIT

Që tashmë ka një kontradiktë reale në pjekje, apo që sistemi i vlerave dhe modeli i tij po luftohet e do të luftohet më ashpër nga kundërshtarë kompleksë e jo vetëm nga format konkrete të nacionalizmit, këtë e dëshmon, jo vetëm një problematikë konkrete në përballjen me egoizmin nacional etj., por edhe futja në parlamentin gjerman, pas 60 vitesh, të një partie të ekstremit të djathtë. Në një farë mënyre kjo situatë e ngritjes së dallgëve të nacionalizmit, ekstremizmit e autoritarizmit në Gjermani, në hapësirën perëndimore e në botë, është pasojë direkte e goditjes së madhe që solli kriza ekonomike e botërore financiare. Ajo u cilësua si një depresion 2, por të mos harrohet se depresioni 1 polli monstrat e nazizmit e fashizmit. Natyrisht që atëherë nuk ekzistonte modeli i ngritur mbi sistemin e vlerave, por kjo nuk lejon asnjë nënvlefësim e shkujdesje, asnjë injorim të historisë dhe shkaqeve që lindin

fenomene të tilla. Pikërisht rezistenca efiçente e sistemit të vlerave dhe mbështetja e gjerë që gëzon, është fakt esencial, por gjithsesi kërkon një shkundje të thellë, për njohjen e përmbajtjes së kontradiktës aktuale e ecurisë së saj dhe për një luftë më të organizuar në mbrojtje të modelit të sistemit të vlerave. E majta europiane sot duket se shfaqet shumë deficitare, sa i përket pasurimit të vizionit në mbrojtje të sistemit të vlerave, që të mund të kthehet në një faktor esencial në zhvillimet politike. Nevojitet të shohë përpara dhe duke njohur mirë stadin aktual të zhvillimit. Nevojitet të mësojë më shumë nga përvoja e partive të djathta, që po mbështesin sistemin e vlerave. Natyrisht që, rol të veçantë luan dhe personaliteti udhëheqësve të tipit "Merkel". Personalitetja e njohur amerikane Klinton ka evidentuar një fakt domethënës e esencial, kur e vlerëson kancelaren Merkel "lideren më të rëndësishme" në dhe për Botën e lirë. Protesta spontane e zhvilluar në Gjermani, pas njoftimit të hyrjes në parlament të partisë së ekstremit të djathtë, është shumë domethënëse, që dëshmon se sistemi i vlerave ka mbrojtës të sigurt popujt.

Siç shihet, zhvillimet e fundit në hapësirën perëndimore, por edhe në botë në tërësi, do ta bëjnë më të mprehtë nevojën për një mbrojtje të mirorrganizuar e efiçente të sistemit të vlerave e modelit aktual të shfaqjes së tij, të demokracisë e sundimit të ligjit. Siç duket, ky model do të jetë në një kontradiktë edhe më të ashpër me modelet ekstremiste, autoritariste, diktatoriale, antihumane e të mbytura nga egoizmi nacional, si të tipit aktual të Koresë së Veriut, por edhe të atyre ku popujt janë në mëshirë të orekseve të vendimmarrjes së "njëshit" politik, që vendos për fatin e jetën e tyre. Demokracia, sundimi i ligjit, sistemi i vlerave, humanizmi e solidariteti, sot ndodhen përballë një lufte të vendosur me autoritarizmin, ekstremizmin, format diktatoriale, egoizmat nacionalë laramanë, që përbën një kontradiktë në zhvillim, që pritet të bëhet më e ashpër dhe më e mprehtë dhe që do të ndikojë direkt në mbushjen e përmbajtjes së sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe sidomos në cilësinë e tij.



## PSZH nuk njih limitet

Sulmuesi brazilian i Liverpoolit, Filipe Kutinjo, është ende në listën e transferimeve të skuadrës "blaugrana", por tashmë për spanjollët ka dalë një rival i ri, Paris Sen Zhermen. Skuadra franceze është vënë në gjurmët e Kutinjos, duke e konsideruar si një përforcim me shumë vlera, madje duke ndërhyrë menjëherë në merkato, për ta sjellë në Paris që në janar. Dhe bisedimet për të sjellë fantazistin brazilian në Liga 1 po i kryen vetë presidenti Nassel Al-Khelaifi. Duket se PSZH kërkon të përfitojë nga situata e krijuar dhe mund të lërë të lirë fanatistin italian Marko Verratti, që kërkohet nga Barcelona.

## Isha afër tërheqjes nga futboli

Lorenzo Insinje ka treguar se ishte shumë afër të tërhiqet nga futboli për shkak të kritikave për gjatësinë e tij. Sulmuesi i Napoli ka thënë se agjentë dhe skaut të shumtë i kishin sugjeruar atij që të hiqte dorë nga futboli, dhe ai pothuajse ishte bindur për këtë gjë, por ekipi i Napoli i riktheu vetëbesimin atij. "Të gjithë më thonin se kisha pak talent, por isha shumë i shkurtër, dhe në një moment mendova se ishte e kotë që të vazhdoja. Pastaj Napoli më ftoi në prova dhe gjithëcka shkoi shumë mirë", është shprehur Insinje. 26 vjeçari është vetëm 1.63m i gjatë, por kjo nuk e ka ndaluar atë që të bëhet një lojtarët kyç në ekipin e 'Napolitanëve'.



Maqedonia në Strumicë pret Lihtenshtajnin

# Hasani: Ta mbyllim ciklin kualifikues me fitore

Na pret ndeshja e fundit e këtij cikli kualifikues ku pa dyshim ne duam ta mbyllim me fitore. Hyjmë me atmosferë shumë të mirë por edhe me një rezultat 1-1 në fushë të Italisë, natyrisht që ka ngritur motivin dhe vetëbesimin në skuadër", thotë për gazetën KOHA, Hasani



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 8 tetor – Përfaqësuesja e Maqedonisë pas barazimit (1-1) të madh kundër Italisë në Torino, sonte në stadiumin "Mladost" në Strumicë do të zhvillon ndeshjen e fundit kualifikues për Kampionatin Botëror, i cili vitin e ardhshëm do të mbahet në Rusi. Djemtë e seleksionuesit Igor Angelovski përballë do të kenë Lihtenshtajnin, në të cilën ata nuk duhet të kenë probleme për të shënuar fitore.

Për këtë sfidë, Angelovski në dispozicion do të ketë të rinjtë, Nikolla Gjorgiev e Elif Elmas, të cilët rikthehet në ekipin senior pas sfidës së zhvilluar për Maqedoninë U21 kundër Serbisë, derisa në kombinim do të jetë edhe Arian Ademi, ndërsa në vend të Velkoskit të lënduar, pritet të luajë Kire Markoski, i cili mungoi për shkak të kartonëve në sfidën ndaj Italisë në Torino kurse për shkak të kartonëve të verdhë do të mungojë Stefan Spirovski. Njëri prej katër

futbollistëve shqiptar që ishte pjesë e barazimit historik ndaj Italisë, Ferhan Hasani për gazetën KOHA thotë se përballjen e fundit ndaj Lihtenshtajnit ta përmbyllim me fitore. "Na pret ndeshja e fundit e këtij cikli kualifikues ku pa dyshim ne duam ta mbyllim me fitore. Hyjmë me atmosferë shumë të mirë por edhe me një rezultat 1-1 në fushë të Italisë, natyrisht që ka ngritur motivin dhe vetëbesimin në skuadër. Përkundër faktit që luajmë me Lihtenshta-

jnin, mendoj që nuk do të jetë ndeshje e lehtë sepse kësaj radhe ne do të duhet të krijojmë raste, të bëjmë lojën dhe të shënojmë fitore. Respektojmë ata si gjithë të tjerët. Do të dalim të bëjmë maksimumin me shpresë se fitorja dhe tre pikët do të vijnë me një lojë tjetër të bukur, që do të jetë një motiv për të ardhmen", deklaroi Hasani. Fitore ndaj Lihtenshtajnit shpreson edhe i riu Elif Elmas. "Është një nder që të jesh në mesin e këtyre futbollistëve. E dini që luajtëm në mënyrë të shkëlqyeshme kundër Italisë dhe arkëtuam një pikë të madhe dhe tani duhet të përballemi me Lihtenshtajnin, ku ne jemi në rolin e favorittit. Shkojmë që të shënojmë fitore, si edhe në çdo takim tjetër dhe shpresojë se në Strumicë do të jemi më të mirë dhe do të arkëtojmë 3 pikët", tha Elmas. Përballja Maqedonise Lihtenshtajni, do të zhvillohet sonte (e hënë) në orën 20.45 në stadiumin "Mladost" në Strumicë.

Përfundoi edicioni i 14 "Struga Open 2017"

## Përfaqësuesja e Kosovës më e mira, "Forca" e dyta



Shkup, 8 shtator – Të shtunën nën organizimin teknik të KK "Drini" nga Struga u mbajt turniri në karate "Struga Open 2017". Qyteti buzëdrinit u zburua nga ngjyrat e veshjeve sportive nga rreth 500 sportistë, 55 klube të cilët kishin ardhur nga pesë shtete të ndryshme si Shqipëria, Kosova, Austria, Mali i zi dhe klubet nga Maqedonia. Për të nderuar këtë aktivitet, prezent ishte kreu më i lartë i Federatës së Karatesë së Maqedonisë Dragan Stojanovski, kryetari i Federatës së Karatesë së Shqipërisë Petrit Baba, sekretari i Federatës së Karatesë së Kosovës Nazmi Gashi, përfaqësues nga Mali i Zi Skënder Tahiri si dhe shumë personalitete të tjerë.

në numër më të madh me sportistë. Ata në këtë aktivitet u paraqitën si përfaqësues e Kosovës, por nuk munguan edhe klubet nga mbarë Kosova. Hajredini gjithashtu falënderoi edhe klubin nga Austria të cilët ishin prezent për herë të parë në këtë turnir.

Organizatori në fund ndau edhe mirënjohje dhe plaketa për të gjithë ata që ishin prezent. Mirënjohje u ndanë edhe për sponsorët dhe mediat e këtij evenimenti kaq të rëndësishëm, pa të cilët do të ishte e pa mundur ky aktivitet. Për të gjithë sportistët u ndanë medalje, diploma dhe kupa për katat ekipe. Gjithashtu u ndanë dy kupa për më masovikët nga jashtë dhe nga vendi. Të cilat ju takuan përfaqësueses së Kosovës dhe K.K "Forca" nga Shkupi.

Alim Hajredini si organizator i këtij turniri, në fjalimin e tij, përshëndeti të pranishmit, kryetarët prezent në sallë, të gjithë sportistët, gjyqtarët, adhuruesit e sportit të bukur të karatesë, për pjesëmarrjen e tyre në këtë eveniment kaq të bukur. Ai në mënyrë të veçantë falënderoi kryetarin dhe bordin udhëheqës të Federatës së Kosovës Ismet Krasniqi, të cilët mbështetën fuqimisht këtë aktivitet duke qenë

Në fund të turnirit u ndanë edhe kupat kryesor për tre fituesit në rezultatit përfundimtar, që këtë radhë fitues doli përfaqësuesja e Kosovës pasuar nga K.K "Forca" dhe në vend të tretë u plasua "Uskana" nga Kërçova. Por, edhe KK "Drini" nuk ngeli duar bosh. Ata fituan shumë medalje duke u plasuar në vendin e 7 nga 55 klube.

## Vokri dhe lojtarët i japin lamtumirën Albert Bunjakut

Kryetari i Federatës Futbollistike të Kosovës, Fadil Vokri, ka shtruar një darkë solemne në Shkodër për ekipin Kombëtar dhe stafin përcjellës, për nder të përzgjedhësit në largim, Albert Bunjaku. Me këtë rast, presidenti Vokri dhe kapiteni Samir Ujkani ia kanë ndarë përzgjedhësit një fanellë të Kombëtares me nënshkrimet e të gjithë futbollistëve dhe stafit, duke i shprehur falënderime për punën e bërë në krijimin e këtij grupi të futbollistëve.



Në anën tjetër, përzgjedhësi Albert Bunjaku ka falënderuar edhe një herë presidentin Vokri dhe

Komitetin Ekzekutiv të FFK-së për besimin që ia dhanë për të drejtuar Kombëtares, derisa shpre-

hur falënderim të madh për të gjithë futbollistët, duke ua bërë me dije se ata do të mbesin gjithmonë në zemrën e tij. Ai uroj që Kombëtarja e Kosovës të vazhdojë të rritet dhe të ketë suksese në të ardhmen. Bunjaku do të drejtojë Kombëtares e Kosovës vetëm edhe kundër Islandës të hënën. Kosova në tetë ndeshje zyrtare nën drejtimin e Bunjakut pas pranimit në UEFA e FIFA, regjistron vetëm një barazim, teksa ka pësuar shtatë humbje.

## Shqipëri – Itali, një përballje e relaksuar

Pas disfatës 3-0 nga Spanja, Kombëtarja e Shqipërisë sonte (e hënë) do të zhvillojë sfidën e fundit të ciklit kualifikues për Kampionatin Botëror vitin e ardhshëm në Rusi. Kundërshtari i kuqezinjve në "Loro Boriçi" do të jetë kampioni i katërfishtë botëror Italia. Kjo sfidë ka marrë tjetër ngjyrim, pasi italianëve nuk i nevojitet domosdoshmërisht fitorja, çka do të thotë që përballë kuqezinjve të Panuçit mund të jetë një kundërshtar më i relaksuar. Një rival i tillë në sfidën e avantazh, kjo jo sepse Shqipëria është në garë për ndonjë objektivi, por një ndeshje me Italinë

është pritur prej një jete të tërë nga tifozët shqiptar, dhe vlen shumë në aspektin psikologjik por edhe për kënaqësi personale për të gjithë ata që në kampionatet botërore dhe evropiane bëjnë tifo për të kaltërit. Gjithashtu mbetet një sfidë e veçantë edhe për ata futbollistë të kombëtares që luajnë në serinë A, për të treguar vlerat e tyre përpara se të rikthehen në Itali për të mbrojtur ngjyrat e skuadrave ku aktivizohen. Sipas mediave nga Shqipëria seleksionuesi i kuqezinjve Kristian Panuçi po mendon të ndryshojë disi emrat në fushë për takimin e sotëm me Armando



Sadikun që mund të startojë nga minuta e parë në ndryshim nga ndeshja e Spanjës. Derisa, përtej rreshtimit taktik, në ndeshjen e kësaj të hënë edhe seleksionuesi i Italisë Ventura do të ndryshojë

disa lojtarë por duhet të bëjë shumë kujdes edhe me kartonët e verdhë pasi janë disa lojtarët që nëse ndëshkohen do të humbisnin plej-ofin, si Immobile, që do të jetë në sulm me Eder dhe Insin-

jen, në mesfushë Barella me Parolon, me këtë në fundit që gjithashtu skualifikohet në rast të një kartoni të verdhë ndërsa mbrojtja me katër, me Zapakostan, dhe Spizanollan nga krahet dhe Kielinin e Bonuçin në qendër. Ndryshe, portieri i Italisë Buffon, kërkon të karikojë skuadrën në prag të takimit me kuqezinjve. "I kërkoj të rinjve më shumë impenjim në fushë, por na takon neve, që jemi më ekspertë për ta nxjerrë Italinë nga kjo situatë dhe për ta çuar kombëtares në Botëror", tha Buffon. "Po të kishim fituar ndaj Maqedonisë do të kishte qenë më e lehtë për të gjithë. Nuk dhamë atë që

pritej, madje bëme një ndeshje të dobët. Ndaj kemi nevojë që në sfidën tjetër, atë ndaj Shqipërisë, të bëjmë një paraqitje pozitive. Të gjithë duhet të reagojmë në këtë sfidë dhe të tregojmë se kush jemi. Italia do të shkojë në Botëror", deklaroi Buffon. Në anën tjetër Armando Sadiku i cili ishte i pafat ndaj Spanjës shpreson që golat të vijnë ndaj Italisë. "Isha mirë, u futa në pjesën e dytë. Isha i pafat, mund të kisha shënuar dhe mund t'i jepnim më shumë ngjyra lojës. Shpresoj që golat të vijnë me Italinë", tha Sadiku. Ndërkohë, Shqipëri – Itali luhet sonte me fillim në ora 20.45.

**XHENGIS REXHEPI, NDIHMËSTRAJNER I PËRFAQËSUESES SË MAQEDONISË**

# REXHEPI, TRAJNER I "SË ARDHMES"

**"Unë edhe gjate karrierës futbollistike kisha një hobi ndaj punës së trajnerit dhe kisha dëshirë të madhe të bëhem trajner. Shoh se nuk kam gabuar që e kam zgjedhur këtë profesion edhe pse nuk është lehtë. Në rrugëtimin tim kam pasur përkrahje nga familja sidomos babait që të ndjek kurset e licencimit për trajner kështu që meritat i ka prindi im Nizamedin Rexhepi , që unë jam në këtë shkallë. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj për përkrahjen e dhënë në sfidën time si trajner", pohon Rexhepi**



Koha

Bujar KURTAJ

*Shkup, 8 tetor* - Xhengis Rexhepi është një emër i njohur në futbollin vendor dhe jashtë saj. 35-vjeçari nga Pershefci i Tetovës, aktualisht është ndihmëstrajner i përfaqësueses së Maqedonisë në futboll, ndërsa rrugëtimi i tij deri në këtë post ka ardhur falë karakterit të fortë dhe karrierës si futbollist dhe si trajner në ekipet e Ligës së dytë të Maqedonisë. Ngritjen si futbollist e kishte në Turqi, pasi në Maqedoni nuk e vlerësuan sa duhet, por si trajner shkëlqeu në klubet e Ligës së dytë. Dhe si rezultat i kësaj dhe punës së palodhshme, Rexhepi aktualisht ushtron detyrën e ndihmëstrajnerit të përfaqësueses së Maqedonisë. Për të gjitha këto, karrierën e tij si futbollist dhe si trajner si dhe jetën e tij profesionale, Rexhepi i tregon në intervistën për gazetën KOHA.

**KOHA: A mund të na tregosh për hapat e parë si futbollist dhe çka të shtyri të merresh me futbollist?**

**REXHEPI:** Hapat e para me futbollin i kam nisur si çdo fëmijë me shokët duke luajtur në kohë të lirë në fushën e shkollës fillore të fshatit. Duke pasur dëshirë që të bëhem futbollist, jam regjistruar në KF 'Teteks' nga Tetova ku edhe i kam kaluar të gjitha kategoritë e futbollit. Me të vërtetë atë kohë si një i rri përveç sportit dhe



mësimin, nuk kishim zgjidhje tjera, si sot që e kanë te rinjtë.

**KOHA : Thatë se në fillim ke luajtur për KF "Teteks". Mirëpo, më pas keni qenë edhe futbollist i Shkëndijës dhe Renovës. Cilat janë përshlytjet e tua dhe sukseset me këto klube?**

**REXHEPI:** Në atë kohë shumë ishte vështirë të përparosh dhe te gresh klube për të luajtur për dallim prej tash kur është shumë e lehtë të angazhohesh në ndonjë klub të Ligës dytë apo të parë. Suksesin më të madh e arrita te KF Renova duke u inkuadruar ekipin nga Liga e tretë në të dytën dhe nga e dyta në të parën. Derisa, isha edhe golashënuesi më i miri në ekip. Mirëpo, t'ua them të drejtën, atë kohë kishe shumë padrejtësi ndaj meje edhe nga ana e KF Shkëndija dhe KF Renova, pasi që përkundër faktit se ishte njëri prej më të mirëve nuk mu dha hapësira e duhur. Nëse do të kishte qen ndryshe, sigurisht se do të kisha pasur karrierë më të mirë.

**KOHA: Më pas braktise Maqedoninë dhe një kohë të gjatë qëndrove në Turqi. Si ndodhi që të transferohesh në Turqi**

**REXHEPI:** Njëpër një miqve dhe anëtarëve të familjes që i kisha në Turqi, arrita të njohem me trajnerin e sotëm të 'Balikesirspor' 'XhanXhangok',



ku atë kohë ai drejtonte ekipin e 'Erdekspor'. Ky njeri më mundësoi të dalë në testim ku edhe arrita ta binde atë sa jam futbollist i mirë me çka edhe arrita marrëveshje me atë klub. Në Turqi qëndrova shtatë vite duke bërë transferime të mira në klube të ndryshme dhe gati te çdo ekip kam qenë golashënuesi më i mirë.

**KOHA: Për shtatë vite qëndrim në Turqi luajte për gjatë klube si "Erdekspor", "Karacabejspor", "Bandirmaspor", "Balikesirspor", "Burgazspor" dhe "Zonguldakspor". Si e vlerëson eksperiencën tënde në këto klube.**

**REXHEPI:** Të luash në Turqi shtatë vite radhazi nuk është lehtë. Duke ia bashkangjitur faktit se kam qenë kapiten i ekipeve në dy vitet e fundit me të vërtetë duhet të jesh futbollist i mirë dhe njeri me karakter të fortë. Kam pasur mundësi të luaj me futbollistë shumë cilësor të cilët kanë pasur karrierë të mirë në Turqi. Gjithashtu kam punuar me trajner të mëdhenj ku sot e kësaj dite disa udhëheqin ekipe të kategorisë së dyte në Turqi. Me një fjalë Turqia më ka ndihmuar shumë në çdo sfidë të jetës profesionale ku edhe sot e kësaj dite i marrë benefitet e asaj kohe. Ky shtet më ka ndihmuar tepër edhe për karrierën si trajner se pata mundësi të punoj me trajner të mirë prej të cilëve kisha se çfarë të mësoj. Kjo më ndihmoi shumë për nisjen e karrierës si trajner

**KOHA: Më pas braktise futbollin a e kishe vështirë ti japësh fund karrierës?**

**REXHEPI:** Karrierën e përfundova në moshën 29-vjeçare edhe pse kisha mundësi të vazhdoj të luaj në Turqi. Por, për shkak obligimeve familjare, vendosa të kthehem në Maqedoni. Mirëpo, duke parë se gjërat në futbollin vendor ishin të njëjta sikurse para shtatë viteve, ku padrejtësitë ishin të mëdha, unë vendosa ti japë fund karrierës.

**KOHA: Por nuk u ndatë nga futbollin dhe vendosët të bëheni trajner. Pse trajner dhe jo në ndonjë funksion tjetër?**

**REXHEPI:** Unë edhe gjate karrierës futbollistike kisha një hobi ndaj punës së trajnerit dhe kisha dëshirë të madhe të bëhem trajner. Shoh se nuk kam gabuar që e kam zgjedhur këtë profesion edhe pse nuk është lehtë. Në rrugëtimin tim kam pasur përkrahje nga familja sidomos babait që të ndjek kurset e licencimit për trajner kështu që meritat i ka prindi im Nizamedin Rexhepi ,



“  
Gjithçka filloi kur më kontaktoi  
seleksionuesi Igor Angelovski . Ai  
më tregoi se kanë biseduar me  
nënkryetarin e Federatës  
Futbollistike të Maqedonisë  
Muahamed Sejdini rreth  
angazhimit tim në reprezentacion  
e Maqedonisë. Realizuar një  
takim dhe më tregoi që ka dëshirë  
që unë të jem pjesë e stafit teknik  
të tij ku unë edhe e falënderova  
atë për besimin ndaj meje.  
Sigurisht se është kënaqësi të  
jesh në këtë postë, por e veçanta  
të vishe duke e merituar dhe duke  
e provuar veten si trajner nëpër  
klube.



**sit Igor Angelovski. Si e pritët  
këtë ftesë?**

**REXHEPI:** Gjithçka filloi kur  
më kontaktoi seleksionuesi Igor  
Angelovski . Ai më tregoi se kanë  
biseduar me nënkryetarin e  
Federatës Futbollistike të  
Maqedonisë Muahamed Sejdini  
rreth angazhimit tim në repre-  
zentacion e Maqedonisë.  
Realizuar një takim dhe më tregoi  
që ka dëshirë që unë të jem  
pjesë e stafit teknik të tij ku unë  
edhe e falënderova atë për besimin  
ndaj meje. Sigurisht se është kënaqësi të  
jesh në këtë postë, por e veçanta të  
vishe duke e merituar dhe duke  
e provuar veten si trajner nëpër  
klube.

shumë lehtë të punohet me ata.

**KOHA: Cili është momenti  
më i mirë gjatë karrierës  
tënde?**

**REXHEPI:** Si futbolliste do  
ta veçoja me klubin turk  
‘Bandirmaspor’ inkuadrimit  
nga Liga e tretë në të dytë. Si  
trajner suksesin me KF ‘Rrufeja-  
M’ ku në gjysmësezon ekipi  
kishte tubuar vetëm 11-pikë  
dhe ndodhej në vendin e para-  
fundit. Atë sezon pesë ekipe lar-  
goheshin nga liga, ndërsa në  
vazhdim për gjysmësezon  
arritim të fitojmë 10 ndeshje,  
tre barazime dhe vetëm dy disfa-  
ta, duke tubuar kështu 33 pike  
dhe duke u ngjitur nga vendi 15  
në vendin e pestë.

**KOHA: Kush është në  
jetën private Xhengis  
Rexhepi?**

**REXHEPI:** Në jetën private  
mundohej të ndaj kohe me  
tepër familjes, punës profesio-  
nale kuptohet dhe obligimeve  
ditore. Gjatë kohës së lire mun-  
dohem të beje analiza të nde-  
shjeve, mundohej ende me  
tepër ta përvetësojë veten, te  
kem më tepër dituri në profesio-  
nin tim.

**KOHA: A dëshiron që edhe  
djali të ndjek hapat tuaja?**

**REXHEPI:** Emrin djalit ja  
kemi vënë Arda, për shkak se  
kishim një fare simpatie ndaj  
futbollit aktual të Barcelonës  
Arda Turan. Nëse ai do të ketë  
kualitet të mirë do ta bëja fut-  
bollist, pasi futboli është një  
profesion në të cilën duhet të  
kesh kualitet, në të kundërtën  
nuk mund të arrish asgjë.

që unë jam në këtë shkallë.  
Shfrytëzoj rastin ta falënderoj  
për përkrahjen e dhënë në  
sfidën time si trajner.

**KOHA: Dhe si trajner keni  
një karrierë të pasur, duke  
drejtuar pesë klube si, KF  
“Rrufeja-M”, KF “Vrapçiste”,  
KF “Drita”, KF “Kozhuv  
Gjevgjeli” dhe së fundmi KF  
“Vëllazërimi”. A mund të na  
tregoni më shumë rreth punës  
tuaj në këto klube?**

**REXHEPI:** Falë drejtorit  
sportiv të atëhershëm Jasin  
Fetishi u emërova për trajner i  
KF ‘Rrufeja-M’. Ky ka qenë per-  
soni i cili më ka përkrahur dhe  
më ka dhënë rastin që të bëhem  
trajner i kësaj skuadre. Edhe  
pse nga ky klub nuk u ndamë

miqësisht, prapë se prapë unë  
jam falënderues ndaj tij.  
Ndryshe, në të gjitha klubet ku  
kam qenë trajner, kam qenë i  
suksesshëm. Në fakt aty ku  
kam qenë trajner, kam qenë  
lider i klubit. Klubet që i kam  
drejtuar kanë qenë kandidat për  
të rënë nga Liga e dytë, por falë  
punës sime dhe angazhimit  
maksimal të futbollistëve si dhe  
kryesive të klubeve, kemi arritur  
suksese të mëdha, duke shpë-  
tuar nga rënia dhe duke u bërë  
ekipe stabile në vazhdim të  
kampionatit.

**KOHA: Është interesante  
se karriera juaj si trajner ka  
qenë e lidhur vetëm me klubet  
e Ligës së dytë dhe jo me ata  
të Ligës së parë. Është kjo**

**mungesë e ofertave apo thjeshtë  
është çështje fati?**

**REXHEPI:** Sigurisht se është  
çështje fati sa i përket faktit që  
deri më tani nuk kam qenë traj-  
ner i ndonjë ekipi të Ligës së  
parë. Mirëpo, sa për informim,  
para disa ditëve kam qenë në  
bisedime me tre klube kosovare  
te Super ligës, por për shkak  
angazhimeve në reprezentacion  
e Maqedonisë, nuk kam pranuar  
asnjë ofertë. Unë e di që unë  
veten dhe kapacitetin që e posedoj  
dhe për këtë arsye nuk  
ngutem dhe shpresoj se në të  
ardhmen të angazhohem në  
ndonjë klub të mirë.

**KOHA: Në gusht të këtij  
viti morët ftesë të jeni  
ndihmëstrajner i seleksionue-**



Formula 1, Çmimi i madh i Japonisë

# Hamilton "prek" titullin

Pas dy javësh në Austin, Luis do të ketë shansin e "match point-it" të parë, do t'i mjaftojë të marrë 16 pikë më shumë se Fettel në Teksas për të rrëmbyer titullin e tij të katërt Botëror. Një skenar i paimagjinueshëm jo vetëm në verë, por edhe një muaj më parë, kur para garës në Monca kur Fettel ishte kryesues i Botërorit me 7 pikë avantazh



Ishte e bukur deri sa zgjati ëndrra e Ferrarit. Shpresat për Botërorin u shuajtën në agimin Evropian të Çmimit të Madh të Japonisë, kur një problem në kandelën e makinës së Sebastian krijoi fillimisht problem në momentin e nisjes, për të arritur të tërheqja e hidhur në xhiron e katërt. Me kokëkuqen e parakaluar nga Verstappen dhe të lënë mënjanë nga të tjerët, shuhen dhe iluzionet për një përmbysje ndaj Luis Hamilton. Anglezi fitoi garën duke lënë pas në vendin e dytë Maks Verstappen dhe Daniel

Rikiardon me australianin që mbrojti duke mos u dorëzuar vendin e fundit në pod, duke fluturuar me një distancë prej 59 pikësh ndaj gjermanit. "As në ëndërr nuk e kisha imagjinuar që do të kisha një avantazh të tillë. Ferrari ka qenë një rival i fortë këtë sezon, një makinë e qëndrueshme, ndaj nuk e prisja këtë situatë. Por duhet të falënderoj skuadrën për punën fantastike që ka bërë", tha Hamilton pas garës së Suzukës. Piloti britanik arriti të përmbysë në pak muaj renditjen e Botëror-

it të Formula 1, duke qenë ai lider, ndërkohë që në korrik ishte Fettel ai që dominonte renditjen. "Kjo ishte një garë fantastike, ndërkohë që skuadra bëri një punë të mirë, duke më vënë në dispozicion një makinë të shpejtë. Edhe Verstappen bëri një garë të mirë, nuk ishte e lehtë të konkurroje me të, por ia dolëm mbanë", tha Hamilton, që pret më i qetë garat e mbetura. "59 pikë janë shumë, por jo të mjaftueshme për të fituar titullin. Botërori është ende i gjatë, duhet të jemi me këmbë në tokë dhe të

punojmë vazhdimisht, për të ruajtur avantazhin dhe fituar titullin", deklaroi britaniku.

Pas dy javësh në Austin, Luis do të ketë shansin e "match point-it" të parë, do t'i mjaftojë të marrë 16 pikë më shumë se Fettel në Teksas për të rrëmbyer titullin e tij të katërt Botëror. Një skenar i paimagjinueshëm jo vetëm në verë, por edhe një muaj më parë, kur para garës në Monca kur Fettel ishte kryesues i Botërorit me 7 pikë avantazh. Pas atyre që ndodhën në xhiron e parë në

Suzuka, nuk është se gara e humbi krejt adrenal-inën, por nuk mund të dhuronte emocione nga ato që krahasohen me një luftë për Botërorit me Red Bull që zunë dy vendet e fundit në pod pas Hamilton, të cilit për të fituar Çmimin e 8 të Madh këtë sezon ju desh të përpiqej deri në fund. Maks Verstappen provoi ta sulmonte, por Hamilton menaxhoi avantazhin duke shfrytëzuar dhe një manovër të Alonso të rikapur një xhiro më pas, me spanjollin që ashtu si në Malajzi hetohet për mungesë respektimi të flamujve blu. Pas podit, në vendin e 4 Botas, që lë pas Raikkonen, Kimi u ngjiti me ritëm të mirë deri në vendin e pestë ndërkohë që në zonën e pikëve dhe Okon e Perez, respektivisht në vendin e 6 dhe të 7, pastaj në të 8-in dhe të 9-in, makinat Haas të Magnussen dhe Grosjean, ndërsa i dhjeti Massa që u mbrojti nga Alonso në vendin e 11. Hamilton pret vetëm aritmetikën për të festuar, Red Bull konfirmon progresin, ndërsa Ferrarit i mbeten vetëm pengjet, për kokëkuqen është "Game Over".

## Shkurt

### Saņez dëshiron largimin nga Arsenal

Sipas "Daily Mail", në janar priten disa lëvizje të bujshme në merkato. Aleksis Saņez dëshiron largimin nga Arsenal, me Manchester Siting që do ta priste krahëhapur lojtarin e Kombëtares së Kilit. Nga ana tjetër, transferimi i 28-vjeçarit te Siti do të hapte rrugën për largimin e Sergio Agüero, që prej kohës ëndërrrohet nga Milani. Ekipi i Guardiols është gati të paguajë 21 mln euro për Saņez, pak për një lojtar me cilësitë e tij, por shumë për një lojtar që i skadon kontrata në fund të këtij sezoni.

### Motta nuk është i impresionuar nga sulmi

Mesfushori i Paris Sen-Zhermen, Tiago Motta foli për faqen zyrtare të klubit francez, për startin e këtij sezoni. 35-vjeçari deklaroi se nuk është shumë i impresionuar nga sulmi, pasi skuadra më parë ka pasur lojtarë si Kavani, Di Maria, Draxler e Pastore. Megjithatë Motta pranoi se me ardhjen e Nejmar dhe Mbappe ka një impostim më shumë në sulm, dhe për mesfushorët është më e lehtë të bëjnë punën e tyre.

### Martial ndiqet nga Barcelona

Entoni Martial përfundon në "radarin" e Barcelonas. E ardhmja e lojtarit francez është larg Manchester Junajted, dhe për këtë drejtuesit e klubit katalanas po e monitorojnë me kujdes situatën e tij në "Old Trafford". 21-vjeçari është lodhur duke qëndruar nën hijen e Markus Rashford, dhe gjithashtu nuk dëshiron të rrezikojë pjesëmarrjen në Botërorin e "Rusi 2018". Për këtë sulmuesi dëshiron të ndryshojë skuadër, me Barcelonan që është gati ta transferojë në "Camp Nou".

### Rikthehet Benzema

Më në fund vijën lajme të mira nga infermeria për Zinedin Zidan. Trajneri i Real Madrid do të ketë në dispozicion në sfidën me Getafon, në program pas përfundimit të ndeshjeve të Kombëtareve, Karim Benzema. Francezi duket se është rikuperuar plotësisht nga dëmtimi i pësuar rreth 1 muaj më parë. Megjithatë Kovaciç, Marcelo, Karvahal dhe Belli duhet të qëndrojnë ende jashtë fushe.

## Në Angli janë të bindur Konte largohet në fund të sezonit



Antonio Konte po përgatit rikthimin në Itali. Mediat angleze tashmë e japin si të sigurt lajmin se tekniku i Çellsit në fund të sezonit do të largohet nga drejtimi i "Bluve të Londrës". I pakënaqur me merkaton dhe dëshira për t'u rikthyer pranë familjes, janë këto arsye se përse italian i planifikon t'i rikthehet aventurës në Seria A. Në ndjekje të tij është Milan. Drejtuesit e kuqezinjve prej kohësh po mundohen të bindin 47-vjeçarin të bëhet pjesë e projektit të tyre. Kontrata aktuale e Konte skadon më 2019 dhe vetë trajneri ka vendosur që kjo marrëveshje të mos rinovohet duke i dhënë një mesazh të qartë drejtuesve të klubit se bashkëpunimit mes palëve po i vjen fundi. Italiani kurrë nuk e ka fshehur pakënaqësinë e

tij në lidhje me merkaton e zhvilluar dhe jo në pak raste është shfaqur nostalgjik për kohën kur ai ishte pjesë e kampionatit italian. "Italia është atdheu im, do të kthehem. Nuk e di se kur, por ky është objektivi im", Kështu shprehej në një intervistë Konte. Këtë deklaratë mediat angleze e kanë cilësuar si një mesazh të qartë divorci të parakohshëm. Në fund të sezonit numri një i stolit të Çellsit pritet t'i kërkoj Presidentit Roman Abramoviç një zgjidhje konsensuale të kontratës. Në Itali skuadrat që duan të kenë Antonio Konten si trajner janë të shumtë edhe pse nuk ka asnjë kandidat konkret një gjë është e sigurt, tekniku 47-vjeçarë do ti japë lamtumirën Premier Ligë, për t'u rikthyer aty ku edhe u bë i njohur në Itali.

## Pirlo tërhiqet nga futbolli

Andrea Pirlo, lider i Italisë kampione e botës në vitin 2006, ka deklaruar sot tërheqjen nga futbolli i luajtur. Nga Nju Jorku, ku dhe luan prej dy sezonesh, fantazisti që në karrierën e tij ka fituar gjithçka, ka deklaruar në një intervistë për "La Gazzetta Dello Sport" se në dhjetor do t'i thotë "stop" futbollit. "Vjen një moment kur kupton se ka ardhur momenti për t'u ndalur. Çdo ditë kam probleme fizike dhe nuk arrij të stërvitem ashtu si dua. Në moshën që jam tani, ka ardhur koha t'i them mjaft futbollit. Nuk

mund të vazhdoj më të luaj me këtë ritëm", u shpreh Andrea Pirlo, tashmë 38 vjeç. Pirlo shprehet se ende nuk ka vendosur se çfarë do të bëjë në të ardhmen. "Diçka do të bëj. Në dhjetor do të rikthehem në Itali. Zëvendës i Konte? Janë thjesht fjalë. Unë kam disa ide, por do të marr pak kohë për të vendosur. Nuk është e thënë se meqë kam qenë një futbollist i mirë të bëhem edhe një trajner i mirë. Duhet të lindja ajo "shkëndija" që kjo gjë të ndodhë. Mua ende nuk më ka ardhur momenti për t'u bërë trajner", u sh-



preh Andre Pirlo, që në Serinë A ka luajtur me Inter, Milan e Juventus, ndërsa me kombëtaren ka luajtur 116 ndeshje e realizuar 13 gola.

## Juventus me tetë mungesa ndaj Lacios



JuventusI në gjendje alarmi. Situatë aspak e favorshme paraqitet në kampin e bardhezinjve, një pjesë e mirë lojtarëve pritet të mos jenë të gatshëm për sfidën e së shtunës së ardhshme ndaj Lacios. Mario Manxhukiq dhe Andrea Barzali janë dy emrat e fundit që i bashkohen listës së të dëmtuarve. Sulmuesi kroat pësoi një dëmtim në takimin ndaj

Finlandës edhe pse nuk asgjë serioze, gjasat janë që ndaj Lacios ai të mos jetë në gjendje për të luajtur. Situata paraqitet kritike edhe në repartin e mesfushës. Markisio pas operacionit është duke u stërvitur i veçuar, por faza e rikuperimit për të pritet të zgjas. Kedira gjithashtu vazhdon të ndjejë shqetësime në pjesën e gjurit, ndërkohë i sapoard-

huri Hovedes ka nisur të vrapojë, por fizikisht mbetet prapa me përgatitjet. Pjaniç dhe Barzali me shumë mundësi do të jenë të aftë për të luajtur vetëm në ndeshjen e "Champions League" ndaj Sporting Lisbona. Në "boxe" do të qëndrojnë dhe De Shilio, ndërsa rikthimi i kroatit Pjaca do të jetë i mundur në nëntor. Trajneri i Juventusit, Masimiliano Alegri ndodhet në pozita të vështira. Tetë emra të formacionit bazë të dëmtuar me kampionatin që rifillon fundjavën e ardhshme. Deri atëherë numrit një të bardhezinjve nuk i ngelet gjë tjetër veçse të shpresojë që të paktën disa prej këtyre emrave të jenë të gatshëm për sfidën ndaj Lacios.



## NEW YORK TIMES: Merrni mësim nga Turqia si të silleni me refugjatët

Gazeta prestigjioze amerikane "The New York Times" bëri të ditur se prej 5 milionë refugjatëve sirianë të arratisur në vendet e ndryshme kushtet më të mira i kanë ata të strehuar në Turqi. Në artikullin me titull "Një mësim nga Turqia si të silleni me nderë ndaj refugjatëve" të publikuar në rubrikën e opinionëve të gazetës në fjalë shkruhet se pjesa më e madhe e refugjatëve sirianë janë strehuar në Turqi, Liban dhe Jordani dhe në mesin e tyre kushtet më të mira u ofrohen në Turqi. Në artikullin e gazetares italiane me origjinë palestineze, Rula Xhebril theks i veçantë u vë në qytetin Gaziantep të Turqisë. Gazetarja bën fjalë me lëvdata për punimet që kryetarja e bashkisë së Gaziantepit, Fatma Shahin bëri për refugjatët sirianë. Në artikull shkruhet se në Gaziantep janë strehuar 600 mijë sirianë dhe vetëm 40 mijë prej tyre jetojnë në kampe, ndërsa bëhet e ditur se mbrojtja e të drejtave të refugjatëve nga ana e kryetares Shahin është bërë pjesë e politikave të saj për refugjatët. "Qyteti është bërë shembull global i mikpritjes së viktimave të luftës", theksohet në artikullin e gazetës "The New York Times".





Besimi në gatishmërinë e Rusisë për të sakrifikuar për të mirën e Serbisë, në Mitrovicë të veriut nuk është mit e as temë historike. Një gjë të tillë e beson edhe Smiljana Jovanović, serbe nga Mitrovica e Veriut

Mitrovica e veriut, një prej katër komunave veriore të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, me nxitjen e liderëve politikë lokalë, sot është një bastion pro-rus, ku simpatia për presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, por edhe për shtetin rus, konfirmohet nga shumica e qytetarëve serbë të kësaj komune

Nëpër rrugët e qytetit, valojnë flamujt rus dhe serbë, ndërkaq portreti i Putinit në ndërtesa ose i paraqitur edhe përmes mbishkrimeve, transmetojnë mesazhe të glorifikimit të aleancës serbo-ruse. Disa qytetarë serbë të Mitrovicës së veriut e shohin Rusinë si aleatin e vetëm të Serbisë. Miroslav Laketiç nga Mitrovica e veriut, shpreh mendimin se aleanca serbo-ruse, është krejtësisht e natyrisht. “Kjo është një gjë që dihet në përgjithësi. Serbia gjithmonë ka qenë në udhëkryqin e interesave të perëndimit dhe të lindjes dhe kjo do të vazhdojë të jetë kështu edhe më tutje. Për dallim nga perëndimi, Rusia kurrë nuk na ka nxjerrë probleme, nuk na e ka rrezikuar sigurinë dhe mëvetësinë tonë”. Ata janë miqtë tanë tradicional. Shpresojmë që edhe kësaj here, Rusia do të mbetet në këtë rrugë. Rusia e fortë nënkupton edhe një Serbi të fortë. Kur Rusia është e dobët, atëherë nuk do ta ndihmojë Serbinë, ashtu siç ka ndodhur me Jelcinin e çmendur”, thotë

# Serbët e veriut mbajnë shpresat te Rusia dhe Putini



## SERBIA NUK ËSHTË NË POZITË TË THJESHTË

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, në bisedën telefonike me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka vlerësuar se Serbia nuk është në një situatë të thjeshtë. Ai theksoi se rrethanat ndërkombëtare janë të atilla që Serbia nuk është në pozitë të thjeshtë, por është i bindur se “populli serb, si gjithmonë përgjatë historisë, do të tregojë karakterin e tij dhe nën udhëheqjen e presidentit Aleksandar Vuçiq do të tejkalojë të gjitha problemet”, theksohet në njoftimin e Kabinetit të presidentit të Serbisë. “Jam i sigurt se nën udhëheqjen tuaj, Serbia dhe populli serb do të shkojë përpara”, tha Putin. Vuçiqi dhe Putini janë dakorduar për të caktuar një takim me qëllim të përfundimit të bashkëpunimit të dy shteteve.

Laketiç. Mendim të ngjashëm ka edhe Bosanka Prodanović, serbe nga Mitrovica e veriut. Ajo thotë se populli në Mitrovicë të veriut, kryesisht, shpreson në mbështetjen e Rusisë: “Na mjafton ndjenja që Rusia dhe Putini ekzistojnë. Kjo mjafton. Pres gjithçka pozitive nga ata. Populli këtu, kryesisht, beson në Rusinë, sepse ne nuk e dimë se çfarë po bi-

sedohet në Bruksel”. Me këtë gatishmëri të opinionit të qytetarëve në Mitrovicë të veriut, nuk duhet befazuar se pse lideri i Listës Serbe, Goran Rakiç, së bashku me shefin e Zyrës për Kosovën i Qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriç, ka vendosur që para zgjedhjeve lokale në Kosovë, që do të mbahen me 22 tetor, ka shkuar në Moskë për të marrë kë-

shilla. Por, njohësi i çështjeve të sigurisë nga Mitrovica e veriut, Veroljub Petroniq, nga organizata joqeveritare “Qendra humane në Mitrovicë”, shpreh mendimin se rrëfimi për ndihmën e Rusisë për serbët në Kosovë, të cilit iu dha hov, është imagjinari dhe bëhet më tepër për propagandë. Sipas tij, një ndihmë e tillë nuk ekziston. Petroniq thotë se

kohë më parë ka marrë pjesë në një konferencë për sigurinë ndërkombëtare në Soçi të Kinës. Bisedat që kishte bërë atje me përfaqësues rus, siç thotë ai, e kanë sjellë deri te përfundimet interesante. “Kam pasur rastin të bisedoj me një deputet rus, i cili thjesht më ka bërë t’i hap sytë dhe të zbres në tokë. Ai më tha që në listën e tyre të interesave është në vendin e 17. Ai më tha se shteti i tij është vend që kufizohet me 19 shtete dhe ka dalje në 12 dete. Siç më tha, Armenia, Gruzia, Azerbaixhani, Kazakistani dhe të tjera, janë një grumbull i problemeve të tyre. Prandaj, ne jemi në vendin e 17 për ta”. “Madje, më ka thënë se Mali i Zi, para se të hynte në NATO, ka qenë një sferë apo zonë më e madhe e interesit për ta, se sa Serbia. Kjo, siç më tha ai, për arsyen e thjeshtë se do të ishte e mjaftueshme që e gjithë flota e Detit të Zi të shkojë dy herë në vit në Tivar, që të marr ujë për anijet dhe nëndetëset, të parakalojë nëpër Adriatik dhe ta tregojë forcën”, thotë Petroniq. Por, rezerva të tilla ndaj Rusisë, sikurse ato të Petroniqit, vështirë se mund t’i gesh në Mitrovicën e veriut. Jova Jovanović nga kjo komunë, thotë se Rusinë nuk mund ta shohë ndryshe, përveç si një vend mik të

serbëve. “Rusët i përjetojnë si miq. Ata janë miqtë tanë më të mirë për qindra vjet, e jo vetëm tash. Atij që i pengon Rusia, ai është armiku më i madh i popullit serb. Ata na ndihmojnë gjithmonë, pa ndonjë kërkesë për kompensim. Ata në perëndim, kërkojnë t’iu ndihmojnë vetëm kur kanë interes”, shprehet Jovanović. Por, a ka ardhur mbështetja ruse për Listën Serbe në momentin e duhur, kur me lejen e Beogradit, kjo listë ka vendosur ta mbështesë Qeverinë e Kosovës, në krye të së cilës është Ramush Haradinaj, të cilin Serbia po e akuzon për krime lufte? Megjithatë, serbët e veriut, e arsyetojnë këtë veprim të Listës Serbe. Një arsytim të tillë e jep edhe Bosanka Prodanović: “Ne kemi qenë kundër asaj që Lista Serbe të hyj në qeverinë e Haradinajt. Por, nëse këtë e ka thënë Putini dhe në qoftë se qeveria e jonë e thotë një gjë të tillë hapur, atëherë diçka do të dalë nga kjo”. Besimi në gatishmërinë e Rusisë për të sakrifikuar për të mirën e Serbisë, në Mitrovicë të veriut nuk është mit e as temë historike. Një gjë të tillë e beson edhe Smiljana Jovanović, serbe nga Mitrovica e Veriut.

“E shihni si ndihmojnë për ushtrinë, për pajisje dhe për shumëçka tjetër”, thotë Jovanović. Bashkëpunimi ushtarak serbo-rus, ka marrë hov, përkundër politikës së balancimit, të cilën e proklamoi qeveria në Serbi. Megjithatë, për shumë serbë të Mitrovicës së veriut, një gjë e tillë i thëllon shpresat se Rusia do të vazhdojë mbështetjen për arritjen e qëllimit, që Kosova të jetë pjesë e Serbisë. (REL)

## Dialogu Kosovë-Serbi në bashkëpunim të ngushtë me SHBA-në

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, që po zhvillohet me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, gjithmonë e ka pasur përkrahjen e Shteteve të Bashkuara dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tej, tha zëdhënësjja e Komisionit Evropian, Maja Kocijančić. “SHBA-të gjithmonë e kanë përkrahur dialogun, i cili po ndërmjetësohet nga BE-ja dhe bashkërisht do të vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë në Ballkanin Perëndimor”, tha Kocijančić, për agjencinë “Beta”, duke komentuar deklaratat e zyrtarëve shtetëror të Kosovës dhe mediave për përfshirjen e SHBA-ve në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, përcjell Telegraf. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar gjatë kësaj jave se nga zëvendëspresidenti Amerikan, Mike Pence, ka marrë premtim se SHBA-të do të përfshihen drejtpërdrejt në dialogun Kosovë-Serbi.

Duke iu referuar ë dhënave nga Dogana e Kosovës, konsumi mesatar vjetor i sheqerit është 49 milionë ton, i çajit 1.9 milionë ton dhe i kafes 7.7 milionë ton. Nisur nga konsumi vjetor, llogaritet që kosovarët shpenzojnë mbi 50 milionë euro në vit për çaj, kafe dhe sheqer, pjesën më të madhe nëpër lokale

Edhe shoqëria e tregut, ajo që të dikton të ulësh kokën e të punosh fort, nuk po mundet ta largojë shqiptarin nga streha e lokalit, shtëpia e dytë e tij. Gjithnjë ankimtar e duke pritur mos i bie diçka nga qielli, ai është gjithashtu fort i lidhur me gjendjen e limontisë ose një dore muhabet para një kafeje apo çaji, duke i lënë orët e punës dhe produktivitetin maksimal prej tyre, në plan të dytë. Duke iu referuar ë dhënave nga Dogana e Kosovës, konsumi mesatar vjetor i sheqerit është 49 milionë ton, i çajit 1.9 milionë ton dhe i kafes 7.7 milionë ton. Nisur nga konsumi vjetor, llogaritet që kosovarët shpenzojnë mbi 50 milionë euro në vit për çaj, kafe dhe

## Milionat e kosovarëve në kafe, çaj dhe sheqer



sheqer, pjesën më të madhe nëpër lokale. Përkthehen këto si milionat e një vesi të pashqitshëm, e ku pa, në një ekonomi tregu e konkurrence. “Artikulli më i shitur në lokale të Kosovës sot është kafeja ‘Maçhiato’, më pas vijnë çaji i nxehtë dhe në periudhën e verës pijet freskuese”, thonë pronarët e bareve dhe lokaleve të kryeqytetit, Prishtinës. Me një kilogram kafe baret dhe

lokalet arrijnë të bëjnë mesatarisht 100 kafe, kjo do të thotë se një kosovar në vit pi 120 kafe. Nëse i referohemi këtyre të dhënave sipas një llogaritje të thjeshtë del që kosovarët çdo vit konsumojnë 22 milionë kafe. Nga të dhënat në internet, më shumë kafe në vit konsumojnë vendet nordike ku konsumi i saj arrijnë deri në 13 kilogramë për frymë në vit. Për sa i përket

konsumit të çajit, më së shumti përdoret ai i zi apo ai i fermentuar apo pjesërisht i fermentuar. Gjatë vitit 2016 nga të dhënat e Doganave të Kosovës janë zhdoganuar 58 milionë tonë çaj, kafe dhe sheqer në vlerë prej 50 milionë euro. Po ashtu, gjatë këtij nëntëmuajori janë zhdoganuar 39 milionë ton sheqer në vlerë prej 21 milionë euro, ndjekur nga kafeja me 5.3 milionë ton në vlerë prej 13.3 milionë euro dhe çaji me 1.7 milionë ton apo në vlerë prej 6.7 milionë euro. Ndërsa në gjatë vitit 2015 në Kosovë janë importuar 64.2 milionë ton çaj, kafe dhe sheqer, përkatësisht 54.7 milionë ton sheqer, pasuar nga kafeja me 6.8 milionë ton dhe çaji me 2.5 milionë ton. Vlera e tyre për këtë vit arrijnë 47.3 milionë euro. Kurse në vitin 2013 deri në nëntëmuajorin e vitit 2017 janë importuar 293.9 milionë ton çaj, kafe dhe sheqer me vlerë të përgjithshme prej 230.6 milionë euro.





## Bashkë për të luftuar kolerën



Qeveri të ndryshme, Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) dhe organizata bamirëse nga e gjithë bota do të takohen në Francë që të angazhohen në parandalimin të 90% të rasteve të vdekjeve nga kolera deri në vitin 2030. Është hera e parë që të gjitha këto agjenci bëjnë këtë zotim. Ky takim i agjencive vjen pasi Jemeni vazhdon të luftojë me një nga shpërthimet më të këqija që kolera ka pasur në këtë vend. Kolera është një sëmundje infektive që shpërndahet nëpërmjet ujit të ndotur. Nëse nuk kurohet, kolera mund të rezultojë vdekjeprurëse. Rreth 100 000 njerëz vde-

sin çdo vit prej saj. Kolera është përhapur në Jemen për shkak të higjienës së përkeqësuar, kushteve jo të mira sanitare dhe dëmtimeve të rezervave të ujit. Më shumë se 770.000 persona janë infektuar nga sëmundja që është lehtësisht e kurueshme me pajisjet e duhura mjekësore, ndërsa rreth 2.000 persona llogariten të kenë vdekur. Shumë prej viktimeve janë fëmijë. Por nuk është vetëm Jemeni që vuan prej kësaj sëmundje. Sipas OBSH-së, rreth 2 miliardë njerëz në të gjithë botën përdorin ujë të ndotur dhe në këtë mënyrë ata janë të rrezikuar prej kolere.

## Ushtria ruse ndalon "selfiet"



Ministria ruse e Mbrojtjes nxori një urdhër që u ndalon të gjithë ushtarëve të saj profesionistë postimin e fotove në rrjetet sociale. Sipas autoriteteve ruse, vendimi është marrë për arsye sigurie, pasi fotot dhe gjeo-lokalizimi mund të nxjerrin në publik sekrete të bazave dhe ushtrisë ruse. Vendimi mbërrin pas disa rasteve, ku nëpër rrjetet sociale është verifikuar e kundërta e pretendimeve të

Moskës, sidomos sa i takon qëndrimin të saj në Ukrainë. Në njërin nga këto postime në vitin 2014, ushtari Mikhail Chuguno publikoi një imazh me shënimin: "Me Gradët për në Ukrainë". Imazhi tregon një karvan automjetesh transportuese ushtarake dhe Gradët janë model raketash ruse, që besohet se u janë dorëzuar separatistëve në lindje të Ukrainës.

## Varros "vëllain", ai i përgjigjet në telefon

Një grua pësoi shokun e jetës kur varrosi me kremim trupin e njeriut që besonte se ishte vëllai i saj, për t'u përballur me të vetëm pak orë më vonë. Rajo Devi, nga India, pa foton e një burri që ishte vetëvarur në një gazetë lokale dhe ishte e bindur se ai ishte vëllai i saj 30-vjeçar Kaluram. 27-vjeçarja e telefonoi këtë të fundit, por kur i doli i

fikur -u bind se vëllai, i cili jetonte disa kilometra larg saj, kishte vdekur. Mediat në vend raportuan se Rajo dhe disa familjarë të tjerë u paraqitën në stacionin e policisë në Lalgah, për të marrë trupin. Një zyrtar deklaroi se kishin qenë të shumtë familjarët, të cilët e kishin identifikuar trupin si të 30-vjeçarit. Pasi ekzaminimit, trupi iu dorëzua

27-vjeçares Devi dhe ajo e mori nga morgu e më pas mbajti varrimin me dje-gies, si pjesë e traditës Hindu. Por pas ceremonisë, një nga të afërmit i ra telefonit të Kaluram me shpresën se do mund të gjente të dhëna, mbi shkaqet e vdekjes së tij. Ironia deshi që burri i cili presupozohej të kishte vdekur u përgjigj. Ai kishte shkuar për të viz-

ituar dikë dhe i kishte rënë bateria, ndaj telefoni doli i fikur kur e mori filimisht e motra. Atij iu tha që të shkonte me urgjencë në shtëpinë e të motrës, ku e pritën plot shend e verë. Policia konfirmoi se Devi pranoi që kishte identifikuar trupin e gabuar, kështu që autoritetet po përpiqen tani të identifikojnë personin e vdekur.

Mijëra katalonjas protestuan në Barcelonë për dialog dhe jo konfrontim të mëtejshëm në krizën aktuale. Kërkesat e tyre: Më shumë zgjidhje, më pak egoizëm

Një det me bluza të bardha të shtunën në Barcelonë. Ky ishte simboli i paqes në sheshin Plaça Sant Jaume në qendër të Barcelonës. Mijëra vetë iu bashkuan një thirrjeje anonime për protestë. Qëllimi i protestuesve ishte që të dyja palët si kryeministri, Mariano Rajoy dhe presidenti i Katalonjës, Carles Puigdemont të zhvillojnë dialog mes tyre. "Të dyja palët duhet të ulen me njëra-tjetrën dhe të bisedojnë, kështu nuk vazhdohet më", u shpreh një protestues. Ndërsa një tjetër thekson, se "sikur të kisha parë një flamur katalonjas apo spanjoll do të isha larguar menjëherë". Vetëm flamuj të bardhë shiheshin në protestë me mbishkrime - "na lini të flasim". Një protestuese e re u shpreh se "kjo është një lëvizje popullore, dhe jo partiake". Shumë vetë janë të shqetësuar se çfarë do të ndodhë, nëse presidenti Puigdemont të martën e ardhshme shpall pavarësinë. A do të aktivizojë Spanja nenin 155 dhe do t'i heqë autonominë Katalonjës? Si do të reagojnë përkrahësit e separatistëve? Do të ketë dhunë? Të gjitha këto janë

## Katastrofa e panjohur



shqetësimet e pjesës tjetër të katalonjasve, krahas separatistëve. Një grua e zemëruar shprehet se në jemi "shumica që hesht. Jemi ata 60% që nuk shkuan në referendum". Politikanët duhet të bëjnë punën e tyre, e të vendosin për ne popullin, e jo për qëllimet e tyre politike", thotë protestuesja e zemëruar. Politologu Oriol Bartomeu nga Universiteti i Pavarur i Barcelonës thotë se "shumica e katalanëve duan të qëndrojnë në Spanjë, nëse pozicioni autonom i vendit forcohet". Problematike sipas politologut është se Madridi nuk do të lëvizë asnjë centimetër, sepse "pala spanjolle ka ndjesinë se fiton, pse duhet të lëvizë ajo? Ajo mendon, ose ju dorëzoheni komplet, ose deklaroni njëanshëm pavarësinë?" Por sipas Bartomeut,

kjo do të ishte me rrezik për qeverinë e Katalonjës, sepse nuk ka shumicë për këtë gjë. Si pasojë, qeveria e Spanjës do të aktivizonte nenin 155. E pas kësaj? Politologu Oriol Bartomeu thotë se "kjo do të ishte katastrofa e panjohur". Çfarëdo deklarate pavarësie të bëhet nga Katalunja, nuk do të ketë efekt! Ky është paralajmërimi i kryeministrit spanjoll Mariano Rajoy, i cili ka shtuar më tej se nuk e përjashton mundësinë që t'ia pezullojë autonominë e zgjeruar rajonit katalanas. Në një intervistë për gazetën "El País", Rajoy refuzoi gjithashtu edhe ndërmjetësimin për të zgjidhur këtë situatë krize. Gjatë së shtunës, mijëra njerëz u mbledhën në protesta mbarëkombëtare, në mbështetje të unitetit të vendit. Demonstratat

ishin në kundërpërgjigje të referendumit të diskutueshëm të mbajtur të dielën e kaluar, mbi pavarësinë e Katalonjës. Rezultatet përfundimtare të referendumit në rajonin verilindor tejet të pasur, treguan se 90% e popullsisë prej 2.3 milionë banorësh votuan pro shkëputjes, por pjesëmarrja ishte vetëm 43%. Madje ka pasur edhe pretendime për parregullsi të shumta, ndërsa shumë kuti votimi u sekuestruan nga policia spanjolle gjatë bastisjeve të qendrave të votimit për të mos lejuar mbarëvajtjen e procesit. Afro 900 persona u plagosën, teksa policia përpigje të zbatonte urdhrin e Gjykatës Kushtetuese spanjolle për të ndaluar votimin, duke shpërndarë votuesit. Edhe 33 policë mbetën gjithashtu të plagosur.

## Brenda 9 muajve janë vrarë të paktën 185 persona nga torturat

SNHR ka publikuar raportin në lidhje me personat që kanë vdekur nga tortura, sulmet në qendrat shëndetësore si dhe punonjësit e mediave që kanë humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës në Siri

Rrjeti Sirian për të Drejtat e Njeriut (SNHR), njoftoi se në periudhën janar-shtator të vitit 2017 të paktën 185 persona kanë humbur jetën nga tortura, ndërsa 36 punonjës të medias dhe 93 punonjës shëndetësor kanë humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, transmeton Anadolu Agency (AA). SNHR ka publikuar

raportin e muajit shtator në lidhje me personat që kanë vdekur nga tortura, sulmet në qendrat shëndetësore si dhe punonjësit e mediave që kanë humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës në Siri. Në muajin shtator të paktën 24 persona kanë humbur jetën nga tortura, ku 23 prej këtyre kanë vdekur nga torturat e regjimit të Ba-



shar Al Asadit dhe mbështetësve të tij. Në raportin në të cilin është theksuar se vdekjet nga torturat në Siri që nga fil-

limi i luftës së brendshme janë duke vazhduar, është njoftuar se në 9 muajt e fundit kanë humbur jetën të paktën 185

persona nga torturat. SNHR njoftoi se në muajin shtator 4 punonjës të mediave kanë humbur jetën në Siri, 2 prej të cilëve janë vrarë nga forcat e regjimit, ndërsa një nga rusët dhe një tjetër nga opozitarët. Në 9 muajt e parë të vitit 36 punonjës të mediave kanë humbur duke u torturuar nga grupe të ndryshme. Gjithashtu në raport është theksuar se në sulmet kundrejt qendrave shëndetësore në 9 muajt e fundit kanë humbur jetën të paktën 93 personel shëndetësor. Sipas raportit të

SNHR, në 9 muajt e parë të 2017 të paktën 4.809 persona janë arrestuar. Në muajin shtator 557 persona janë arrestuar ose janë mbajtur me forcë nga grupet të ndryshme në Siri. Mes 316 personave të cilat mbahen me forcë nga forcat e regjimit gjenden 31 fëmijë dhe 55 gra. SNHR në raportin e javës së kaluar kishte njoftuar se në sulmet e palëve që janë në përleshje në Siri, në muajin shtator kanë humbur jetën të paktën 912 civilë mes të cilëve 200 fëmijë dhe 144 gra.



Clint Williamson, prokurori që drejton hetimin e Gjykatës së Hagës për vrasjet në Sanski Most, tha se problemi me ndjekjen penale të luftëtarëve të Arkanit ishte se ata e kishin fshehur identitetin e tyre

**Paraushtarakët e udhëhequr nga zoti famëkeq i luftës, Zeljko Raznatovic, I njohur si Arkan, e çanë rrugën me luftë për në Bosnje, Kroaci dhe Kosovë, por përse asnjë prej tyre nuk është burgosur për krimet e njësive të tij?**

# PARAUSHTARAKËT E ARKANIT

## Tigrat që ia mbathën nga drejtësia

Jusuf Trbic kujton herën e parë kur e pa Arkanin, të ulur në një kamion të mbushur me armë në Bijeljina në lindje të Bosnjës. Ishte ora 4 e pasdites më 12 prill, 1992, pasi forcat serbe morën në kontroll qytetin. Trbic e njohu fytyrën e Zeljko Raznatovicit nga lajmet televizive, ai ishte tashmë i njohur si një burrë që duhej t'ia kishe frikën. Trbic sapo ishte kapur nga Rojet Vullnetare Serbe të Arkanit, "Tigrat". Gjatë disa orëve të ardhshme, përgjatë natës përpara agimit, ai u rrah dhe u torturua, ndonjëherë edhe në prani të vetë Arkanit. "Ata e dinin se çfarë po bënin", tha Trbic për BIRN. "Nuk kisha asnjë milimetër lëkurë të bardhë, ma kishin bërë të gjithë të zezë dhe blu". Ai u lirua më pas sepse Arkan i kishte kapur për një arsye - ai ishte një gazetar vendas dhe shefi i paraushtarakëve donte që ai të transmetonte një apel të myslimanët në Radio Bijeljina që ata të dorëzonin armët. Të tjerët nuk ishin me aq fat.

Një grua nga Bijeljina që kërkoi të mbetej anonime, tha se ajo ishte 19 vjeçe kur burrat e Arkanit trokitën në derën e familjes së saj një natë prilli në 1992. "Ata ishin të maskuar, ndaj mund t'i shikoje vetëm sytë", kujton ajo. Paraushtarakët grabitën sendet e familjes, morën para dhe ar. Një luftëtar e goditi atë në shpinë dhe ajo humbi ndjenjat. Kur u zgjua, ajo dhe kunata e saj ishin të zhveshura dhe të përgjakura. Ditën tjetër, Arkan i shkoj dhe e përdhunoj atë, pretendon ajo. "Arkani erdhi te unë për herë të parë pas asaj nate. Ai erdhi, më kapi për flokësh dhe më largoi. Ai më çoi në një apartament dhe abuzoi me mua atje. Më ktheu pas gjysmë të vdekur dhe më pas e përsëriti këtë edhe ditën tjetër", tha ajo në një intervistë për BIRN. "Më pas të tjerë ushtarë erdhën dhe më abuzuan përpara femijëve të mi, vjehrrës dhe kujtdo tjetër", vazhdoi ajo. "Iu përgjërova atyre të më vrisnin sepse nuk mund të vuaja më gjatë. Ata qeshën me cinizëm dhe ë thanë se nuk fitonin asgjë nëse më vrisnin, sepse unë do të vrisja veten".

Pavarësisht se dëshmia e saj nuk është dhënë kurrë në gjykatë, ajo është njohur zyrtarisht si një viktimë e përdhunimeve të luftës nga shteti i Bosnjës dhe është kompensuar për atë që ka hequr. Vendimet



e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Ish-Jugosllavisë kanë treguar se të paktën 48 persona janë vrarë në Bijeljina nga paraushtarakët serbë në dy ditët e para të prillit 1992. Por asnjëri prej burrave të Arkanit nuk janë burgosur për vrasje, përdhunim apo plaçkitje - ose për krime të tjera që akuzohet se kanë bërë gjatë luftës në ish-Jugosllavi në vitet '90. Arkan i kishte akuzuar për krime luftime nga gjykata e Hagës në kohën kur u vra në Hotelin Ndërkombëtar të Beogradit në janar 2000, por vrasësi u sigurua që ai të mos gjykohej kurrë. Që atëherë, vetëm një nga luftëtarët e tij është dënuar për krime luftime teksa shërbente me Tigrat - Boban Arsic, u shpall fajtor nga një gjykatë kroate për vrasjen e një çifti të martuar në një fshat të vogël në 1992 - ai u dënua në mungesë sepse vendndodhja e tij ishte e panjohur. Disa Tigra janë burgosur që atëherë për krime të tjera gjatë dhe pas luftërave në Ballkan, si vrasja e kryeministrit serb Zoran Djindjic në 2003, por nuk janë dënuar për asgjë që kanë bërë gjatë luftimit për Arkanin. Eksperti i Ballkanit, Christian Axboe Nielsen, asistent profesor në Studimet



• Një burrë boshnjak përgjërohet për jetën e tij i marrë peng nga Tigrat në Bijeljina. Foto Ron Haviv

Europiane Juglindore në Universitetin e Aarhusit, thekson se Tribunali i Hagës u ngrit për të hetuar të dyshuar të nivelit të lartë, jo luftëtarë të zakonshëm: "Hamendësimi dhe pritisshmëria ishte që gjykatat e krimeve të luftës të vendede të ish-Jugosllavisë do të fillonin të gjykonin me kalimin e kohës njësinë e Arkanit". Por kjo nuk ndodhi. Në Serbi, shpjegoi Nielsen, hetimet gjithashtu "shmangën ndjekjen e zinxhirit komandues", nuk shënjestruan kurrë zyrtarë të lartë që mundësuat ekzistencën e njësive paraushtarakë. "Ka pak dhe pothuajse aspak vullnet - dhe pak oreks publik - për këtë gjë në Serbi edhe sot",

tha ai.

### NJË KARRIERË KRIMINALE

Zeljko Raznatovic u lind në qytetin e vogël sllaven Brezice më 17 prill, 1952 dhe ai ishte i mirënjohur te policia e shumë vendeve nëpër Europë në kohën kur filloi konflikti jugosllav. Ai u arrestua fillimisht në Beograd më 1966 për vjedhjen e kuletës së një gruaje dhe kaloi një vit në paraburgimin e të rinjve, përpara se të shkonte në Europën perëndimore në '70 dhe t'i hynte një dekadë kriminale. Në vitet 1973 dhe 1983, ai u hap me një seri dënimesh dhe mandatarrestesh për grabitje banke, grabitje dhe tentativë vrasje



• Një nga Tigrat shkelmon trupin e burrit që sapo është qëlluar nga paraushtarakët në Bijeljina në mars 1992. Foto Ron Haviv

në Belgjikë, Norvegji, Suedi, Gjermani, Australia, Zvicër dhe Itali. Ai ia doli t'ia mbathte nga shumica e burgjeve ku mbahej. Pasi u kthye në Serbi, ai u bë lider i tifozëve të futbollit në Beograd Ylli i Kuq, "Delije", që do ta njihje me disa nga Tigrat e tij të ardhshëm. Gazetari Filip Svaram, që ka studiuar nga afër Arkanin, tha për BIRN se shërbimi shtetëror i sigurisë në ministrinë e brendshme serbe e ngarkoi atë me themelimin e njësive në vjeshtën e 1990 për të kryer "operacione të errta" në Kroaci. "Ata oficerë të sigurisë shtetërore i thoshin Arkanit me saktësi se çfarë prisnin prej tij", shpjegoi Svaram. "Në kthim, Arkanit i jepeshin përfitime të ndryshme për nderet që ai i bënte sigurisë së shtetit. Këto përfitime ishin kryesisht të natyrës ekonomike". Mbrojtja nga hetimi penal për aktivitetet e tij kriminale ortodokse ishin një tjetër stimul për liderin e sapocaktuar të milicisë, i cili organizonte operacione grabitje në territorin e serbëve në Kroaci dorur disa shërbime të sigurisë së shtetit, Arkanit nuk iu përmbaj ligjit", tha Svaram. Ndonëse Arkanit u arrestua në tetor 1990, përpara luftës në Kroaci, dhe u dënua me pesë vite burg për planifikimin e një sulmi terrorist pasi policia gjeti armët në makinën e tij, ai nuk u gjykua për këtë. Svaram thotë se ai beson një thashethem të njohur se ministriat e brendshme serb dhe kroat bënë një marrëveshje për të liruuar Raznatovicit: "Kjo i tregon të gjitha se sa i rëndësishëm ishte Arkanit për sigurimin e shtetit serb, që zyrtarët e lartë u lidhën për ta nxjerrë atë nga burgu". Roja Vullnetare Serbe ishte një forcë relativisht e vogël e përbërë nga ultrasit Delije të futbollit, kriminelët dhe vullnetarët e zakonshëm që admironin Arkanin dhe besonin në kauzën e tij, si Borislav Pelevic, që u bë ndihmësi i tij më i afër dhe drejtoi më pas Partinë e Unitetit Serb. "Kishte gjithnjë rreth 500 burra, disa vinin dhe të tjerë iknin. Sipas vlerësimit tim, rreth 10,000 burra ishin pjesë e rojës në një farë mënyrë në ato vite", tha Pelevic, i cili është tani president i Lidhjes Europiane të Kikboksit. Ai gjithashtu mohoi pretendimet se paraushtarakët ishin financuar nga sigurimi shtetëror serb. Arkanit ishte "shumë i pasur", i tha ai BIRN-t, dhe emigrantë të pasur serbë e sponsorizoi. Tigrat ishin kryesisht të vendosur të mbështetnin Ushtrinë Popullore Jugosllave - siç bënë gjatë

rrethimit të qytetit kroat të Vukovarit në 1991 - por imazhi i tyre si brutal, vrasës të stërvitur kishte një ndikim qetësues për armiqët e Beogradit: "Çfarë kishte më shumë rëndësi ishte efekti i propagandës që regjimi i Slobodan Millosheviçit krijoi falë Arkanit", sugjeron Svaram. Ose sipas Pelevic: "Kur njerëzit dëgjonin që Tigrat e Arkanit po vinin, 'Ustasët' [nacionalistët kroatë] dhe myslimanët zakonisht largoheshin".

Tigrat u akuzuan fillimisht për krime luftime gjatë luftimeve në Tenja në Kroaci në korrik 1991, kur të paktën 29 persona u vranë dhe mbi 2900 joserbë u dëbuan, sipas Qendrës së Ligjit Humanitar në Beograd. Më pas, kreu i forcave speciale serbe të ministrisë së brendshme, Radovan Stojicic i njohur si Badza, i siguroi atyre një kamp stërvitjeje në një bazë të vjetër të mbrojtjes territoriale jugosllave në fshatin kroat të Erdut, që mbeti shtabi i tyre deri më majin e 1996. Ranko Momic, një luftëtar serb, shtëpia e të cilit pranë qytetit boshnjak Doboj u dogj në fillim të luftës, shkoi në Erdut për t'iu bashkuar burrave të Arkanit pasi shërbeu më herët si një ushtar i rregullt dhe si pjesë e brigadës së policisë speciale. "Nuk jam ndër një kurrë më mirë dhe askund nuk ishte më mirë", tha Momic për BIRN. "Ishte luftë dhe njerëzit po vdisnin, por nuk jam ndër një kurrë më mirë se atje. Atje kishte stërvitje dhe disiplinë, por gjithçka ishte në nivelin më të lartë... ato ishin kohë të paharrueshme".

Ndonëse civilë mund të jenë vrarë aksidentalisht nga predhat apo granatat, Tigrat nuk kryen kurrë krime luftime, këmbënguli Momic. "Kur isha atje, që ishte veç dy vjet përpara, po luftonim me nder, në mbrojtje të vendit tonë dhe nuk pashë të kryheshin krime luftime.

Ndoshta dikush po thoshte se ai ishte një anëtar i Rojës Vullnetare Serbe dhe bëri diçka, por unë nuk e di, por ne, anëtarët e vërtetë, nuk kryem asnjë krim", tha ai. Disa burra që stërviteshin në kamp në Erdut dhe luftonin me Tigrat nuk ishin atje me zgjedhjen e tyre. Dezeritorët e ushtrisë dhe refugjatët serbë ishin të detyruar t'i bashkoheshin paraushtarakëve të Raznatovicit. Dragan Pjevac, një refugjat serb nga Kroacia, tha për BIRN që ai ishte rrethuar nga policia në Beograd në gusht 1995 dhe u dërgua në Erdut, pas së cilës u dëbua në territorin e kontrolluar nga serbët në manastirin Beli



për tri muaj derisa marrëveshja "Dayton e Paqes" i dha fund luftës. Disa prej rekrutëve të sjellë në Erdut u rrahën, poshtëruan dhe u quajtën tradhtarë, tha Pjevac. Ai kujtoi kur Arkani dha një fjalim për të nxitur dy rreshta luftëtarësh që të pushtonin rajonin Krajina të Kroacisë, që Zagrebi sapo e kishte marrë nga forcat e Beogradit. "Ai i dha fund fjalimit të tij me fjalët, 'A do të kthehemi, të marrim përsëri Krajinan, a do të kthehemi?' Ne qëndruam atje, të humbur në hapësirë; njerëzit po pyesnin çfarë po u ndodhte. Burrat e Arkanit ishin prapa, duke shtyrë ata që ishin në rreshtin e dytë të thoshin 'Po do të kthehemi!' Dhe ata burra të shkretë nga pas bërtisnin "po", por jo aq fort. Arkani tha: 'Me zë më të lartë. A do të kthehemi?' Ata e goditën rreshtin e dytë më fort, sepse përgjigjja e tyre nuk ishte mjaftueshëm e lartë që të dëgjohej për zotërinë". Rreth 700 burra si Pjevaci po e padisin aktualisht Serbinë me pretendimin se e detyroi të shkonte në luftë.

#### NJË BURRË I PAMËSHIRSHËM

Pretendimet për krime luftime dhe pastrim etnik vazhduan të ndiqnin pas Tigrat tekta ata hynin në qytetin Bijeljina në prill 1992. Jusuf Trbic beson se pavarësisht se trupat e rregullta serbe mund të kontrollonin qytetin, burrat e Arkanit ishin çuar që çdo vrasje e civilëve t'i ngjeshin 'parausharakëve të paligjshëm' dhe që ata t'i fusnin frikën popullatës vendase - për të treguar sesi do të bëheshin gjërat. Arkan Arkan ftoi gjithashtu fotoreporterin amerikan Ron Haviv që të bënte foto të burrave të tij, që rezultoi në foton e famshme të Arkanit dhe ortakëve të tij të maskuar që pozonin në një tank me një këlysh tigr, po ashtu edhe me fotot dramatike të një çifti mysliman të qëlluar dhe të një luftëtar serb që shkelmonte një kufomë. "Mendimet e mia të vetme kur bëja ato foto ishte se më duhej një Tigër në të njëjtën kornizë me viktimat që të provoja se kish të ndodhur ky krim luftime", tha Haviv për BIRN. Sa për Arkanin, fotoreporterit kujton: "Ai ishte i zgjuar, me sharm dhe i pamëshirshëm".

Tigrat më pas vazhduan të luftonin në Brcko dhe Zvornik. Atje, përsëri, burrat e tij u akuzuan për vrasje, plaçkitje, pastrim etnik dhe përdhunim. Burrat e Arkanit u tërhoqën nga Bosnja në verën e 1992 pasi shefi i parausharakëve kishte një mosmarrëveshje me komandantin e ushtrisë serbe të Bosnjës, Ratko Mlladiç, që mendonte se ai ishte një kriminel. Një vit më pas, ai ngriti partinë e tij politike. Ai u kthye në Bosnje për aventurën e tij të fundit kriminale në shtator 1995, kur ai dhe burrat e tij hynë në zonën veriperëndimore të Sanski Most, rrëmbuan myslimanë vendas dhe i dërgoi ata në një hotel ku i izoloi në një dhomë dhe i

rrahu, siç pretendohet. 20 të burgosur u çuan më pas në fshatin periferik Trnovo, ku të gjithë përveç njërit, u vranë. Vrasjet në Sanski Most çuan në ndjekjen penale të Arkanit nga Gjykata e Hagës për krime kundër njerëzimit, vrasje, shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës dhe dhunim të ligjeve dhe kushteve të luftës. Megjithatë, Zeljko Raznatovic ishte i vetmi person i akuzuar, dhe me vdekjen e tij, askush nuk është akuzuar për vrasjet.

#### ARKANI I FAMSHËM

Roja Vullnetare Serbe u shpërnda në prill 1996, por Arkani mbeti famëkeq. I martuar me yllin e muzikës folk Ceca, ai mori përsipër një klub futbollit, FK Obilic, që shpejt fitoi kampionatin kombëtar, siç pretendohet përmes kërcënimeve dhe intimidimeve. Shefi i parausharakëve ishte bërë një hero i mafies, thotë Filip Svarm. "Arkani është idhulli i çdo kriminelit", thotë Svarm. "Pse? Sepse Arkani ishte edhe polic edhe shef i mafies në të njëjtën kohë. Sepse Arkani ishte edhe komandant parausharakësh edhe pronar i një klubi futbollit. Sepse ai ishte në shoubiz dhe një person që kërkohet shumë nga Interpoli". Por ndonëse Arkani nuk shkoi përsëri në luftë, disa nga burrat e tij morën pjesë në konfliktin final të Slobodan Millosheviçit në Kosovë nga 1998 në 1999. Në vend që të luftonin si Roja Vullnetare Serbe, ata shkuan më së shumti në Kosovë si pjesë e njësisë të sigurimit të shtetit, veçanërisht si e frikshmeja Njësia e Operacioneve Speciale JSO, sipas vendimeve të dhëna nga ICTY. Disa nga anëtarët e JSO më vonë u dënuan për vrasjen e kryeministrit Zoran Djindjic në 2003. "Nuk kishite nevojë [për Tigrat në Kosovë]", shpjegoi Borislav Pelevic. "Ne kishim polici të fortë, që spastroi UÇK menjëherë. Kishim një ushtri të fortë atje, kishim hynë në një barakë ushtarake në qytetin e Gjakovës

Ish-kapiteni Nike Peraj i Ushtrisë Popullore Jugosllave, një dëshmitar i rëndësishëm në gjyqin e Millosheviç, tha se disa luftëtarë që mbanin veshur stemën e Tigrave hynë në një barakë ushtarake në qytetin e Gjakovës



Disa nga aleatët më të rëndësishëm të Arkanit janë tashmë të vdekur. Sponsori i tij i forcave speciale, Radovan Stojicic, u qëllua në një restorant në Beograd në 1997, ndërsa politikani kukull i tij, Slobodan Millosheviç, vdiq në burg në Hagë në 2006. Më famëkeqi nga Tigrat e tij, Milorad Ulemek, i njohur si 'Legjia', po vuan 40 vite burg për rolin e tij në vrasjen e Djindjic



në Kosovë nëntor 1998, ku iu bashkuan parausharakëve serbë. "Ata kishin dorë të lirë të bënin çfarë të donin", tha Peraj për BIRN, ndonëse ai beson se ata nuk ishin të përfshirë në luftime të drejtpërdrejta. "Ata ishin plaçkitës", tha ai. Peraj tha gjithashtu se ai pa disa nga burrat e Arkanit në një fshatin Meja pas një masakre të rreth 500 shqiptarëve nga forcat e Beogradit në prill 1999. Ata kishin mjekër dhe shumë tatuazhe dhe një prej tyre kishte njolla të

kuqe në pantallona. "Ishte gjak", tha Peraj. Ish-Tigri Ranko Momic shkoi gjithashtu për të luftuar në Kosovë në 1998, por si një anëtar i njësisë rezerviste të policisë serbe. Kur bombardimet e NATO-s filluan në 1999, Momic iu bashkua ushtrisë. Në fillim të këtij viti, ai u burgos me 15 vite burg për përfshirje në vrasjet e 100 shqiptarëve të Kosovës - por si një anëtar i Ushtrisë Jugosllave të skuadrës 177 Ata ndërhyrjes, jo si pjesë e Rojës Vullnetare Serbe. Momic është aktualisht në

liri me kusht tekta po apelon vendimin, i cili gjithashtu dënoi një tjetër ish-Tigër, Milojko Nikolic, me burg për 20 vite për të njëjtin krim.

#### TË VËRTETA TË HIDHURA

Disa nga aleatët më të rëndësishëm të Arkanit janë tashmë të vdekur. Sponsori i tij i forcave speciale, Radovan Stojicic, u qëllua në një restorant në Beograd në 1997, ndërsa politikani kukull i tij, Slobodan Millosheviç, vdiq në burg në Hagë në 2006. Më famëkeqi nga Tigrat e tij, Milorad Ulemek, i njohur si 'Legjia', po vuan 40 vite burg për rolin e tij në vrasjen e Djindjic. Ish-shefi serb i sigurimit të shtetit, Jovica Stanisic dhe zëvendësi i tij Franko Simatovic u liruan nga Gjykata e Hagës në 2013 për kontrollin mbi njësi si Tigrat, ndonëse gjykata zbuloi se ata furnizuan dhe financuan parausharakët serbë. Presidentja serbe e Bosnjës, Biljana Plavsic, që pretendohet se ka ftuar Arkanin në Bijeljina, pranoi se ajo ishte fajtoze për mbikëqyrjen e mizorive dhe u dënua me 11 vite nga gjykata e OKB. Por disa prej atyre që pretendohet të kenë përgatitur mizoritë janë ende të lirë. Ish-Tigra të tjerë janë me shumicë në Serbi dhe nuk janë ndjekur kurrë penalisht. Prokuroria boshnjake ka thënë se nuk do të komentojë nëse ndonjë nga burrat e Arkanit është aktualisht nën hetim. Por avokati boshnjak i krimeve të luftës, Miodrag Stojanovic, që është aktualisht mbrojtësi i Ratko Mlladiç në Hagë, tha se ishte e pamundur për Sarajevën të ndiqte penalisht Beogradin që ka vullnet të çojë për gjykim serbët e dyshuar.

"Është e vështirë për prokurorinë e Bosnjës apo gjykatat që ta bëjnë këtë gjë. Ata mund të ngrenë një aktakuzë, por Serbia nuk do t'i ekstradojë kurrë", tha Stojanovic. Prokuroria boshnjake ka thënë se nuk do të komentojë nëse ndonjë nga burrat e Arkanit është aktualisht nën hetim.

Por avokati boshnjak i krimeve të luftës, Miodrag Stojanovic, që është aktualisht mbrojtësi i Ratko Mlladiç në Hagë, tha se ishte e pamundur për Sarajevën të ndiqte penalisht Beogradin që ka vullnet të çojë për gjykim serbët e dyshuar. "Është e vështirë për prokurorinë e Bosnjës apo gjykatat që ta bëjnë këtë gjë. Ata mund të ngrenë një aktakuzë, por Serbia nuk do t'i ekstradojë kurrë", tha Stojanovic. Prokuroria serbe tha se ishte bashkëpunuese me prokuroritë e shteteve të tjera në rajon mbi çështjet e lidhura me krimet e kryera nga Tigrat e Arkanit, por nuk dha detaje sepse hetimet janë në vazhdim.

Ish-Tigri, Borislav Pelevic tha megjithatë se mungesa e ndjekjeve penale tregonte se ata ishin të pafajshëm: "Kanë kaluar 20 vite që nga lufta, si është e mundur që askush nuk është hetuar nga

Gjykata e Hagës apo nga prokuroria e krimeve të luftës?" pyeti ai në mënyrë retorike. "Si është e mundur që askush nga Roja nuk është akuzuar, asnjëri prej tyre?"

Clint Williamson, prokurori që drejton hetimin e Gjykatës së Hagës për vrasjet në Sanski Most, tha se problemi me ndjekjen penale të luftëtarëve të Arkanit ishte se ata e kishin fshehur identitetin e tyre. "Ata shpesh vinin maska dhe ne nuk mundëm të gjenim dëshmitarë që t'i identifikonin ata", tha Williamson për BIRN në 2010. "Ne hetuam veprimtaritë e 'Tigrave' të Arkanit për një kohë të gjatë dhe mblodhëm prova për Sanski Most. Ne planifikuan që të vazhdonim hetimet për Zvornikun, Bijeljinen, Vukovarin, por më pas ata u vranë", shtoi Williamson. Jasmin Mesic, një prokuror boshnjak me shumë eksperiencë në hetimet e krimeve të luftës, ra dakord se kishte probleme serioze në praktikën e sjelljes së parausharakëve serbë përpara drejtësisë. "Këta njerëz kanë ardhur nga zona të tjera, nga shtete të tjera, ndaj asnjë prej viktimave apo të mbijetuarve nuk i njeh. Ata përdornin zakonisht pseudonime, ndaj kjo është arsyeja përse është shumë e vështirë të identifikohen fajtorët përmes dëshmimeve të viktimave, siç bëhet zakonisht në gjyqet e krimeve të luftës", shpjegoi ai. Në Bosnje megjithatë, shumë besojnë se burrat e Arkanit nuk janë ndjekur penalisht për shkak të lidhjeve që kishte lideri i tyre me zyrtarët e policisë serbe, politikanët dhe krimin e organizuar. "Njësia e tij bëri të njëjtat gjëra në çdo vend që shkoi, por shumë njerëz në Serbi, politikanë në pozicione të larta, janë të përfshirë dhe ndjekja penale e tyre në këto krime mund të hidhte dritë mbi shumë të vërteta të pakëndshme", sugjeroi Jusuf Trbic. Emir Musli, që mban mend ta ketë parë Arkanin drejtonte një bazukë përpara ndërtesës së komunës së qytetit të tij të lindjes Bijeljina në 1992, ndërsa burrat e tij abuzonin me myslimanët në rrugë tekta i merrnin për t'i torturuar dhe vranë, thotë se ishte e dukshme që shefi i parausharakëve kishte status më të lartë se trupat e zakonshme.

"Ai ishte mjeti i përdorur për të vranë, por edhe për të kontrolluar. Dua të them që njësia e tij nuk ishte parausharakë, ai ishte pjesë e sigurimit të shtetit serb", tha Musli për BIRN. "Kjo është arsyeja përse gjërat po lihen në harrësë". Ashtu si Arkania mbathi nga shumë qeli gjatë karrierës së tij kriminale, burrat e tij ia kanë dalë deri më tani të shmangin burgun për krimet e tyre të luftës me njësinë Tigrat. Musli tha se ai kishte pak shpresë se kjo do të ndryshonte: "Arkani u vra, dhe bashkë me të, e gjithë çështja u pushua". (BIRN)



• Një grua boshnjake me burrin që është qëlluar nga Tigrat e Arkanit në Bijeljina në mars 1992. Ajo u qëllua disa çaste më vonë. Foto Ron Haviv



# XHOVANI FALCONE

## Njeriu që ndryshoi Italinë, edhe pse i vdekur...

Palermo ka ndryshuar pas atentateve 20 vjet më parë. Kokat drejtuese të mafies së atëherëshme gjenden në burg, kontakte të rëndësishme janë ndërprerë, e megjithatë mafia ekziston ende, thotë kryebashkiaku Leoluca Orlando: "Krimi i organizuar është transformuar nga mafia që qëllon dhe kryen atentate, në një mafie me kostum dhe kravatë, e cila fshihet në botën e financave. Të luftosh mafien sot është më pak e rrezikshme, por më e vështirë"



20 vjet më parë mafia vrau në Sicili përndjekësin më të famshëm të mafies, gjykatësin Xhovani Falcone. Por 20 vjet pas atentatit, pikërisht në Palermo, shumë gjëra kanë ndryshuar. Kapaçi, një nga periferitë e Palermos. Këtu autostrada kalon nga qendra e qytetit në drejtim të aeroportit. Më 23 maj 1992, në orën 17:57 këtu shpërthyen 500 kilogramë lëndë eksplozive, të fshehura në një kanal ujërash të zeza nën autostradë. Fuqia e shpërthimit goditi dy makina. Në gërmadha vdiq luftëtari më i njohur dhe më popullor i Italisë kundër mafias, gjykatësi Xhovani Falcone. Viktima të atentatit ranë edhe gruaja e tij dhe tri truporjat.

Si arriti mafia të godiste në shenjë? Planet e lëvizjes së Falcones asokohe mbaheshin sekret me shumë kujdes, pasi konsiderohej shumë i rrezikuar. Falcone ishte kandidati me më shumë shanse për postin e shefit të policisë së re antimafie dhe në sajë të punës së tij ishin dënuar qindra mafiozë. Leoluca Orlando është prej shumë vitesh kryetar i Bashkisë së Palermos; ai vetë ka qenë një nga luftëtarët pararojë kundër krimit të organizuar. "Mafia e kreu atentatin. Por ku mafia vret një gjykatës të rangut të Falcones, atëherë ajo e di se është dikush në aparatit shtetëror, që e mbron. Mafia është kundër shtetit, por njëkohësisht ajo është edhe brenda tij. Ajo është kundër bankave dhe punon brenda tyre. Ajo është kundër kishës dhe brenda saj, është kundër shoqërisë dhe brenda saj. Pasi mafia vrau edhe gjykatësin Paolo Borselino, lindi një lëvizje qytetare e paparë deri atëherë. I mbështetur nga indinjata e këtyre qytetarëve një vit më vonë unë u rizgjodha kryetar i Bashkisë së Palermos".

Këto dy atentate me eksploziv në vitin 1992, kundër gjykatësve Xhovani Falcone dhe Paolo Borselino, e shkundën fort indiferencën në gjithë Italinë: Cosa Nostra u kthye në problem kombëtar. Motra e Xhovani Falcones, Maria, thotë: atentatet kanë pasur patjetër efekt. "Për mafian ishte si një bumerang. Pasi me to

filloi gjithçka. Ky atentat terrorist bëri që njerëzit në atë moment të thoshin: mjaft më! Dhe nën tryninë e vazhdueshme të qytetarëve të indinjuar shtetit iu desh të reagonte në mënyrë të qartë". Shteti dërgoi ushtrinë. Ishte misioni më i madh që prej Luftës së Dytë Botërore. Deri në 12000 ushtarë u vendosën përkohësisht në Sicili për të mbështetur policinë, për gjashtë vjet rresht. Dhe hetimet përparuan shpejt. Një vit pas atentatit u kap autori kryesor, Toto Riina, një bos i mafias nga Korleone. Katër vjet më vonë, më 1996, Michele Prestipino shkoi në Palermo dhe punoi atje deri në vitin 2008 si prokuror. Në aspektin shoqëror, shumë gjëra ndryshuan dukshëm në vitet që pasuan atentatet, thotë Prestipino. "Kisha siciliane e viteve 1992/'93 nuk ishte e njëjta me atë në vitin 2008, sistemi i sipërmarrësve më 1992 nuk ishte i njëjti me atë sot, e njëjta gjë mund të thuhet për shkollat dhe kualifikimin. Ne filluam të përpunonim njohuritë dhe perceptimin tonë për mafien. Ky proces përfshiu mijëra, dhjetëra mijëra, qindra mijëra të rinj. Dhe ky brez është ai që sot drejton shumë sektorë në Sicili". Atëherë filloi një transformim vlerash. Papritur në shkolla u futën orë mësimi për sqarimin politik. Të rinjtë mësonin se çdo

të thotë të bashkëpunosh me mafien. Papritur disa sipërmarrës refuzuan të paguanin paratë për mbrojtje. Studentët themeluan lëvizjen "Addiopizzo" - "Lamtumirë para për mbrojtje". Një nga këta të rinj është Chiara Capri, e cila në moshën pesë vjeç përjetoi pasojat e atentateve me bomba. Ajo shkruan ndërkohë libra mbi mafien, është në prag të përfundimit të studimeve të mjekësisë dhe do të specializohet në psikiatri të mjekësisë ligjore për të përpunuar profile keqbërësish. Edhe për Chiaran gjithçka filloi me vrasjen e Xhovani Falcones, pasi falë tij që fëmijë ajo filloi të interesohet se përse dikush në qytetin e saj të lindjes Palermo, vendos bomba. "Atentatet që u kryen ato vite e vendosën qytetin në një lloj gjendje lufte, si për shembull kur në Kabul apo rajone të tjera lufte shpërthen një bombe dhe të gjithë kujtohen më pas se çfarë bënin në atë moment. Edhe pse atëherë isha e vogël, shpërthimi në autostradë, vrasja më vonë e Borselinos, ajo goditje e tmerrshme, ai shpërthim bënë që për mua koha të mbetej në vend". Palermo ka ndryshuar pas atentateve 20 vjet më parë. Kokat drejtuese të mafies së atëherëshme gjenden në burg, kontakte të rëndësishme janë ndërprerë, e megjithatë mafia ekziston ende,

thotë kryebashkiaku Leoluca Orlando: "Krimi i organizuar është transformuar nga mafia që qëllon dhe kryen atentate, në një mafie me kostum dhe kravatë, e cila fshihet në botën e financave. Të luftosh mafien sot është më pak e rrezikshme, por më e vështirë".

Për Maria Falconen, lufta kundër mafies është kthyer në qëllim jete. Ajo ka themeluar një fondacion dhe organizon fushata sqaruese në shkolla në të gjithë vendin. Ajo thotë se e pyet shpesh veten se çfarë do të kishte ndodhur nëse vëllain e saj nuk do ta kishin vrarë, nëse ai do të kishte pasur mundësi të vazhdonte punën.

"Çdo të kishte ndodhur nëse do të kishte pasur në krah një shtet dhe një shoqëri që e mbështesnin, në vend që të bëhej shënjestër e zilisë, akuzave dhe dyshimeve? Pyetja ime është: ku do të ishim tani? Ndoshta Cosa Nostra do të ishte mundur vërtet". Masakra e Kapaçit hyri në histori. Luftëtari më i aftë i mafies vdiq nga duart e kriminelëve, ndër të tjera edhe sepse politika e kishte lënë në baltë dhe nuk ishte angazhuar në kohë për të. Në autostradën e aeroportit në Palermo dy shtylla të mëdha të kuqe graniti kujtojnë Xhovani Falconen, gruan dhe truporjat e tij si dhe ditën në të cilën mafia i shpalli luftë shtetit.





## Keni dhimbje koke? Proveni trukun e lapsit

Doktoresha Jane Leonard shprehet se shumica e dhimbjeve të kokës shkaktohen nga stresi, ankthi, lodhja apo shqetësimet emocionale. Por në vend që të përdoren ilaçe të cilat sjellin dhe dëme të tjera anësore, disa ekspertë sugjerojnë që zgjidhja mund të jetë më e thjeshtë, duke vendosur një laps në mes të dhëmbëve. “Dhimbjet e kokës janë të lidhura dhe me muskujt e nollës dhe mbajta e një lapsi në mes të dhëmbëve i ndihmon muskujt e nollës të relaksohen”, shpjegon doktoresha Jane Leonard. Studimet e mëparshme e kanë lidhur dhimbjen e kokës me presionin që i bëhet qafës, pra sforcimin e saj. Sipas këtyre studimeve 80% e dhimbjeve të kokës shkaktohet nga muskujt e qafës. Julie Sugrue, një psikoterapiste u shpreh se koka dhe qafa kanë 36 muskuj të ndryshëm, të cilët përdoren për të lëvizur kokën, për të ngrënë, për të folur, për të bërë shprehje fytyre. Sforcimet e këtyre muskujve mund të shkaktojnë dhimbje në vende të ndryshme, siç quhet dhimbje e deleguar prandaj kjo është arsyeja pse muskujt e qafës shkaktojnë dhimbje, të cilën e ndjejmë në kokë.



## Përse na bën të qajmë qepa

Mark Antony te “Cleopatra” e Shekspirat e ka përmendur këtë dukuri si “lotët që jetojnë brenda në qepë”. Por në të vërtetë përse na bëjnë qepët të qajmë? Dhe pse vetëm disa lloje qepësh na bëjnë të lotojmë ndërkohë që perimet e tjera të së njëjtës familje si hudhrat, nuk japin të njëjtin efekt? Kur një perime është e dëmtuar, qelizat e saj janë të hapura. Bimët shpeshherë përpriqen të mbrojnë veten duke lëshuar kimikate me shije të hidhur, që quhen polifenole, në mënyrë që të mbrohen nga insektet të cilat përpriqen t'i hanë. Por mekanizmi mbrojtës i qepës shkon më larg se kaq, duke prodhuar një element edhe më irritues, oksidin propantial, i cili ka për qëllim të bëjë që qepa të preket sa më pak nga insektet e dëmshme. Ky kimikat i avullshëm është ajo që njihet si faktori lotsjellës. Fakti që ai është avullshëm do të thotë që sapo ky element të lirohet, shpejt gjen rrugën në sytë tanë. Aty shpërbëhet në kontakt me ujin dhe krijon një sipërfaqe në sy duke formuar acidin sulfurik. Kjo irriton një gjëndër në sy që njihet si gjëndra e lotit, prandaj edhe quhet kimikati lotsjellës. Për shkak se sasia e acidit të prodhuar është e vogël, efekti i tij është vetëm irritues dhe jo i dëmshëm.

# Sa është i rrezikshëm gjumi i tepërt për shëndetin?

Fletja e përditshme gjatë një periudhe më të gjatë se ora 9:00 mund të jetë një shenjë e ndonjë gjendjeje shëndetësore, ose mund të rrisë rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve të caktuara



Mund të jetë pak e vështirë të besohet se gjumi i tepërt mund të jetë po aq i dëmshëm sa një gjumë i vogël, por kërkimet kanë treguar se kjo është e vërtetë. Shumica e të rriturve kanë nevojë për 7 deri në 9 orë gjumë çdo ditë, për të funksionuar sa më mirë që mundën. Fjetja e përditshme gjatë një periudhe më të gjatë se ora 9:00 mund të jetë një shenjë e ndonjë gjendjeje shëndetësore, ose mund të rrisë rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve të caktuara.

**RRITET RREZIKU I DEPRESIONIT.** Një studim ka treguar se ata që flenë më shumë se 9 orë kanë një rritje 27% të rrezikut të depresionit. Përveç kësaj, ata ishin më të prirë për ndryshime të papritur të disponimit.

**VEPRIM I DËMSHËM NË TRU.** Hulumtimet nga shkencëtarët amerikanë kanë treguar se gratë që flenë shumë pak ose shumë kanë funksione më pak njohëse pas 6 viteve të stilit të jetesës, sesa bashkëmoshatarët e tyre. Burrat morën pjesë në studim, por shkencëtarët

theksojnë se efekti i gjumit të tepërt të burrat është i njëjtë. **NDËRPRERJA E CIKLIT MENSTRUAL.** Shkencëtarët koreanë kanë analizuar zakonet e gjumit në më shumë se 650 gra që kanë pësuar trajtim in vitro të fekondimit. Ata zbuluan se probabiliteti i konceptimit ishte më i madh tek gratë që flinin 7 deri në 8 orë në ditë dhe më të ulëta në gratë që flinin 9 deri në 11 orë në ditë. Nga kjo mund të konkludohet se gjumi i tepërt është më shumë i dëmshëm për fertilitetin sesa humbja e gjumit. Megjithatë, hulumtimi nuk ka zbuluar korrelacionin e saktë, por beson se gjumi i tepërt ndërpret ciklin menstrual dhe ekuilibrin hormonal.

**RRITET RREZIKU I DIABETIT.** Njerëzit që flenë më shumë se 8 orë në ditë kanë një rrezik dyfish më të lartë të zhvillimit të diabetit të tipit 2 pas 6 viteve të stilit të jetës, pavarësisht nga pesha e trupit dhe indeksi i masës trupore.

**RRITET RREZIKU I OBEZITETIT.** Shkencëtarët kanë gjetur se ata që flenë më shumë se 9 orë çdo ditë në një periudhë 6-vjeçare do të kenë një rrezik 25% më të lartë për të marrë 5 kilogramë. Rreziku mbetet i njëjtë pavarësisht nga futja e zakoneve të shëndetshme të ngrënies dhe stërvitjes.

**RRITET RREZIKU I SËMUNDJEVE TË ZEMRËS.** Ata që flenë më shumë se 8 orë çdo ditë kanë një rrezik në rritje të sëmundjeve kardiovaskulare dhe sulm në zemër. Rreziku i angjinës rritet deri në dy herë.

**RRITET RREZIKU I VDEKJES SË PARAKOHSHME.** Një studim ka treguar se rreziku i vdekjes së parakohshme për ndonjë arsye rritet në mënyrë drastike për njerëzit që flenë shumë ose shumë pak. Personat që flenë tepër rrezikohen 1,3 herë më shumë nga vdekjet e parakohshme në krahasim me njerëzit që flenë nga 7 deri në 9 orë në ditë.

## Brokoli lufton kancerin



Brokoli është ndër ushqimet kryesore që i ndihmon organizmit tuaj. Shkencëtarët thonë se brokoli lufton kancerin. Ata gjetën substanca të caktuara në perime për të bllokuar gjenet e dëmtuara që ishin të lidhura me kancerin. Gjetjet mund të çojnë në një strategji të re për parandalimin dhe trajtimin e kancerit. Substancat e quajtura isothiocyanates mund t'i gjejnë në brokoli, lulelakër, marule ose lakërishtë, dhe ajo ndikon në parandalimin e rritjes së kancerit. Por, askush nuk e di saktë se si këto substanca funksionojnë, që është çelës për zhvillimin e strategjisë së përmirësuar në luftën kundër kancerit të njerëzit.

## Gabimi që bëjmë kur fëmija ka temperaturë



Shumë prindër mendojnë se fëmija me temperaturë të lartë duhet të qëndrojë në vend të ngrohtë dhe të djerësit. Ky është një gabim nga zakonet e bërë nga prindërit. Ngrohja e tepërt e një fëmije me temperaturë të lartë, vetëm sa mund të rrisë temperaturën. Fëmija duhet veshur me rroba të lehta dhe të pastrohet me ujë të vakët për të ulur temperaturën. Mbulimi i fëmijës që ka temperaturë të lartë, me një rrobë ose peshqir të lagur, gjithashtu është ide e keqe. Kjo mund të

shkaktojë dridhje të trupit dhe të rrisë temperaturën e trupit. Temperaturat e larta rritin konsumin e kalorive, kështu që foshnja ka nevojë për më shumë kalori sesa zakonisht. Nëse fëmija refuzon ushqimin, provoni lëngun e ëmbël që i pëlqen. Paracetamoli ose ibuprofeni për largimin e temperaturave të larta nuk duhet dhënë fëmijës, derisa nuk ka një temperaturë prej 38.5 ose më shumë. Nëse nuk dini çfarë të bëni më tepër, telefononi një mjek ose urgjencë dhe kërkoni këshilla.

## Fuqia që gjendet në lëngun e shegës

Vjeshta është stina që ofron më shumë fruta. Në mesin e tyre janë edhe shegët, të cilat konsiderohen si mjaft të shijshme. Shegët na vijnë me tre shije, të ëmbla, tharta dhe jo shumë të tharta.

Përveç shijes ne mund të përfitojmë shumë efekte pozitive për organizmin. Ato janë një frut me forcë antioksiduese të rrallë që nga mbrojnë nga radikalët e lira që prodhohen në organizëm nga disa faktorë dhe që janë të rrezikshme. Një studim ka treguar se nga konsumi i lëngut të shegëve mundësohet ngadalësimi i rritjes së masës tumorale në mushkërinë. Eksperimenti është provuar tek minjtë. Kjo vjen për shkak të forcës së madhe antioksiduese që ka ky frut. Gjithashtu shega mund të parandalojë edhe kancerin e prostatës. Siç është përfolur edhe më herët, shegët ngadalësojnë plakjen. Kjo vjen nga një molekulë që gjendet tek kokrrat e kuqe magjike.

Nëse konsumoni lëng shege të kombinuar me 2-3 hurma Arabie në ditë, keni gjetur ilaçin ideal kundër sëmundjes së zemrës dhe hemorragjisë cerebrale. Lëngu i shegës është jashtëzakonisht me vlera për femrat shtatzëna. Është një burim i pashtershëm vitaminash dhe mineralesh, përfshirë acidin folik që është një element thelbësor për një dietë të pasur të nevojshme gjatë shtatzënisë.

Vlerat anti-inflamatore të lëngut të shegës sigurojnë një qarkullim të mirë të gjakut që është thelbësor për zhvillimin e përgjithshëm të fetusit. Nëse pini lëng shege rregullisht, do të keni flokë të fortë dhe plot shkëlqim. Substancat që gjenden tek shega parandalojnë rënien e flokëve dhe u japin atyre shëndetin dhe shkëlqimin e munguar.




## Rrezikojnë jetën për të shpëtuar lopë e majmunë


Vullnetarët rrezikojnë jetën e tyre për të shpëtuar dhjetëra mijëra kafshë të mbe-tura në mëshirën e një vullkani që "rënkon" në ishullin turistik të Balit, duke bërë udhëtime të rrezikshme në zonën e kuqe për t'i zhvendosur ato. Mali Agung, rreth 75 km larg qendrës turistike të Kuta, është tronditur që nga gushti, duke shkaktuar largimin e 144 mijë njerëzve nga zona, teksa ekspertët paralajmërojnë se një shpërthim mund të jetë i afërt. Ndërsa të shpërngulurit janë derdhur në strehimore të përkohshme ose kanë lëvizur me të afërmit, kafshët - duke përfshirë majmunët e egër, si dhe qentë dhe kafshët e fermave siç janë derrat, pulat dhe lopët - janë lënë në zonën e rrezikut. "Unë jam shumë i shqetësuar sepse të gjithë ne që punojmë së bashku për të shpëtuar kafshët nuk e dinë kur do të jetë shpërthimi", tha Vio Verandhini, nga Rrjeti i Ndhmës për Kafshët në Xhakarta. Ai dhe 12 persona të tjerë, kanë bërë udhëtime të rrezikshme në zonën e kuqe, e cila shtrihet në mes të 9 dhe 12 km larg qendrës së vullkanit. Kafshët zhvendosen në strehimore ku ushqehen dhe kujdesen dhe pronarët inkurajohen që të vizitojnë sa më shpesh që të jetë e mundur për të siguruar mirëmbajtjen e tyre. Retë e avullit të bardhë mbi krater janë vërejtur me frekuencë më të madhe gjatë tre ditëve të fundit, duke rritur probabilitetin e një shpërthimi. Rreth 10,000 lopë janë zhvendosur deri më tani në një evakuim të ndihmuar nga qeveria, tha agjencia për zvogëlimin e fatkeqësive të Indonezisë, por ka rreth 20,000 të tjera për t'u zhvendosur.




## DASHI (20/III-20/IV)

 Jeni paksa i mërzhitur por kjo gjendje do të jetë e përkohshme. Gjërat do të përmirësohen gjatë pasdites! Kjo ka të bëjë me shumë me jetën tuaj pasi që jeni një person shumë i gjallë, si në aspektin profesional ashtu edhe sentimental.


## DEMI (21/IV-20/V)

 Vëni kapak opinioneve të juaja dhe mos jepni më shumë së duhet. Njerëzit janë duke kërkuar çdo shenjë për t'ju thumbuar kështu që duhet të jeni më i kujdesshëm. Kujdes duhet të tregoni edhe për shëndetin.


## BINJAKËT (21/V-20/VI)

 Inteligjenca e juaj është dominante sot kështu që duhet të merreni më shumë me disa aktivitete të cilat duhet t'i bëni orar. Do të arrini në kulm të asaj që keni kërkuar. Në dashuri po ashtu do të keni sukses.


## GAFORRJA (21/VI-22/VII)

 Duhet të mendoni më shumë – përndryshe do të befasoni me disa surpriza të këndshme. Është njëra nga ato ditë kur duhet që t'i jepni më shumë mundësi të tjerët për të punuar. Mos lejoni që një mundësi t'ju ik nga duart.


## LUANI (23/VII-22/VIII)

 Prisi një fitore të madhe sot – kështu që do të arrini të fitoni atë që keni kërkuar më parë! Energjia e juaj e madh ju garanton se do të arrini suksese që nuk i keni parë më parë. Kujdes me paratë!


## VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)

 Keni një altruizëm të paparë në punë që do ju motivojë për të ecur më tutje. Duhet që të ndihmoni një person sepse do ishte mirë për anën e juaj humanitare. Kështu mund të bëni ndryshime serioze edhe për vetën tuaj.


## PESHORJA (23/IX-22/X)

 Jeta e juaj është e begat – por ju duhet më shumë kohë për ngritje në karrierë! Kolegët po kërkojnë shumë nga ju - kështu që jepi ide por edhe kohë. Shpenzoni më shumë energji për të mirën e juaj!


## AKREPI (22/X-21/XII)

 Dikush është duke ju sfidua r shumë prandaj kërkon më shumë së duhet nga ju! Fokusohuni më shumë në një problem që ju preokupon dhe zgjidheni atë. Në dashuri duhet të jeni më i/e kujdesshëm.


## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

 Keni bërë një start të mirë kështu që duhet të jeni më shumë i qartë në punë! Pavarësisht çfarë pune bëni sigurohuni që t'ju shpaguehet mundit. Në dashuri po ashtu duhet të kërkonit më shumë!


## BRICJAPI (22/XII-20/I)

 Prisi kërkesa të ndryshme për ndihmë apo vëmendje sot! Nuk mund të merreni më të gjithë. Është njëra nga ato ditë kur ju duhet që të praktikoni punë që nuk i keni bërë. Megjithatë mos shkatërro një lidhje të re.

## UJORI (20/I-19/II)

 Është një ditë e madhe për ju edhe pse nuk jeni në gjendje të mirë emocionale. Por, ngjarje të jashtëzakonshme do të ndodhin. Yjet ju sugjerojnë që nëse nga mëngjesi keni filluar ditën me kafe atëherë gjërat do shkojnë edhe më mirë.

## PESHQIT (20/II-19/III)

 Shmanguni nga drama dhe shpenzimet sot. Kështu nuk do të shkatërro njerëzit e tjerë të cilët po kërkojnë më shumë nga ju! Ka disa gjëra interesante që po ju rrethojnë kështu që mos refuzoni dhe mos bëni aventura të rrezikshme.

# SUDOKU

	7	5			8	2		
	3			9				
			1				3	7
5				3		8		
	4		8		1		6	
		6		5				3
4					9			
		9		1			2	
		7	2			5	4	

## TRE VJET PA MË TË DASHURIN TONË, PA LULEN E RINISË...



### LUAN TAIRI 1995-2014

Atë ditë Ti, ike në përjetësi, e prapa na le një lum me lot. Mbushen plot tre vjet qëkur buzëqeshja jote kaloi në përjetësi, e ne na mbeti freskia e buzëqeshjes tende dhe zjarri i lotit që rëndon mbi qepallë. Në siparin e kohës renditen ditët, ecin ato pandalshëm e dhembja për Ty sa vjen e shtohet më shumë. Buzëqeshja jote rri e freskët në kujtimet tona, si moshë jote pa i mbushur 19 pranvera, kur ike atij çast të hidhur. Mbete i përjetshëm me buzëqeshjen e lules së rinisë, me mallin e pashuar që sa po vjen e po rritet! Jemi krenarë që të patëm dhe Ti gjithnjë do të qëndrosh në padvdekësinë Tende e në zemrat tona!

**Përballshëm të kujtojmë:** babai Murati, nëna Anishja dhe vëllau Bajrami nga fshati Mahmutaj në Kërçovë.



NË KËTË DATË

Mensur Mamuti	GDHENDJE AKTORJA KOÇOVARE NË FOTO	L	QYTET NË JAPONI	QENDËR PËR MJEKIMIN E TË SEMURËVE NGA TUBERKULOZI
FILOZOFI GJERMAN, VEBER				
FILM ME AKTOREN NË FOTO				
QYTET NË FRANCË SHUMË E VOGLA				
E				
HIDROGJENI		OLIVER TUJST SHITESË E DRITARES PËR TË PENGUAR DRITEN		
ARGJENDI			OZONI QYTET ANTIK NË AZINË E VOGLË	
QYTET NË GJERMANI RADIO-TELEVISIONI (IRLANDEZ (ORIGJ.))				

KOHA	LLQJ GURI GËLQEROR, KRISTALOR	ERBIUMI	ISHULL KROAT	NUË PLANET	PRUËSI I MYFTINISË QË SËSHTË E JONA				
SHKRIMTARI GJILANAS, REXHEPI (SHQ.)									
DRAMË ME AKTOREN NË FOTO								METRI EMRI I DEMAÇIT	
REOMIRI		AUDIO RESPONSE UNIT PËREMËR VETOR				SHKRONJË GREKE NETWORK DATA MOVER			NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE
NJERI I SHQIAR, I RENDËSISHËM (FR.)							NOTË MUZIKORE NDAJFOLJË SASIE		
ELIDA TOPÇIU EMISION TELEVIZIV			NDREQEM RREGULLOHEM (BISED.) GRAMI						
P									

ZGJIDHJET: L, MAKS, ETJA, LION, E IMTA, H, OT AG, O, TRIR, REISI, MEHMETALIU, ERVEHEJA, M, R, ARU, ETA, MARKANT, DO, ET, UJDISEM, PROGRAM, AMI.



## Suedezeit: Divorci është gjenetike

Studime të shumta më parë tregojnë se fëmijët e prindërve të divorcuar kanë më shumë gjasa të divorcohen kur ata të rriten nëse krahasohen me ata që u rriten me prindërit që mbetën të martuar. Por ky model mund të mos jetë i vërtetë për fëmijët e adoptuar, thotë një studim i ri. Sipas hulumtimit, faktorët gjenetikë janë shpjegimi kryesor për trendin e divorcit dhe gjetjet e reja mund të kenë



implikime për këshillat e martesës ose terapistët. Studimi i ri, u krye nga

studiuesit në Universitetin e Commonwealth Virginia (VCU) dhe Lund University në Suedi tekta analizuan regjistrat e popullsisë suedeze. Ata zbuluan se njerëzit që ishin të adoptuar i ngjajnë prindërve të tyre biologjikë, por jo adoptues, prindërve dhe vëllezërve të motrave në historitë e tyre të divorcit. Pra si përfundim, hulumtuesit pranojnë se divorci mund të jetë gjenetike në familje.

## KALENDARI HISTORIK 9 TETOR

- 768 - Karli i Madh dhe Karlemani II ndajnë Republikën Franke
- 1192 - Richard Coeur de Leeuw largohet nga Jerusalemi në fshehtësi.
- 1238 - Xhejms I i Aragon pushton Valensinë dhe themelon Mretërinë e Valensisë.
- 1446 - Alfabeti hangul publikohet në Kore.
- 1617 - Paqja e Pavia mes Spanjës dhe Savojit.
- 1621 - Turqia dhe Polonia nënshkruajnë Paqen e Kotinit.
- 1655 - Mbreti suedez Karel X Gustaaf okupon Krakovin.
- 1708 - Beteja në Lesnaja: Ushtria ruse zë rob karvanin suedez.
- 1760 - Lufta 7 vjeçare: Forcat ruse okupojnë Berlinin.
- 1806 - Prusia i shpall luftë Francës.
- 1817 - Zyrtarisht hapet Universiteti i Gentit.
- 1831 - Vritet Capo d'Istria.
- 1855 - Isaac Singer patenton motorin e makinës për qepje.
- 1899 - Trupat e parë britanik arrijnë në Durban të Afrikës Jugore.
- 1934 - Atentat në Marsej: Vrasja e Mbretit Aleksandri I i Jugosllavisë dhe Ministrit të Jashtëm francez, Louis Barthou.
- 1962 - Uganda shpall pavarësinë nga Britania e Madhe.

## A E DINI SE...



Banka e Vatikanit, është e vetmja në botë që i lejon përdoruesve bankomatit të kryejnë transaksione në latinisht.

Në rast se njerëzit do të mund të nxirrin nga korja e planetit tonë të gjithë sasinë e arit, do të ishte e mundur të mbulohej e gjithë sipërfaqja e tokës me ar deri në lartësinë e gjurit tuaj.



Një në çdo pesë të rritur në SHBA, besojnë se të alienët ekzistojnë të fshehur në planetin tonë, të maskuar si njerëz.

## BARSOLETA



### PINGUINËT ME SYZE

Një polic shef njërin që po ngiste një kamion të mbushur me pinguinë mbrapa. E ndalon dhe i thotë:  
- Ku shkon me gjithë këta pinguinë ti? Çoji në kopsht zoologjik. Të nesërmen polici duke drejtuar trafikun, sheh prapë këtë tipin me kamionin plot me pinguinë dhe secilit i kishte vënë syze. E ndalon prapë dhe i thotë:  
- Ore ti, nuk të thashë ti çoje në kopsht zoologjik dje?  
- I çova mor shef - përgjigjet shoferi.  
- Sot po i çoj në plazh.

## THËNIA E DITËS

Marrëdhënia ideale ka të bëjë me dy gjëra, e para, të gjesht ngjashmërinë, e dyta, të respektosh ndryshimet.



## Vetitë shëruese të gështenjës

Gështenja ruan zembrën Sezonit i rënies së gjetheve na e sjell një ushqim të pasur me materie ushqyese, minerale dhe vitamina. Gështenjat apo ndryshe frutat aromatike me mbështjellës të fortë me ngjyrë kafe të errët, janë burim i shkëlqyeshëm i mineraleve, vitaminave dhe fibrave dhe përveç kësaj, kanë më pak kalori dhe yndyra sesa frutat e tjera arnore. Gështenja si ilaç Ky fryt mund të konsumohet i zier, i pjekur, si pure, por edhe i përgatitur në çaj. Në secilën formë ta konsumoni, do ta ndjeni shijen e saj interesante dhe do t'i thithni



vlera shëruese të saj. Çaj nga gështenja Gështenja njihet për faktin se ndihmon për problemet me tretje dhe veshka. Çaji nga gështenja ndihmon edhe për simptomat e astmës dhe bronkitisit. Gështenja e

egër për vena Duhet ta dalloni gështenjen e egër dhe të butë, sepse e egra nuk konsumohet. Por, prej saj përgatiten tinktura dhe kremra, sepse është shëruese.

Gështenja e egër si ilaç përdoret për problemet me vena të zgjeruara dhe kapilarët e pëlcitur, për hemoroidet, menstruacionet me dhimbje dhe prostata e rritur. Gështenja ruan zembrën Në gështenjë hasim nivel të lartë me yndyrna mono të ngopura. Këto mbrojnë sistemin kardiovaskular, e bashkë me fibrat në gështenjë, ulen nivelin e kolesterolit.

## Origjina e besimit tek patkoi fatsjellës

Qoftë nëse është i varur në mur për të ruajtur dhe tërhequr fatin e mirë, apo për të bekuar ata që kalojnë, patkoi i kalit është një besëtytni shumë e përhapur. Një shpjegim se si u bë fatsjellës, mund të jetë rrëfimi për Shën Dunstanin, një njeri i shenjtë që punonte si farkëtar, kur nuk merrej me lutjet apo nuk luante harpën e tij. Sipas kësaj historie, Shën Dunstani po bënte këtë të dytën kur djalli e dëgjoi të këndojë. Kënga e mbushi djallin me urrejtje, dhe ai gjithashtu nisi të këndojë. Djalli shkaktoi një zhurmë kaq të tmerrshme, sa që Dunstani e dinte që ajo shkaktonte nga një gjë me



të vërtetë e keqe. Dunstani e kapi nga hunda me një palë instrumente të farkëtarit dhe vazhdoi duke i vënë këpucë të nxehta prej hekuri djallit në këmbë, bashkë me gozhdët që shponin lëkurën e tij të butë. Ulë-

rimat e agonisë ishin shumë të forta, aq sa zgjuan të vdekurit. Dunstani refuzoi t'ia heqë këpucët dhe gozhdët, deri kur djalli premtoi që nuk do të ngacmonte më njerëzit tekta këta luteshin në kishë, apo kudo

tjetër, nën mbrojtjen e një patkoi kali. Dunstani e mbajti pjesën e tij të premtimit dhe që atëherë, patkoi ka mbrojtur këdo që e var në mur... sa kohë që qëndrojnë njerëz të virtutshëm. Ka edhe disa shpjegime të tjerë për patkoin, duke përfshirë shoqërimin me numrin shtatë (numri i gozhdëve që përdoret zakonisht). Por çuditërisht, hekurpunuesi zakonisht shoqërohej me djallin dhe të keqen, e jo me të mirën. Ndërkohë që punuesi i metaleve të zinj lidhej me praktikën e magjisë së zezë, punuesi i metaleve të bardhë konsiderohej një person shumë më i respektueshëm.